



Ministry of
JUSTICE

PRISON
REFORM
TRUST

Informacion për të burgosurit

© Prison Reform Trust and HM Prison Service/NOMS

This publication can be shared, copied, distributed and transmitted but not sold. It can not be altered in any way without the permission of the copyright owners.



**Ministry of
JUSTICE**

The National Offender Management Service: part of the Ministry of Justice protecting the public and reducing re-offending by delivering probation and prison services.

**PRISON
REFORM
TRUST**

The Prison Reform Trust works to create a fair and decent prison system. We do this by looking at how prisons are working, giving information to prisoners, staff and people outside and by asking the government and officials to make changes.

First published in 2008 by Prison Reform Trust

ISBN: 0946209 86 3

For further information, contact:

Prison Reform Trust
15 Northburgh Street
London EC1V OJR
020 7251 5070
www.prisonreformtrust.org.uk

Both HMPS and the Prison Reform Trust would like to thank prisoners and staff at HMP Wandsworth for helping with this book and Mencap for its work to make the book easier to read.

The Prison Reform Trust would like to thank the Big Lottery Fund and the Diana, Princess of Wales Memorial Fund for supporting our charity to improve information for prisoners.

Informacion për të burgosurit

Kush punon në burg?

Guvernatori ose **drejtori** është në komandë të burgut. Ne do të përdorim termin guvernator në këtë libër.

Oficerët e burgut – punojnë në shumë punë përreth burgut dhe janë ata punonjës që ju i shihni më shpesh.

Mbikëqyrësi i të dënuarit - Mbikëqyrësi juaj do të punojë me përgjegjësin tuaj të dënimit për t'ju ndihmuar që të përmbushni qëllimet në planin tuaj të dënimit.

Oficeret personalë – ky është një oficer burgu i cili angazhohet për t'ju ndihmuar dhe është ai që do të shkruajë raportet mbi përparimin tuaj. Ata mund edhe të punojnë me ju në planin tuaj të dënimit.

Oficeri i rehabilitimit – dikush që punon me ju për t'ju ndihmuar të mos bëni shkelje të tjera kur dilni nga burgu.

Psikologët – bëjnë vlerësimin tuaj dhe punojnë me punonjës të tjerë për të organizuar kurse për sjelljet e dënueshme.

Klerikët – do t'ju ndihmojnë të praktikoni besimin tuaj. Ata do të jenë prej një numri besimesh fetare të ndryshme. Ju gjithashtu mund të flisni me ta për mënyrën se si ndiheni.

Punonjësit e edukimit dhe të trajnimeve - japin mësim dhe trajnime.

Punonjësit e shëndetësisë – këta janë infermieret, mjekët, dentistët dhe kështu me radhë.

Punonjësit e **CARAT-it** – ndihmojnë të burgosurit me probleme droge.

Anëtarët e IMB-së – janë njerëzit që kontrollojnë nëse burgjet drejtohen në mënyrë të drejtë. Ata janë vullnetarë nga zonat afër.

Vizitorë zyrtarë të burgut – këta janë njerëz vendas që mund të vizitojnë të burgosur, të cilët nuk kanë shumë vizitorë.

Përmbajtja– çfarë ka në këtë libër

Përmbajtja	Faqe
Rreth këtij libër	4
Kur mbërrini në fillim	5
Të burgosurit e padënuar	7
Të burgosurit civilë	16
Të mbajturit e imigracionit	18
Të apelosh kundër fajësisë ose dënimit	22
Llogaritja e kohës që do të qëndroni në burg.	25
Gjera për të rregulluar – jashtë burgut	29
Njerëzit që mund t'ju ndihmojnë në burg	37
Kontakti me familjen dhe miqtë.	39
Kontakti me avokatin tuaj dhe persona të tjerë zyrtarë.	47
Jeta në burg	49
Shëndeti juaj	65
Besimi juaj	78
Rregullat e burgut	83
Si të bëni një ankesë ose një kërkesë	110
Menaxhimi i të dënuarve, planifikimi i dënimit dhe përgatitja për lirim	118
Lirimi i përkohshëm me kusht	134
Lirimi dhe mbikëqyrja	138
Të burgosurit e kombësive të huaja	151
Të rinjtë e dënuar dhe institucionet e të rinjve të dënuar	155

Rreth këtij libri

Ky libër do t'ju informojë mbi gjërat kryesore që duhet të dini për qëndrimin në burg të tilla si

- ✓ Rregullat e burgut dhe mënyrat se si bëhen gjërat.
- ✓ Të drejtat e juaja.

Nëse jeni i pasigurt për ndonjë gjë në këtë libër, pyesni një punonjës të burgut

Kujt i drejtohet ky libër?

Ky libër është për te burgosurit meshkuj duke përfshirë të rinjtë e dënuar të moshës 18 vjeç e sipër.

Për çfarë flitet në këtë libër?

- Ky libër do t'ju tregojë gjithçka që duhet të dini për jetën e burgut.
- Rregullat dhe funksionimi mund të jenë të ndryshme në secilin burg. Në disa raste rregullat e burgut ndryshojnë shpejt. Ju do t'ju tregohen ndryshimet e rregullave që ndikojnë mbi ju.
- Në bibliotekën e burgut ka kopje të rregullave të burgut.
- Mund të kërkoni t'i shikoni këto rregulla edhe nëse nuk mund të shkoni në bibliotekë.

Ku mund të merren kopje të këtij libri.

- Në bibliotekën e burgut.
- Punonjësit e burgut mund të printojnë një kopje të këtij libri, ose pjesë të tij, nëse ju nuk keni mundësi t'a merrni nga biblioteka.
- Në qoftë se keni një kopje të printuar, ju mund të lejoheni ta mbani ose ta ndani me të tjerë në bllokun tuaj të burgut.
- Nëse keni një kopje ju lutem kujdesuni për të sepse mund të mos jetë e lehtë të sigurohet një kopje tjetër.

Kur mbërrini në fillim

Ja se çfarë do të ndodhë kur sapo të mbërrini në burg.

- ✓ Ju do të dërgoheni në zonën e recepsionit të burgut.
- ✓ Tregojini punonjësve nëse keni marrë drogë ose alkool dhe keni nevojë për ndihmë.
- ✓ Punonjësit e burgut do të vendosin me ju se çfarë rrobash do të vishni. Ju mund të jeni të detyruar të vishni rrobat e burgut nëse jeni një i burgosur i dënuar.
- ✓ Një pjestar i stafit të burgut do të bëjë një listë të të gjitha sendeve që keni sjelle me vete. Mund të lejoheni të mbani disa gjëra. Të gjitha sendet e tjera do të mbahen për ju në një vend të sigurtë. Ju do t'i merrni përsëri të gjitha sendet kur të dilni, përve ndonjë gjëje të rrezikshme ose kundra ligjit. Për shembull thika ose droga.
- ✓ Një anëtar i stafit do t'ju kontrollojë. Ju mund të kërkonti të takoheni me një mjek nëse keni një problem mjekësor, që do të thotë që është e vështirë që të kontrolloheni në të tërë trupint'ju.
- ✓ Ju mund të kërkonti të shihni një mjek ose një infermiere në qoftë se keni një problem shëndetësor. Tregojini mjekut ose infermijeres në qoftë se po merrni ndonjë mjekim, ose në qoftë se keni ndonjë problem me drogat ose alkoolin. Gjithashtu tregojuni atyre nëse jeni i mërzhitur apo i shqetësuar për diçka.
- ✓ Ju do të lejoheni të telefoni familjen tuaj. Gjithashtu do t'ju tregohet se si të organizoni që ata t'ju vizitojnë.
- ✓ Do t'ju jepet një numër burgu.
- ✓ Ju do të dërgoheni në qelinë në të cilën do të flini.
- ✓ Ju mund të bëni një banjë ose dush në qoftë se dëshironi.
- ✓ Ju do të takoni punonjës të tjerë. Ju mund të keni një intervistë me dikë që quhet oficeri personal.
- ✓ Punonjësit mund t'ju marrin shenjat e gishtave dhe fotografinë.
- ✓ Punonjësit do t'ju tregojnë më shumë për jetën e burgut dhe se çfarë duhet të bëni. Ky quhet prezantimi.

Informacion i mëtejshëm

Ku do të flini (qelia juaj)

- Ju mund të jeni të detyruar të ndani një qeli me dikë tjetër. Nëse kjo gjë ndodh punonjësit e burgut do të mendohen se kush mund të jete njeriu më i përshtatshëm për të ndarë qelinë me ju. Ju mund t'i tregoni atyre nëse keni ndonjë problem me këtë gjë. Nuk do t'ju kërkohet të ndani qelinë me një njeri që pi duhan nëse ju nuk pini. Tregojini punonjësve nëse jeni të shqetësuar ose ndiheni të pasigurtë.
- Disa burgje kanë një zonë të veçantë ku të burgosurit flenë natën e parë në mënyrë që të mësohen me burgun.

Çfarë duhet të bëni në qoftë se...

Ndiheni shumë të lënduar ose të shqetësuar kur vini në burg.

Është e rëndësishme që të bisedoni me dike në qoftë se ndiheni në këtë mënyrë.

Ju mund të bisedoni

- ✓ me punonjës të burgut. Mund të keni dikë që quhet oficeri personal. Ose mund të bisedoni me punonjës të përgjegjës në zonën tuaj të burgut (ky quhet blloku ose krahu).
- ✓ me mjekun ose infermieren që ju kontrolluan shëndetin
- ✓ me klerikun
- ✓ me një të burgosur i quajtur dëgjues ose shok
- ✓ me Samaritanët.

Jeni i shqetësuar për fëmijët dhe njerëzit e tjerë për të cilët kujdeseni

- bisedoni me njerëzit në listën e mësipërme.

Ju duhet të takoheni me një avokat – në qoftë se nuk keni patur mundësinë për ta takuar përpara se të largoheshit nga gjyqi.

- Pyesni oficerët e burgut në recepsion t'ju ndihmojnë të siguroni një vizitë nga avokati juaj.

Të burgosurit e padënuar

Kush janë të burgosurit e padënuar?

Te burgosurit e **padënuar** janë ata të cilët presin të shkojnë në në gjyq për gjykim.

- ✓ Të burgosurit e padënuar trajtohen sikur ata të ishin **të pafajshëm**. Kjo bëhet për arsye se ata nuk kanë dalë në gjyq për t'u gjykuar për shkeljen e tyre.
- ✓ Të burgosurit e padënuar mund të bëjnë disa gjëra që të burgosurit e dënuar nuk mundën ti bëjnë. Për shembull, ata mund të votojnë dhe zakonisht të vishen me rrobat e tyre.
- ✓ Megjithatë të burgosurit e padënuar gjithsesi duhet të ndjekin shumicën e të njëjtave rregulla si të burgosurit e tjerë.

Si një i burgosurit i padënuar ju duhet të merrni ndihmë dhe përkrahje me qëllim që

- të kërkonti lirim me kusht
- të vazhdoni të mbani punën dhe shtëpinë tuaj
- të mbani kontakt me familjen dhe miq
- të vazhdoni të jeni të përfshirë në ose me drejtimin e një biznesi, për sa kohe që është i ligjshëm.
- të merrni ndihmë për ndonjë problem që mund të keni.

Kërkimi i lirit me kusht kur jeni i burgosur i padënuar

Të kërkoni lirim me kusht do të thotë që ju po kërkoni të liroheni nga burgu ndërkohë që prisni gjyqin.

Informacion i mëtejshëm gjendet në Urdhrat 6100 dhe 6101 të Shërbimit të Burgut.

Kopje të të dyjave gjenden në bibliotekë.

Si të kërkoni lirim me kusht.

Pikat kryesore.

- ✓ Ju mund ti kërkoni lirimin me kusht më shume se një herë të njëjtit gjyq, ose dikujt që quhet Gjyqtari në Dhomë, në qoftë se jeni refuzuar një herë. Por këtë gjë mund ta bëni vetëm nëse jepni një arsye të re përse ata duhet t'ju lirojnë me kusht.
- ✓ Kur kërkoni lirim me kusht, paraqisni të gjitha arsyet që keni përse gjyqi duhet t'ju lejojë të liroheni me kushtt'ju.
- ✓ Në qoftë se gjyqi ju refuzon lirimin me kusht, rishikoni arsyet përpara se të kërkoni lirim me kusht përsëri. Pyetni oficerin e informacionit të lirit me kusht ose oficerin e shërbimeve ligjore ose avokatin tuaj në qoftë se nuk jeni të sigurtë përse nuk ju dha lirim me kusht.
- ✓ Ju mund të pyesni edhe oficerin e informacionit të lirit me kusht në qoftë se keni nevojë për ndihmë që të kërkoni lirim me kusht. Ekziston një skemë e quajtur Clearsprings që ju ndihmon me strehimin.
- ✓ Në qoftë se keni nevojë për të aplikuar për ndihme ligjore (para për të ndihmuar në pagesës për këshillimet ligjore ose përfaqësimin), bisedoni me oficerin e shërbimeve ligjore.
- ✓ Ju duhet të keni një adresë për të jetuar përpara se gjyqi t'ju lejojë lirimin me kusht.

Diku për të jetuar.

- Nëse kërkon lirim me kusht ju duhet t'i jepni gjyqit një adresë të një banese ku mund të jetoni liroheni me kusht. Kjo mund të jetë shtëpia juaj ose një shtëpi e familjes ose miqve tuaj. (Miq të ose familja juaj në fillim duhet të informojnë gjyqin që janë dakord që të jetoni me ta).
- Në qoftë se nuk keni asnjë vend për të jetuar, pyetni oficerin e informacionit të lirimit me kusht ose oficerin e shërbimeve ligjore për ndihmë. Ata mund të ndihmojnë për të gjetur një vend për të jetuar, të tillë si një bujtinë.

Në qoftë se gjykimi juaj do të bëhet në Gjykatën e Magjistraturës

Ju mund të kërkon lirim me kusht çdo herë që shkoni në Gjykatën e Magjistraturës për çështjen tuaj. Ose kërkojini avokatit që ta bëjë këtë gjë për ju.

1. Ju duhet të plotësoni disa formularë për të kërkuar lirim me kusht. Avokati juaj ose oficeri i shërbimeve ligjore duhet t'ju ndihmojnë që ta bëni këtë gjë.
2. Në qoftë se gjyqi nuk ju lejon lirim me kusht, ju do të merrni një letër që do t'ju shpjegojë arsyen përse. Ruajeni këtë letër sepse mund të jetë e dobishme në qoftë se kërkon lirim me kusht përsëri.
3. Në qoftë se Gjykata e Magjistraturës vendos të mos ju japë lirim me kusht në asnjë mënyrë, ata do t'ju dërgojnë një letër tjetër të quajtur certifikate për t'ju shpjeguar këtë.
4. Në qoftë se Gjykata e Magjistraturës jua dërgon këtë certifikatë duke thënë se ata i kanë dëgjuar të gjithë provat, atëherë ju mund t'ja dërgoni certifikatën Gjykatës së Kurorës për të kërkuar lirim me kusht.
5. Në qoftë se Gjykata e Kurorës jua refuzon kërkesën, mund t'i shkruani dikujt që quhet Gjykatës në Dhomë, në Gjykatën e Lartë për të kërkuar lirim me kusht.

Në qoftë se gjykimi juaj bëhet në Gjykatën e Kurorës

1. Shkruajini zyrtarit të Gjykatës së Magjistraturës që ju dërgoi për gjykim në Gjykatën e Kurorës. Ose kërkoni avokatit tuaj ta bëjë këtë për ju.
2. Ju mund t'i kërkoni avokatit tuaj të aplikojë drejtpërdrejt në Gjykatën e Kurorës.
3. Në qoftë se nuk keni të ardhura të mjaftueshme për një avokat dhe nuk keni përfaqësim ligjor për t'ju ndihmuar ju mund të kërkoni ndihmën ligjore të dikujt që quhet Avokati Zyrtar. Pyetni oficerin e shërbimeve ligjore se si mund ta bëni këtë. Për Avokatin Zyrtar dhe gjëra të tjera ligjore ka më shumë informacion në **Urdhrin 2600 të Shërbimit të Burgut 2006**. Ju mund të merrni një kopje nga biblioteka e burgut.

Në qoftë se Gjykata e Magjistraturës dhe Gjykata e Kurorës refuzojnë lirimin tuaj me kusht.

Ju mund t'i drejtoheni **Gjykatësit në Dhomë**, në Gjykatën e Lartë për të kërkuar lirim me kusht.

Kjo është mënyra se si mund ti kërkoni Gjykatësit në Dhomë lirimin me kusht.

1. Kërkoni avokatit tuaj ta bëjë këtë për ju. Në qoftë se po paguani një avokat, ju duhet t'i paguani ata që ta bëjnë këtë për ju.
2. Në qoftë se nuk keni të ardhura të mjaftueshme për një avokat dhe nuk keni përfaqësim ligjor ju mund të kërkoni që Avokati Zyrtar të kërkojë lirimin me kusht për ju. Ju duhet të plotësoni një formë për të deklaruar se sa para keni. Kjo bëhet për t'i treguar Avokatit Zyrtar se ju nuk keni të ardhura të mjaftueshme për të paguar një avokat.

Në qoftë se dërgoheni në Gjykatën e Kurorës për t'u dënuar.

Ju mund të kërkonti lirim me kusht nga Gjykata e Kurorës. Në qoftë se Gjykata e Kurorës nuk ju jep lirim me kusht, ju mund t'i drejtoheni Gjykatësit në Dhomës në Gjykatën e Lartë.

Çfarë ndodh në qoftë se nuk liroheni me kusht?

Ju duhet të ndiqni disa rregulla në qoftë se nuk liroheni me kusht.

Për shembull

- Ju duhet të paraqiteni ne gjyq kur t'ju kërkohet, përveç rasteve kur keni një arsye shumë të fortë për t'u mos paraqitur.
- Mund t'ju kërkohet të përmbushni disa kushte si për shembull të jetoni në një adresë të caktuar, të shkoni në polici çdo ditë ose te mbani një kordon elektronik.
- Ju mund t'ju duhet të gjeni miq ose familjarë të cilët duhet të pranojnë për të paguar disa të holla nëse ju nuk paraqiteni në gjyq. Këto njerëz quhen **siguruesit**.

Nëse shkelni rregullat atëherë ju mund të arrestoheni ose të paditeni për shkelje. Nëse ju nuk paraqiteni në gjyq, familjarëve ose miqve tuaj të cilët janë siguruesit mund t'ju duhet të paguajnë të gjitha të hollat që kanë pranuar të paguajnë, ose të shkojnë në burg vetë.

Siguruesit

- Siguruesit janë miq ose familjarë të cilët pranojnë që të paguajnë disa të holla në rast se ju liroheni me kusht dhe nuk paraqiteni në gjyq kur ju kërkohet.

Si mund të bëhen sigurues familjarët ose miqtë tuaj

Në qoftë se mendoni se mund të merrni lirim me kusht kur të paraqiteni përballë Gjykatës së Magjistraturës.

Sigurohuni që familjarët ose miqtë tuaj që kanë pranuar të jenë sigurues, janë në gjyq me ju. Nëse liroheni me kusht dhe gjyqi i pranon njerëzit e paraqitur si sigurues, ju do të liroheni aty dhe në atë kohë.

Në qoftë se liroheni kur nuk jeni në gjyq.

1. Miqtë ose familja juaj duhet të shkojnë në gjyq ose në rajonin e policisë të vlerësohen për t'u siguruar që janë të përshtatshëm për t'u paraqitur si sigurues. Ata duhet të marrin me vete disa dokumente që të tregojnë mundësinë për të paguar në qoftë se duhet.
2. Miqtë ose familja juaj duhet të nënshkruajnë një dokument ku pranojnë faktin që janë sigurues.
3. Gjyqi ose rajoni i policisë do t'ju japin miqve ose familjes tuaj një dokument të quajtur certifikate, nëse mendohet se ata janë në rregull për të qenë sigurues.
4. Miqtë ose familja juaj duhet ta dërgojnë certifikatën në burg, përpara se ju të liroheni. Kjo bëhet për t'i treguar burgut që gjyqi ose policia i kanë përcaktuar ata si në rregull për të qenë sigurues.

Transporti nga burgu në qoftë se ju jepet lirimi me kusht.

- Në qoftë se ju jepet lirimi me kusht dhe nuk keni të ardhura për të udhëtuar në shtëpi, punonjësit që ju sollën në gjyq mund të sigurojnë që ju të merrni diçka të quajtur autorizim udhëtimi. Kjo është një biletë udhëtimi që ju jep mundësinë të udhëtoni pa pagesë në banesën në të cilën do të banoni gjatë liritimit me kusht.
- Ju gjithashtu mund të merrni një autorizim udhëtimi prej punonjësve që ju dërguan në burg. Ose nga punonjësit e burgut nëse jeni në burg dhe dëshmuat në gjyq me anë të lidhjes me video.

Përgatitja për të shkuar në gjyq

Ju duhet të bisedoni me oficerin e shërbimeve ligjore në burg për ndihmë për tu përgatitur për çështjen tuaj në gjyq dhe gjetjen e një avokati.

1. Sigurimi i dëshmitarëve për gjyqin tuaj.

- Pyesni avokatin tuaj që t'ju ndihmojë të merrni dëshmitarët që të flasin në gjyqin tuaj.
- Nëse nuk keni avokat mund të pyesni oficerin e shërbimeve ligjore për ndihmë.
- Oficeri i shërbimeve ligjore nuk mund të marrë dëshmitar për ju. Por ata ju ndihmojnë të shkruani letër miqve ose familjes suaj ku t'ju kërkoni që ata të mundohen të gjejnë dëshmitarët për ju.
- Ju mund t'i shkruani policisë, dhe ti kërkoni që të mundohen të sigurojnë dëshmitarët për ju. Por policia nuk siguron që këta njerëz do të paraqiten në gjyq.

2. Përdorimi i kompjuterit për t'ju ndihmuar me punët tuaja ligjore

- Ju nuk mund të përdorni kompjuterin tuaj personal për këtë.
- Pyesni guvernatorin nëse kërkoni të përdorni një kompjuter të burgut për t'ju ndihmuar me punët tuaja ligjore.
- Guvernatori do të organizojë që ju të përdorni një kompjuter laptop të burgut nëse ata mendojnë se keni nevojë për një të tillë për të bërë gjyqin tuaj më të drejtë.
- Ju duhet të ndiqni disa rregulla nëse guvernatori nuk ju lejon të përdorni një laptop burgu.
- Mund të gjeni informacion të mëtejshëm në **Udhëzimet e Shërbimit të Burgut 2/2001**. Një kopje e tillë gjendet në bibliotekë.

3. Sendet tuaja

- Merrini të gjitha sendet tuaja personale në gjyq në rast se të liroheni. Nëse keni lënë gjëra të tjera në burg edhe pas lirit, ju duhet të kontaktoni burgun që ti marrni ato.

Gjëra të tjera mbi të qenit i burgosur i padënuar

Shëndeti juaj

- Ju **nuk** jeni të detyruar të merrni kujdes shëndetësor të NHS-it nga punonjësit e shëndetësisë së burgut në qoftë se nuk keni dëshirë.
- Ju mund të merrni kujdes shëndetësor nga një mjek ose dentist privat por mund t'ju duhet të paguani.
- Pyesni një punonjës të shëndetësisë në qoftë se dëshironi këtë. Zakonisht ata dhe guvernatori do t'ju lejojnë ta bëni këtë.

Votimi

Ju mund të votoni edhe në burg në qoftë se jeni

- i padënuar
- i dënuar por pa ju dhënë dënimi akoma.
- një i burgosur civil i cili ndodhet në burg për mospagesë gjobash ose mospërbushje udhëzimesh gjyqi (kjo quhet shpërfillje gjyqi)

Përpara se të votoni emri juaj duhet të jetë në një listë që quhet **regjistri i votuesve**.

Në qoftë se emri i juaj nuk është në regjistrin e votuesve

Ju duhet të plotësoni një formë dhe ta dërgoni tek dikush jashtë burgut i quajtur Oficeri i regjistrimit të votuesve. Adresa për të dërguar format është në **Urdhri i Shërbimit të Burgut 4650**. Një kopje e tillë gjendet në bibliotekë.

1. Pyesni oficerin tuaj personal ose një oficer tjetër burgu për formën ose informacion të mëtejshëm për votimin.
2. **Urdhri i Shërbimit të Burgut 4650** përmban informacion të mëtejshëm për votimin. Ju informon gjithashtu përmbi gjërat e tilla si votimi me postë (ku ju votoni me anë të postës) ose votim me ndërmjetës (kur dikush tjetër voton për ju).

Punë dhe marrje pagese.

- Ju **nuk** jeni të detyruar të punoni në burg në qoftë se nuk doni.
- Në qoftë se ju doni të punoni por nuk ka punë për ju, atëherë ju do merrni një pagesë të vogël të hollash çdo javë për të blerë gjërat që keni nevojë.
- Në qoftë se nuk pranoni punën që iu është ofruar ju mund të mos merrni të holla nga burgu. Dhe mund t'ju mos ofrohet më punë.

Të burgosurit civilë

Të burgosurit civilë janë njerëz që janë dërguar në burg për gjëra të tilla si

- mospagesë të hollash për mbajtjen dhe kujdesin e fëmijëve.
- mospagim të hollash për ato që quhen gjoba dhe borxhe.
- mos pagim të hollash që pranuan të paguanin për dikë të njohur që ishte në lirim me kusht dhe nuk u paraqit në gjyq.
- mosbindje udhëzimeve të gjyqit.

Të burgosurit civilë trajtohen kryesisht në të njëjtën mënyre si të burgosurit e dënuar. Megjithatë ka disa ndryshime. Për shembull, në qoftë se jeni i burgosur civil

- Ju keni të njëjta të drejta me të burgosurit e padënuar për vizitat, letrat dhe thirrjet telefonike. **Shikoni faqen 40.**
- Ju nuk jeni të detyruar të përziheni me të burgosurit e tjerë nëse nuk dëshironi.
- Ju mund të vishni rrobat tuaja. Në qoftë se nuk keni rroba të mjaftueshme, mund të kërkoni për rroba të tjera nga punonjësit e burgut.
- Ju mund të lejoheni të votoni në qoftë se jeni dërguar në burg për shpërfillje gjyqi ose mospagese gjobe. Do të gjeni informacion të mëtejshëm në **Urdhrin e Shërbimit të Burgut**. Një kopje e tillë gjendet në bibliotekë.

Gjera të tjera përmbi të qenit një i burgosur civil

Lirimi i parakohshëm nga burgu

- Në varësi të arsyes të dënimit me burg nga gjyqi, mund të jetë e pamundur që ju të liroheni para kohe. Ju madje mund të shërbeni të gjithë kohën e plotë të dënimit tuaj. Punonjësit e burgut do ta shqyrtojnë këtë në atë kohë kur të llogarisin datën e lirimit tuaj.
- Pyesni oficerin tuaj personal, ndonjë oficer burgu tjetër ose punonjësit e rehabilitimit për ndihmë në qoftë se
 - Nuk jeni i sigurt në qoftë se mund të liroheni para kohe.
 - Ju mendoni se duhet të liroheni para kohe por punonjësit e burgut nuk e kanë marrë këtë parasysh kur kanë llogaritur ditën tuaj të lirimit.

Apelimi kundër dërgimit në burg për shpërfillje gjyqi

- Shpërfillje gjyqi do të thotë mos zbatim i udhëzimeve të gjyqit. Ju mund të apeloni në qoftë se jeni dërguar në burg për shpërfillje gjyqi. Të apeloni do të thotë që të mundoheni të ndryshoni vendimin që ka marrë gjyqi .
- Si fillim ju duhet të bisedoni me oficerin e shërbimit ligjor në burg, që të merrni këshilla se si ta bëni këtë.

Në qoftë se jeni dërguar në burg nga Gjykata e Magjistraturës.

Apeloni në Gjykatën e Kurorës ose kërkoni avokatit tuaj ta bëjë këtë brenda 21 ditësh të marrjes së dënimit.

Ne qoftë se ju jeni dërguar në burg nga Gjykata e Kurorës ose Gjykata e Rrethit.

- Apeloni në Gjykatën Civile të Apelit ose kërkoni avokatit ta bëjë këtë brenda 14 ditësh të marrjes së dënimit. Adresa ku ta dërgoni apelin është më poshtë

Gjykata Civile e Apelit
Royal Courts of Justice
Strand
London
WC2N 2LL

Të ndaluarit e imigracionit

Të Ndaluarit e Imigracionit. Të ndaluarit e Imigracionit janë njerëz të cilët nuk janë nga MBRETËRIA E BASHKUAR (Angli, Skoci, Uells dhe Irlandë e Veriut)

Këto zakonisht janë njerëz të cilët janë duke u mbajtur në burg për shkelje të rregullave të imigracionit ose shkelje ligjore dhe që tani po presin që të njoftohen nëse do të dërgohen mbrapsht (përzihen) në vendin nga kanë ardhur. Agjencia e Kufirit dhe Imigracionit vendos se çfarë do të ndodhi me të ndaluarit e imigracionit.

Agjencia e Kufirit dhe Imigracionit. Ky është një grup njerëzish që punojnë për qeverinë. Ata përgjigjen për menaxhimin e atyre që vijnë në këtë vend për të punuar, për vizitë ose për të jetuar.

- ✓ Agjencia e Kufirit dhe Imigracionit do t'ju kontaktojnë gjatë kohës që jeni në burg. Ata do të rishikojnë çështjen tuaj gjatë kohës që jeni në burg.
- ✓ Ju duhet të ndiqni të njëjtat rregulla si të burgosurit e padënuar gjatë kohës që jeni në burg. **Shikoni faqen 7 për informacion të mëtejshëm.**
- ✓ Ju duhet të mundoheni të merrni ndihmën e një avokati. Nëse nuk keni një avokat kontaktoni një grup të quajtur Shërbimi i Këshillave të Imigracionit. **Adresa e tyre është në faqen 20.** Do t'ju jepet mundësia ti telefononi, shkruani dhe mbase edhe ti dërgoni faks avokatit tuaj. Gjithashtu ata mund të vijnë e t'ju vizitojnë.
- ✓ Kërkoni ndihme në qoftë se keni nevojë nga këta njerëz
 - oficerit personal i juaj, në qoftë se keni një
 - oficerit përgjegjës të bllokut tuaj të burgut.
 - dikush që quhet oficeri i barazisë racore në burg.
 - ose dikush që quhet koordinatori i të burgosurve të huaj, në qoftë se ka një të tillë në burgun tuaj.
- ✓ Ju mund të merrni një përkthyes nëse keni nevojë për një. (Ky është dikush që mund t'ju ndihmojë të kuptoni diçka të thënë në Anglisht).
- ✓ Për informacion të mëtejshëm ju mund të shihni një fletëpalosje të quajtur **Informacion dhe këshilla për të burgosurit e huaj.** Një kopje e tillë gjendet në bibliotekë.

Kontakti me punonjësit që shqyrtojnë çështjen tuaj

- Persona nga Agjencia e Kufirit dhe Imigracionit do t'ju kontaktojnë gjatë kohës që jeni në burg. Ata mund të punojnë në burgun tuaj, ose mund të vinë t'ju vizitojnë në burg.
- Ju gjithashtu mund të kontaktoni me ta në qoftë se keni nevojë.
- Ju gjithashtu mund t'i kërkonit avokatit, një oficeri të burgut ose guvernatorit të kontaktoni me punonjësit e imigracionit që po merren me çështjen tënde.

Kërkesa e lirimit me kusht (kjo do të thotë që të kërkoresh të lirohesh nga burgu ndërkohë që çështja jote po shqyrtohet)

- Ju mund të keni mundësinë të kërkonit që të liroheni me kusht nga burgu.
- Për të kërkuar të liroheni me kusht ju duhet të plotësoni një formë që quhet **IS 91R**.
- Në formë ka më tepër informacion rreth lirimit me kusht.
- Ju mund të merrni ndihmë për të kërkuar formën e lirimit me kusht.
 - Një grup që quhet Shërbimi i këshillave të imigracionit (**të dhënat e tyre janë në faqen 20**)
 - Stafi i imigracionit që punon ose viziton burgun tuaj.
 - Avokati juaj ose stafi në burg. Ato mund të kontaktojnë me stafin e imigracionit që po shqyrton çështjen tuaj.

Njerëz që mund t'ju ndihmojnë

1. Shërbimi i këshillave të imigracionit

Këta njerëz japin këshilla dhe ndihmë falas për të mbajturit e imigracionit,

Shërbimi i këshillave të imigracionit

Head Office

3rd Floor

County House

190 Great Dover Street

London

SE1 4YB

Telefoni i përgjithshëm 0207 967 1200

Linja këshilluese 0207 967 1299 (gjatë orarit të punës).

Faksi 0207 403 5875

2. Shërbimi këshillimor për ndalimet

Këta njerëz mund të japin këshilla dhe ndihmë për gjëra në lidhje me qëndrimin tuaj si një i ndaluar imigracioni. Ata mund t'ju ndihmojnë të takoheni me një avokat. Gjithashtu ata vizitojnë burgjet shpesh herë.

Shërbimi këshillimor për ndalimet

Unit B3

62 Beechwood Road

London

E8 3DY

Telefoni 0207 254 6888

Faksi 020 7254 8555

3. Këshilli i bashkuar për mirëqenien e imigrantëve (JCWI)

Këta njerëz ju japin ndihmë, informacion dhe këshilla të mbajturve të imigracionit.

Këshilli i bashkuar për mirëqenien e imigrantëve
115 Old Street
London
EC1 9RT

Telefoni 020 7251 8706

Faksi 0207 251 8707

Në qoftë se ju jeni një azil kërkues (dikush që ka lënë vendin e tij sepse është në rrezik dhe është duke pritur të marrë vesh në qoftë se mund të qëndrojnë në Mbretërinë e Bashkuar), kontaktoni me

4. Qendra ligjore e refugjatëve (RLC)

Qendra Ligjore e Refugjatëve
Nelson House
153-157 Commercial Road
London
E1 2DA

Telefoni 0207 780 3200

Faksi 0207 780 3201

Ju gjithashtu mund të telefononi këto numra

1. Një numër **telefoni falas** 0800 592 3333 ose 0207 780 3333

Ju mund të telefononi këtë numër të hënën, të mërkurën dhe të premten prej orës 10.30 të mëngjesit deri në 1.00 të drekës dhe prej 2.00 deri në orën 4.30 të mbasdites.

2. Në qoftë se keni nevojë të flisni me dikë shumë shpejt në një rast **urgjent** telefononi në numrin 07831 598057.

Ju mund ta merrni këtë numër gjatë javës dhe në fundjavë nga ora 6.00 deri në 8.00 të darkës.

Të apelosh kundër vendimit ose dënimit

Fjalë të nevojshme

Vendimi juaj . Kur gjyqi vendos që ju ishit fajtorë për krimin.

Dënimi juaj. Ajo ç'ka gjyqi vendos duhet të zbatohet sepse ju jeni fajtor.

Bërja e një apeli. Kjo ndodh kur ju mundoheni të ndryshoni vendimin e marrë nga gjyqi për fajësinë ose dënimin tuaj.

Ju mund të përpiqeni të ndryshoni të dy vendimet e marra që janë dhënë për **fajësinë** dhe **dënimin**. Ky proces quhet apel. Avokati juaj do t'ju këshillojë në qoftë se mund të apeloni dhe për çfarë mund të apeloni.

Pikat kryesore

- Mendohuni mirë përpara se të vendosni të apeloni. Disa herë, nëse apeli nuk është i suksesshëm, gjyqi mund të vendosi që koha që keni shpenzuar në burg duke bërë apelin do t'i shtohet dënimit tuaj.
- Sigurohuni që keni marrë këshillë nga avokati juaj ose përfaqësuesi juaj në gjyq përpara se të merrni ndonjë vendim.
- Ju mbase duhet ta bëni apelin tuaj shpejt. Zakonisht brenda 28 ditëve të fajësisë ose dënimit. Mbas kësaj ju mund të keni të drejte të apeloni. Pyesni avokatin tuaj për këshillë.
- Kërkoni të bisedoni në burg me dike që quhet punonjësi i shërbimit ligjor. Ata mund t'ju ndihmojnë për t'ju shpjeguar si të apeloni.
- Në qoftë se bëni një apel, ju duhet të keni të hollat për ta paguar atë. Ju mund të aplikoni për të siguruar disa të holla të quajtur financimi për shërbime ligjore.

Si të apelosh

1. Bisedoni me avokatin ose me përfaqësuesin tuaj në gjyq. Në qoftë se nuk arritët të flisnit me ta në gjyq, kërkojini guvernatorit nëse ju mundi t'i takoni ata në vizitë.

Avokati ose përfaqësuesi juaj ligjor do t'ju

- thonë se sa mundësi keni të fitoni apelin sipas mendimit të tyre.
- plotësojnë format në qoftë se vendosni të apelon.

2. Kërkoni të flisni me punonjës të shërbimeve ligjore. Ata mund t'ju shpjegojnë se si mund të bëni një apel.

3. Punonjësi i shërbimeve ligjore mund t'ju tregojë cilat forma të plotësoni dhe ku t'i dërgoni. Kjo gjë varet nëse ju u gjykuat në Gjykatën e Kurorës apo në Gjykatën e Magjistraturës.

4. Nëse apeli juaj do të bëhet, aplikoni të merrni të holla që të paguani apelin. Të hollat për të cilat duhet të aplikoni quhet **financimi për shërbimet ligjore**.

Financimi për shërbimet ligjore (të hollat) që pagoi për gjyqin tuaj, lejon vetëm që ju të merrni këshilla se si të kryeni apelin tuaj, jo të bëni apelin.

Çfarë duhet bërë nëse...

Doni të ndërroni avokatin ose përfaqësuesin tuaj ligjor.

- Bisedo me avokatin ose përfaqësuesin ligjor që keni tani dhe tregojini pse dëshironi t'i ndryshoni. Ata do të pyesin gjykatësit nëse është e mundur që ju të ndërroni përfaqësues.
- Ose ju mund të paguani të takoheni me avokatin ose këshilltarin ligjor që zgjidhni vetë.

Ju dëshironi të liroheni me kusht ndërkohë që prisni që të dëgjohet apeli juaj?

- Ju duhet të plotësoni një formë të quajtur **Forma B** dhe ta dërgoni në Gjykatën e Apelit.

Nëse apeli juaj refuzohet (domethënë nuk është i suksesshëm)

- Ju mund të pyesni një grup njerëzish të quajtur **Komisioni i rishqyrtimit të çështjeve kriminale** që ta rishikojë çështjen tuaj.
- Ata mund ti rishikojnë çështjet kur mendojnë se është bërë një gabim. Ata mund ta dërgojnë çështjen mbrapsht në Gjykatën e Apelit.
- Ju duhet t'ju tregoni atyre **informacion ose prova të reja** për të cilat nuk është folur më parë në gjyq ose në apel.
- Ju mund të merrni ndihmë nga një avokat.
- Për t'ju ndihmuar ju mund të merrni Financim për Shërbet Ligjore. Ju duhet të plotësoni një formë që quhet **CDS1** dhe **CDS2** për ta kërkuar këtë ndihmë.
- Informacion i mëtejshëm gjendet në kapitullin 3 të **Urdhrit 4400 të Shërbimit të Burgut**. Ju mund ta gjeni një kopje në bibliotekë.

Llogaritja e kohës së qëndrimit në burg

Pikat kryesore

- Gjyqi vendos sa i gjatë do të jetë dënimi juaj, por zakonisht llogaritja e detajeve vonohet.
- Data e mbarimit të dënimit do t'ju thuhet kur të shkoni në burgt'ju. Në qoftë se burgu është duke pritur informacion për kohëzgjatjen e dënimit juaj, ju mund të informoheni që të dhënat janë **të përkohshme**. Kjo do të thotë që kohëzgjatja mund të ndryshojë.
- Në qoftë se thyeni rregullat e burgut mund t'ju jepen ditë burgimi shtesë. Këto nuk janë pjesë e dënimit tuaj. **Shihni faqen 83 për informacion të mëtejshëm.**
- Bisedoni me oficerin tuaj personal ose me ndonjë punonjës tjetër në qoftë se keni nevojë për të kuptuar dënimin tuaj me burg.

Për dënimin tuaj – kjo nuk përfshin burgimin e përhershëm ose dënimin pa afat për të burgosur e dënuar për mbrojtje publike

Dënimi juaj llogaritet duke konsideruar

- datën kur jeni dënuar
- sa i gjatë është dënimi juaj
- data që ju kryet veprën penale
- shërbimi i burgut do të konsiderojë të gjithë kohën që ju keni kryer në burg ose në arrest për veprën penale nëse ajo është kryer përpara datës 4 prill 2005
- në qoftë se vepra juaj penale është kryer mbas datës 4 prill 2005, gjyqi mund të udhëzojë burgun që të mos llogarisë kohën që keni kryer nën arrest.

Sa kohë do të qëndroni në burg?

Kjo varet nga data kur është kryer krimi. Shihni **faqen 145** për informacion të mëtejshëm.

Dënimi për të rritur deri në 12 muaj

- Lirimi juaj do të jetë i pakushtëzuar (AUR).
- Ju **nuk** do të mbikëqyreni nga një menaxher i të dënuarve.
- Do t'ju jepet informacion i quajtur njoftim. Ky njoftim do të shpjegojë se çfarë do të thotë dhe ju duhet ta nënshkruani atë.

Vepra penale të kryera përpara datës 4 prill 2005

Në qoftë se dënimi juaj është më pak se 1 vit

- Ju do të liroheni pa licencë në mes të dënimit (përveç rastit kur ju jeni nën 21 vjeç).

Në qoftë se dënimi juaj është më i gjatë se 1 vit dhe më i shkurtër se 4 vjet

- Ju do të liroheni kur të keni kryer **gjysmën** e dënimit tuaj.
- Kur të ndodhë kjo, ju duhet të takoni dikë nga rehabilitimi i cili do të sigurojë që po i përmbaheni rregullave të licencës suaj.
- Licenca juaj mbaron në treçerekun e kohës së dënimit tuaj.

Në qoftë se dënimi juaj është më tepër se 4 vjet ose më i gjatë

- Ju mund të aplikoni për lirim para kohe me kusht kur të keni kryer **gjysmën** e dënimit tuaj.
- Në qoftë se merrni lirim para kohe me kusht, dikush nga shërbimi i rehabilitimit do t'ju kontrollojë vazhdimisht mbas lirim tuaj.
- Në qoftë se **nuk** merrni lirim para kohe me kusht, ju mund të aplikoni përsëri çdo vit përveç rastit kur keni më pak se 13 muaj për të kryer nga dënimi juaj.
- Në qoftë se **nuk** merrni lirim para kohe me kusht asnjëherë, ju do të liroheni përpara mbarimit të dënimit tuaj. Data që do të liroheni quhet data e mos-lirimit para kohe me kusht. Ju duhet të takoheni me dikë nga rehabilitimi i cili do të bashkëpunojë me ju dhe do të kontrollojë se ju jeni duke zbatuar rregullat e licencës.

Dënime të zgjatura

- Ju mund të keni një dënim të zgjatur për një krim të dhunshëm ose seksual.
- Data kur do dilni nga burgu varet nga sa gjatë thotë gjykatësi që ju duhet të qëndroni në burg.
- Në qoftë se ju merrni lirim përpara kohe ju mund të jeni nën licencë më gjatë.
- Në qoftë se ju **nuk** merrni lirim përpara kohe me kusht, ju mund të keni mundësinë të aplikoni çdo vit.
- Në qoftë se jo, ju do të liroheni përpara përfundimit të dënimit tuaj. Data kur do të liroheni quhet data e mos-lirimit para kohe me kusht. Ju duhet të takoheni me dikë nga rehabilitimi i cili do të bashkëpunojë me ju dhe do të kontrollojë se ju jeni duke zbatuar rregullat e licencës.

Vepra penale të kryera në ose mbas datës 4 prill 2005

Në qoftë se dënimi juaj është më i gjatë se 1 vit dhe më i shkurtër se katër vite

- Ju do të liroheni kur të keni shërbyer **gjysmën** e dënimit.
- Ju duhet të takoheni me dikë nga rehabilitimi që do të bashkëpunojë me ju dhe do të kontrollojë që ju jeni duke zbatuar rregullat e licencës tuaj.

Dënimet e zgjatura

- Në qoftë se ju keni një dënim të zgjatur, ju duhet të **aplikoni** për lirim përpara kohe me kusht. Ju mund ta bëni këtë mbasi ju keni shërbyer një pjesë të dënimit tuaj në burg.
- Në qoftë se ju **nuk** merrni lirim përpara kohe. Ju mund të aplikoni përsëri çdo vit.

Vepra penale të kryera përpara datës 1 tetor 1992

- Ju mund të aplikoni për lirim përpara kohe me kusht mbasi ju të keni shërbyer **1 të tretën** e dënimit tuaj.
- Në qoftë se merrni lirim para kohe ju do të liroheni nga burgu nën licencë deri kur të arrini dy të tretat e kohës.
- Në qoftë se **nuk** merrni lirim para kohe me kusht ju keni të drejtën të aplikoni përsëri çdo vit përveç rastit kur keni më pak se 13 muaj për të shërbyer. Në qoftë se **nuk** merrni lirim para kohe me kusht asnjëherë, ju do të liroheni nga burgu mbasi të keni kryer **2 të tretat** e dënimit tuaj.
- Në qoftë se kryeni një krim tjetër gjatë kohës së lirimit para kohe me kusht ju mund të kryeni pjesën e mbetur të dënimit tuaj me burg.

Informacion të mëtejshëm për lirimin në licencë dhe atij përpara kohe me kusht mund të gjeni në faqen 141.

Gjëra për të rregulluar – jashtë burgut

1. Fëmijët ose njerëzit e tjerë për të cilët ju kujdeseni

- Në qoftë se keni nevojë për të sistemuar mbikëqyrjen e fëmijëve ose të njerëzve të tjerë për të cilët ju kujdeseni, u thoni punonjësve të burgut menjëherë.

Pagesat për Agjencinë e përkrahjes së fëmijëve

- Në qoftë se keni paguar të holla për mirëqenien e fëmijëve ju duhet të njoftoni Agjencinë e përkrahjes së fëmijëve që jeni në burg.
- Për këtë, ju duhet të njoftoni Agjencinë e përkrahjes së fëmijëve brenda një jave. Përbën vepër penale në qoftë se nuk i njoftoni ata brenda një jave për ndryshimet.
- Ju **nuk** jeni të detyruar të paguani të holla për mirëqenien e fëmijëve në qoftë se nuk po punoni apo po merrni ndihma.

Ju mund t'i shkruani atyre në

Agjencia e përkrahjes së fëmijëve
National Helpline
PO Box 55
Brierly Hill
DY5 1YL

Telefoni 08457 138 924

2. Ndhimat sociale

Në qoftë se merrni ndihma sociale.

- Bisedoni me zyrën e qendrës së punës sa më shpejt që të jetë e mundur për t'i sqaruar gjërat. Ose kërkojini dikujt nga familja juaj që ta bëjë këtë.
- Në qoftë se jeni në burg për më shumë se 21 ditë, zakonisht ndihma e vetme që ju mund të merrni është ndihma për pagesën e shtëpisë.
- Nëse mendoni se qendra e punës ju ka hua të holla ndihmash, atëherë shkruajini atyre dhe kërkojini që t'ju dërgojnë të hollat në burg. Ata duhet të dërgojnë një **çek** të paguar tek **guvernatori**. Më vonë të hollat do t'ju paguhen juve në dorë.
- Nëse ju nuk mund t'i merrni këto të holla, atëherë mund t'i kërkonit mbas lirit tuaj.

Në qoftë se punonit

- Familjes tuaj mund ti duhet të kërkojë ndihma gjatë kohës që ju jeni në burg ose në arrest.
- Ata duhet të kontaktojnë zyrën e qendrës së punës sa më shpejt që të jetë e mundur.

Sigurohuni që të kontaktoni qendrën e punës sa më shpejt që të jetë e mundur. Nëse nuk e bëni këtë gjë, familja juaj mund të ketë probleme në marrjen e ndihmave tani and mbasi të liroheni.

3. Pagesa e qirasë ose pagesa e kredisë së shtëpisë

- Ju ose familja juaj mund të merrni ndihmën e pagesës së shtëpisë për t'ju ndihmuar me qiranë dhe me kredinë e shtëpisë.
- Do të ishte mirë që të merrnit këshillë për këtë, sepse kjo varet nëse jeni i dënuar ose në arrest.

Kur paguani qira – si të veproni

Shkruajini pronarit të shtëpisë ose punonjësit të agjencisë së shtëpive për t'i njoftuar që jeni në burg. Tregojuni atyre

- Se sa kohë do të jeni në burg.
- Nëse dikush do të kujdeset për shtëpinë tuaj.

Nëse ishit duke jetuar me familjen dhe duke marrë ndihmën për pagesën e shtëpisë

- Shkruajini zyrës së pagesës së shtëpisë për t'i njoftuar që ju jeni në burg.
- Familja juaj duhet gjithashtu t'ju shkruajë atyre për t'i kërkuar që të marrin përsipër ndihmat tuaja në kohën që jeni në burg.

Në qoftë se familja juaj ka nevojë të fillojë të marrë ndihmën e pagesës së shtëpisë.

- Ata duhet t'i shkruajnë zyrës së pagesës së shtëpisë për të bërë një kërkesë për pagesën e shtëpisë.

Në qoftë se jetoni vetëm

- Ju mund të vazhdoni ta merrni pagesën e shtëpisë ndërkohë që jeni nën arrest deri në 52 javë ose në qoftë se do të rrini në burg më pak se 13 javë.
- Në qoftë se nuk e merrni pagesën e shtëpisë për momentin, shkruajini këshillit tuaj bashkiak dhe kërkojini t'ju dërgojnë në formular të ri kërkesë.

Nëse nuk e paguani dot qiranë dhe nuk mund ta merrni ndihmën e pagesën së shtëpisë

- Ju mund të doni t'ja ktheni shtëpinë tuaj të zotit të shtëpisë ose punonjësit të agjencisë për shtëpitë. Kjo mund të jetë më mirë se sa t'ju keni hua shumë të holla dhe të futeni në borxh.
- Pronari i shtëpisë suaj mund të pranojë që t'ju gjejë një vend tjetër ku të banoni kur të dilni nga burgu.
- Kërkojini së pari këshilla NACRO-s ose Zyrës së këshillimeve për qytetarët.

Këto organizata mund të vizitojnë burgjet, nëse jo, ju mund të telefononi NACRO-s në 0800 0181 259

Kredia e shtëpisë tuaj

Ju ose familja juaj mund të merrni ndihmë për të paguar **interesin** të kredisë së shtëpisë tuaj nëse

- Ju banonit me familjen tuaj në shtëpinë në të cilën ata vazhdojnë të banojnë.
- Ju **nuk** jeni dënuar ose prisni dënimin tuaj, dhe po blini një shtëpi vetëm.

Çfarë duhet të bëni

- ✓ Ju ose familja juaj duhet t'i shkruani zyrës së qendrës së punës lokale nëse ju ose ata doni të aplikoni për ndihmë për banesë.
- ✓ Sigurohuni që i keni treguar që jeni në burg kompanisë të kredisë së shtëpisë, bankës ose shoqërisë bankare.
- ✓ Gjithashtu informojini ata se çfarë mendoni se do të ndodhë. Për shembull, në qoftë se doni të paguani vetëm pjesën e interesit të kredisë së shtëpisë tuaj. Ose nëse ju mendoni që nuk do të jeni në gjendje ta paguani atë fare.
- ✓ Ju mund të ndaloni pagimet për një kohë të shkurtër. Ose ta shisni shtëpinë.

Si do të paguhet ndihma e shtëpisë

Në qoftë se e keni blerë shtëpinë tuaj përpara datës 2 tetor 1995

- Java 1 deri më 8 Ju **nuk** do të merrni të holla për shpenzimet e shtëpisë tuaj
- Java 9 deri më 27 Ju do të merrni gjysmat e të hollave
- Nga java 27 Ju do të merrni të gjithë të hollat

Në qoftë se e keni blerë shtëpinë tuaj mbas datës 2 tetor 1995

- Java 1 deri më 39 Ju **nuk** do të merrni të holla për shpenzimet e shtëpisë tuaj
- Nga java 39 Ju do të merrni të gjitha të hollat

4. Taksa e bashkisë

Çfarë duhet bërë

- ✓ Informojeni bashkinë se jeni në burg. Ju mund të mos paguani taksë bashkie ose familja juaj mund të paguajë më pak taksë bashkie.
- ✓ Ju duhet të merrni një fletëpalosje për taksën e bashkisë kur të arrini në burg. Së bashku me fletëpalosjen do të ketë edhe disa formularë. Plotësojini formularët për të kontaktuar bashkinë vendore.

5. Faturat e tilla si uji, gazi, elektrik dhe telefoni

Ju **nuk** mund të merrni ndihmë për këto gjatë kohës që jeni në burg.

Çfarë mund të bëni

- ✓ Ju mund t'i shkruani kompanive dhe t'i informoni se jeni në burg. Kërkoni ndihmë nga punonjësit për ta shkruar letrën.
- ✓ Ju mund të mund të pyesni ata në qoftë se është e mundur të paguani faturat kur të dilni nga burgu. Ose ju mund të kërkoni që gazi, uji ose elektrik të ndërpritet.

6. Numri i sigurimeve kombëtare

Nëse keni paguar kundrejt numrit të sigurimeve kombëtare përpara se të hynit në burg

- Nuk do t'ju paguhen sigurimet kombëtare për sa kohë që jeni në burg.
- Por në qoftë se jeni ndërmjet 16 dhe 18 vjeç ju do të merrni kreditin e taksës.
- Ju gjithashtu mund të merrni kreditin në qoftë se jeni ndërmjet 60 dhe 65 vjeç.

Paratë që paguani për sigurimet kombëtare

Ndërkohë që jeni në burg

Ju **nuk** mund të paguani

- Llojet e sigurimeve kombëtare të quajtura Shkalla 1 dhe Shkalla 2 (që kanë të bëjnë me punësimin)
- Por ju **mund** ta paguani këtë nëse jeni në një projekt të veçantë ndërkohë që jeni në burg. Për shembull, kur paguheni sepse keni bërë punë në komunitet.

Ju **mund** të paguani

- Një lloj sigurimi kombëtar të quajtur shkalla 3.
- Nëse nuk e paguani më këtë lloj të sigurimit kombëtar, kjo gjë mund të ndikojë mbi pensionin ose ndihmën në raste hidhëri. Kjo varet nga gjërat të tilla si kohëzgjatja e dënimit tuaj.

Për më shumë informacion kontaktoni me zyrën tuaj të qendrës së punës ose shkruajini

HM Revenue & Customs
National Insurance Contributions Office
Benton Park View
Newcastle on Tyne
NE98 1ZZ

Telefoni 0845 302 1479

7. Pensioni juaj shtetëror

Ju **nuk** do ta merrni pensionin shtetëror

- Në qoftë se jeni dënuar.
- Ndërkohë që jeni në arrest ose duke pritur gjyqin.

Ju **do ta** merrni pensionin tuaj shtetëror

- Në qoftë se jeni liruar pa u dënuar. Ju do t'i merrni të hollat kur të dilni nga burgu.

Në qoftë se keni një partner

- Partneri/ja juaj do të vazhdojë ta marrë pension e saj/tij kur ju jeni në burg përveç rasteve kur ata marrin diçka që quhet shtesa e të varurit.
- Në qoftë se nuk janë të sigurt ata duhet ta kontrollojnë me zyrën e qendrës së punës së tyre.

Për informacion të mëtejshëm shkruajini Shërbimit të pensionit

National Pension Centre
Tyneview Park
Whitley Road
Benton
Newcastle-upon-Tyne
NE98 1BA

Telefoni 0845 6060 265

8. Taksa e të ardhurave

- Është e rëndësishme që të kontrolloni çdo gjë që ka të bëjë me taksat tuaja për sa kohë që jeni në burg.
- Një organizatë që quhet Zyra e këshillimit të qytetarëve mund të vijë në burgun tuaj dhe mund t'ju ndihmojë që të rregulloni taksat e juaja.

Çfarë duhet bërë

- ✓ Kontaktoni zyrën tuaj të taksave nëse keni nevojë për ndihmë. Jepini atyre numrin tuaj të sigurimit kombëtar dhe numrin e referencës në qoftë se mundeni.
- ✓ Pyesni zyrën lokale të taksave nëse nuk jeni i sigurt cila zyrë takse është e juaja.
- ✓ Ju do t'ju duhet të plotësoni formularët tuaj të taksave nëse jua drëgojnë. Ose në rast se keni të ardhura duhet ti njoftoni.
- ✓ Dikush tjetër mund të kontaktojë zyrën e taksës në emër tuaj. Por ju duhet të jepni një autorizim me shkrim për të konfirmuar se ata mund ta bëjnë këtë gjë.
- ✓ Nëse punëdhënësi po jua mban punën e hapur për kohën që jeni në burg, kërkojini atyre që t'ju japin këtë angazhim me shkrim kështu në mënyrë që ju të keni një dokument.
- ✓ Ju mund të vazhdoni të merrni **ndihmën personale** në të holla gjatë kohës së qëndrimit në burg. Ndihma personale në të holla është sasia e të ardhurave që ju mund të fitoni çdo vit, pa paguar taksë për të.

Ju mund të kontaktoni zyrën tuaj të taksave për t'u informuar

- ✓ Nëse mund të transferoni në emër të gruas apo partneres tuaj taksën e kredit të fëmijëve, nëse ato punojnë.
- ✓ Nëse mund të merrni mbrapsht taksën e marrë nga interesi i bankës ose i llogarisë suaj. Për ta bërë këtë gjë ju duhet të plotësoni një formular.
- ✓ Nëse mund të merrni mbrapsht taksën mbi të ardhurat që keni paguar që nga 5 prilli, nëse keni pasur një punë dhe një dokument të quajtur P45.
- ✓ Ose merrni këshillë nëse jeni duke punuar për veten (i vetë-punësuar).

Njerëz që mund t'ju ndihmojnë në burg

- Ju mund të bisedoni me stafin e burgut për çdo problem që ju keni gjatë kohës që jeni në burg.
- Por ka edhe njerëz të tjerë që mund t'ju ndihmojnë.
- Stafi i burgut duhet t'ju tregojë se kush tjetër mund t'ju ndihmojë. Gjithashtu duhet të ketë informacion për këtë në krahun tuaj të burgut.

Këto është një listë e njerëzve të tjerë që mund t'ju ndihmojnë në burg. Ka njerëz të tjerë në faqen tjetër.

Nëse jeni i shqetësuar ose i mërzitur ose dëshironi të bisedoni me dikë, ju mund të flisni me

- ✓ **Një klerik ose me dikë tjetër që ka të bëjë me besimet.**
- ✓ **Samaritanët.** Nëse dëshironi të bisedoni me Samaritanët, tregojini punonjësve të burgut. Samaritanët janë njerëz me të cilët mund të bisedoni privatisht nëse ndiheni i mërzitur ose i shqetësuar ose mendoni se mund të lëndoni ose të vrisni veten. Samaritanët janë të gatshëm 24 orë në ditë. Ju mund të takoni një Samaritan, ti telefononi privatisht (ju duhet të pyesni për numrin lokal) ose t'i shkruani atyre në.
Chris
PO Box 9090
Stirling
FK8 2SA
- ✓ **Të burgosurit e tjerë të quajtur dëgjues ose shok.** Dëgjuesit janë të burgosur të cilët janë të trajnuar për t'ju dëgjuar dhe përkrahur nëse ndiheni i mërzitur ose i shqetësuar. Ata **nuk** do t'i tregojnë kujt çfarë bisedoni përveç rastit kur ata janë të shqetësuar se ju mund të lëndoni veten ose dikë tjetër. Disa burgje kanë gjithashtu shokë. Shokët janë të burgosur që ju dëgjojnë nëse keni nevojë për të biseduar. Shokët mund t'i tregojnë punonjësve të burgut gjërat që bisedoni nëse është nevoja.
- ✓ **Vizitorët zyrtarë të burgut.** Këta janë njerëz lokalë të cilët mund të vizitojnë të burgosurit që nuk kanë shumë vizitorë ose që kanë nevojë të bisedojnë me dikë jashtë burgut. Bisedoni me dikë që quhet oficeri ndërlidhës i vizitave zyrtare të burgut për të kërkuar të takoni një nga këta njerëz.

Nëse dikush po ju lëndon ose ushton dhunë kundrejt jush

- ✓ Bisedoni me **cilindo** anëtar të stafit të burgut menjëherë. Ata do jenë në gjendje t'ju ndihmojnë.

Ndihmë me gjëra të tjera

- ✓ **Organizata të tjera** gjithashtu ndihmojnë të burgosurit. Për shembull, Zyra e këshillimeve të qytetarëve ndihmojnë me të tilla gjëra si të hollat dhe ligji. Alkoolistët dhe Narkotikët anonimë japin ndihmë në lidhje me problemet e drogës ose alkoolit. Pyesni stafin e burgut çfarë ndihme mund të merrni në burgun tuaj.
- ✓ **Fondacioni Ura e re.** Kjo është një organizatë që ndihmon të burgosurit duke ardhur dhe i vizituar në burg dhe duke i ndihmuar ata të përgatiten për jetën pa burgut. Pyesni punonjësit e burgut nëse dëshironi t'ju vizitojë një vullnetar në burg. Ose mund të kontaktoni fondacionin Ura e re në

The New Bridge Foundation
27a Medway Street
London
SW1P 2BD
Telefoni 0207 976 0779

Me kë të bisedoni për problemet në burg

- ✓ **Bordi i monitorimit të pavarur.** Këta njerëz kontrollojnë burgjet për t'u siguruar që ato drejtohen në mënyrë të mirë e të drejtë. Ata nuk punojnë për burgun. Ata janë vullnetarë nga zona lokale. Nëse keni një ankesë që ka të bëjë me burgun ju mund të kërkonte të takoheni me dikë nga Bordi i monitorimit të pavarur ose edhe me të gjithë Bordin kur të vijnë herën tjetër në burg. Ju duhet të plotësoni një formular të veçantë për këtë. Formulari dhe fletëpalosja për Bordin e monitorimit të pavarur duhet të jetë në bllokun tuaj të burgut.
- ✓ Ju mund të ankoheni gjithashtu tek punonjësit e burgut ose dikush i quajtur Mbledhësi i ankesave të burgut dhe rehabilitimit. **Shihni faqen 115 për informacion të mëtejshëm.**

Kontakti me familjen dhe miqtë

Burgu juaj duhet t'ju ndihmojë të mbani lidhjen me familjen dhe miqtë.

Në burg ju mund

- të shkruani letra
- të bëni thirrje telefonike
- të vijnë njerëzit që t'ju vizitojnë.

Kërkojini një punonjësi të burgut t'ju ndihmojë për këto në qoftë se keni nevojë.

Vizitat nga familje ose miq

Pikat kryesore (pika të tjera gjenden në faqen tjetër)

- ✓ Përpara se dikush t'ju vizitojë në burg, ju zakonisht duhet të plotësoni një formular të quajtur **Urdhri i vizitës** (përveç rasteve kur ju jeni një i burgosur i padënuar ose civil)

Vizitat bëhen në një sallë në burg. Punonjësit e burgut do t'ju tregojnë në çfarë pjese të sallës të uleni.

- ✓ Guvernatori i çdo burgu vendos orarin dhe ditët e vizitave. Normalisht vizitat **nuk** bëhen në ditë festash (si Krishtlindje ose Pashkë).
- ✓ Punonjësve të burgut mund t'ju duhet të vendosin në qoftë se fëmijët mund t'ju vizitojnë apo jo. Kjo varet nga shumë gjëra si për shembull shkelja që keni kryer dhe sjellja e juaj në burg. Punonjësit e burgut do t'ju njoftojnë në të tilla raste.

Për të burgosurit e padënuar ose civil

- ✓ Deri tre të rritur dhe çdo fëmijë mund t'ju vizitojnë çdo herë. Ata të gjithë duhet t'ju vizitojnë në të njëjtën kohë. Dhe emrat e tyre duhet të jenë në Urdhrin e vizitës.
- ✓ Fëmijët zakonisht duhet të shoqërohen nga një i rritur. Por 16 deri më 18 vjeçarët mund t'ju vizitojnë të pa shoqëruar në disa burgje.
- ✓ Është gjithmonë mirë të dini kush po ju viziton. Në qoftë se një grup tjetër njerëzish vjen t'ju shohë në të njëjtën ditë, ata mund të mos lejohen.
- ✓ Do të gjeni informacion të mëtejshëm ne **Urdhrin 4410 të Shërbimit të Burgut**. Një kopje e tillë gjendet në bibliotekë.

Për të burgosurit e padënuar dhe civilë

Familja e juaj zakonisht duhet të telefonojë burgun për të caktuar një orar për vizitën. Ju **nuk** keni nevojë të plotësoni Urdhrin e vizitës.

- ✓ Ju zakonisht ju lejohen 3 vizita në javë. Këto vizita do të jenë nga 1 orë çdo radhë. 1 nga vizitat mund të caktohet në fundjavë.
- ✓ Në disa burgje ju mund të keni vizita më të shkurtra në më shumë ditë.
- ✓ Ju mund të siguron vizita më të gjata ose më të shpeshta. Kjo varet nga sjellja juaj dhe nga burgu që jeni. **Shihni faqen 64.**
- ✓ Deri në 3 të rritur dhe çdo fëmijë mund t'ju vizitojnë çdo herë.
- ✓ Në qoftë se do t'ju vizitojnë fëmijë të rritur, sigurohuni me punonjësit e burgut. Disa burgje i llogarisin fëmijët e rritur si të rritur.
- ✓ Ju mund të vizitoni dikë nga familja juaj i cili është i burgosur i padënuar në një burg tjetër. Kjo mund të ndodhë normalish vetëm në qoftë se ju të dy do të jeni në burg edhe në një muaj tjetër. Pvesni punonjësit e burgut nëse doni ta bëni këtë.

Për të gjithë të burgosurit e tjerë

- ✓ Ju mund të keni së paku dy vizita çdo 4 javë. Vizitat do të zgjasin 1 orë.
- ✓ Ju mund të siguroni më shumë vizita nëse silleni mirë ndërkohë që jeni në burg. **Shihni faqen 64.**

Si mund të caktoni një vizitë

1. Plotësoni një formë që quhet **Urdhër vizite**. Ju do të merrni një urdhër vizite të ri çdo 2 javë.
2. Shkruani në formë emrat e të gjithë personave që doni t'ju vizitojnë. Përfshini emrat e çdo fëmije që dëshironi t'ju vizitojë.
3. Dërgojani Urdhrin e vizitës 1 personi që ju dëshironi të shihni.
4. Njerëzit që ju vizitojnë duhet të sjellin formën me vete.

Informacion i mëtejshëm për vizitat

Të vizitoni dikë nga familja juaj në një burg tjetër

Ju mund të vizitoni një anëtar të afërm të familjes tuaj në një burg tjetër. Ju mund të aplikoni për këtë çdo 3 muaj. Të dy ju duhet të plotësoni një Urdhër vizite për këtë. Për tu caktuar kjo gjë mund të duhet pak kohë.

Në qoftë se jeni çuar në një burg larg familjes dhe miqve.

- Ju gjithashtu mund ti kurseni vizitat. Ju mund të kurseni më e pakta 3 deri në ndoshta 26 vizita. Këto quhen **vizita të grumbulluara**. Pyesni punonjësit e burgut se si ta bëni këtë. Mund t'ju duhet të prisni për këtë sepse burgjet janë të zënë.
- Ju mund të pyesni guvernatorin në qoftë se mund të lëvizni në një burg më afër familjes dhe miqve tuaj për një **kohë të shkurtër**. Ju mund ta bëni këtë kërkesë mbas 6 muajsh qëndrimi në burgun ku jeni.
- Ju duhet të ndiqni rregullat e vizitave të burgut tuaj të ri.
- Ju mund të filloni të kurseni vizita përsëri kur të ktheheni në burgun tuaj të vjetër.

Ndihmë me koston e udhëtimit të vizitorëve.

- Njerëzit që ju vizitojnë mund të marrin disa të holla për t'i ndihmuar ata me pagesën e udhëtimit të tyre kur ju vizitojnë. Për të marrë këtë ndihmë ata duhet të jenë mbi 18 vjeç, të jenë duke marrë ndonjë ndihmë sociale dhe të kenë të ardhura të ulta.
- Ata duhet të plotësojë një **formë** për të aplikuar për marrjen e të hollave nga një diçka të quajtur Skema e vizitave të ndihmuara të burgut.
- Do të gjeni informacion të mëtejshëm në **Urdhrin 4405 të Shërbimit të Burgut** dhe në sallën ku njerëzit ju vizitojnë.
- Ju mund ta gjeni formën për ta plotësuar në burg, në qendrën e vizituesve dhe sallën ku njerëzit takohen me ju ose duke kontaktuar grupin e Vizitave të ndihmuara të burgut

Assisted Prison Visits Unit
PO Box 2152
Birmingham
B15 1SD

Telefoni: 0845 300 1423 or 0121 626 2000
(të hënë deri të premte 10:15-11:45 dhe 14:15-15:45)
Tekstfon: 0845 304 0800 (i njëjti orar)

Letrat

Pikat kryesore

- ✓ **Urdhri 4411 i Shërbimit të Burgut ju** tregon se çfarë mund ose nuk mund të përmbajë letra juaj. Kërkojini stafit të burgut ndihmë nëse nuk jeni i sigurt se çfarë cilëson urdhri i burgut sepse duhet ti dini rregullat.
- ✓ Ju do të keni mundësinë të dërgoni 1 letër pa pagesë çdo javë. Kjo do të thotë që ju nuk duhet të paguani për pullën. Nëse jeni i burgosur i padënuar ju mund të dërgoni 2 letra në javë.
- ✓ Kjo nuk do të ndryshojë edhe nëse ju merrni ndonjë ndëshkim.
- ✓ Ju duhet të paguani për të dërguar letra të tjera.
- ✓ Ju mund të dërgoni një letër pa pagesë si zëvendësim i vizitës së dikujt, nëse ai person nuk mund t'ju vizitojë për ndonjë arsye.
- ✓ Ju mund të merrni një letër shtesë pa pagesë nëse keni nevojë të dërgoni një letër për një rast të veçantë ose urgjent. Për shembull, nëse duhet të lëvizni shpejt në një burg tjetër dhe duhet t'i tregoni familjes.
- ✓ Juve mund t'ju dërgojnë sa letra të dëshironi.

Sa private janë letrat e juaja?

- Të gjitha letrat që ju dërgoni dhe merrni do të hapen nga stafi i burgut. Ky kontroll kryet për t'u siguruar që nuk ka asgjë të palejueshme të dërguar me letrat. Kjo gjë bëhet për të tëra letrat me përjashtim të letrave nga avokatët, gjyqi dhe disa organizata të tjera mirë-besuese. **Shih faqen 47.**
- Stafi i burgut **nuk** i lexon shumicën e letrave. Por herë mbas here ata lexojnë një numër të vogël letrash.

Më shumë mbi letrat

- Punonjësit e burgut **mund** të lexojnë të gjitha letrat tuaja në qoftë se
 - ju jeni një i burgosur i Kategorisë A
 - ata mendojnë që ju mund të arratiseni nga burgu
 - ata mendojnë që ju mund të paraqisni rrezik për fëmijët (kjo do të kontrollohet së paku çdo 6 muaj)
 - ju jeni në paraburgim ose jeni dënuar për një vepër penale ngacmimi.
 - ju kanë dhënë një urdhër përmbajtje ose një urdhëresë gjyqi (kjo mund të kontrollohet së paku çdo 6 muaj)
 - nëse për ndonjë një arsye punonjësit e burgut mendojnë se përmbajtja e letrave mund të jetë e rrezikshme për burgun ose njerëzit e tjerë.

Thirrjet telefonike

Pikat kryesore (ka disa të tjera në faqen tjetër)

- ✓ Punonjësit e burgut do t'ju japin një formë në të cilën ju shkruani listën e numrave që ju mund të doni të telefononi. Për shembull, anëtarë të familjes, miq dhe avokatin tuaj.
- ✓ Punonjësit e burgut më vonë duhet ta miratojnë këtë listë. Në disa raste, ju mund të telefononi një numër pa qenë nevoja të miratohet nga punonjësit. Kjo varet se në cilën kategori sigurie jeni.
- ✓ Punonjësit e burgut do t'ju japin një numër të quajtur numër **PIN**. Ju duhet të formoni këtë numër përpara se të kryeni një telefonatë.
- ✓ Ju duhet të nënshkruani një letër për të thënë që pranoni disa rregulla për përdorimin e telefonit.

- ✓ Ju paguani për telefonatat duke blerë diçka të quajtur **kredit**. Kjo është një mënyrë ku ju paguani paraprakisht. Sa herë që bëni një telefonatë vlera në të holla e thirrjes ju zbritet.
- ✓ Ju mund të blini kredit nga dyqani i burgut me të hollat private ose ato të fituara.
- ✓ Ju mund të shpenzoni kohë më të gjatë në telefon varur nga sjellja e juaj në burg. **Shihni faqen 64.**
- ✓ Ju mund të përdorni një telefon që është më privat në qoftë se keni nevojë urgjente të bisedoni me avokatin. Ose për ndonjë arsye tjetër të rëndësishme. Guvernatori do të vendosë në qoftë se kjo është e mundur.

Do të gjeni informacion të mëtejshëm në kapitullin 4 të **Urdhrit 4440 të Shërbimit të Burgut 4440**. Një kopje e tillë gjendet në bibliotekë.

Në qoftë se familja ose miqtë tuaj jetojnë në një vend tjetër

- Përveç telefonatave të tjera, ju mund të bëni atyre 1 telefonatë në muaj **pa pagesë**. Telefonata mund të zgjasë 5 minuta. Ju nuk do ta merrni këtë telefonatë pa pagesë në qoftë se familja ose miqtë tuaj ju kanë vizituar në muajin e fundit.
- Të burgosurit e kombësive së huaja (njerëzit pa pasaportë të MB) ose të burgosurit me familje të afërme në një vend tjetër mund të përdorin më shumë të hollat e tyre për të telefonuar familje dhe miq në këtë vend.

Sa private janë telefonatat tuaja?

- Në qoftë se jeni një i burgosur klasifikimit të rrezikut të lartë ose të veçantë i kategorisë A, punonjësit e burgut do ti dëgjojnë **të gjitha** telefonat tuaja.
- Në qoftë se jo, punonjësit e burgut do të dëgjojnë **disa** nga telefonat tuaja.
- Punonjësit e burgut i dëgjojnë të dy palët në bisedën telefonike. Ata gjithashtu i incizojnë bisedat që të kenë një kopje të tyre.
- Punonjësit e burgut do t'ju tregojnë në qoftë se kjo ndodh në burgun tuaj.
- Punonjësit mund të ndërpresin bisedën nëse ju thoni diçka të palejueshme.
- Punonjësit nuk do të dëgjojnë telefonatat me avokatin tuaj ose me disa organizata të tjera private.

Martesa ose partneriteti civil

- Ju mund të aplikoni që të martoheni ose të bëni një partneritet civil gjatë kohës që jeni në burg.
- Për këtë gjë plotësoni një formë kërkesë ose shkruajini guvernatorit dhe jepjani letrën punonjësve të burgut për t'ja dërguar atij.
- Guvernatori do të vendosë në qoftë se martesa ose partneriteti civil duhet të bëhen në burg ose në zyrën e gjendjes civile më të afërt.
- Ju dhe partneri juaj duhet të organizoni çdo gjë. Për shembull ju duhet të kontaktoni njerëzit e duhur, të plotësoni format e caktuara dhe të paguani për çdo shpenzim.
- Përfaqësuesi klerik mund t'ju ndihmojë me një pjesë të organizimit.

Informacion i mëtejshëm

- Do të gjeni informacion të mëtejshëm për martesën në **Urdhrin 4450 të Shërbimit të Burgut**.
- Do të gjeni informacion të mëtejshëm për partneritetin civil në **Urdhrin 4445 të Shërbimit të Burgut**.

Kopje të këtyre urdhrave mund ti gjeni në bibliotekë.

Kontakti me avokatin tuaj dhe njerëz të tjerë zyrtarë

Letrat e dërguara dhe të marra nga avokati, gjyqi dhe organizata të tjera zyrtare

- Punonjësit e burgut **nuk** do ti hapin apo lexojnë letrat dërguar te avokati ose në gjyq për gjëra ligjore, përveç rasteve kur ka arsye shumë të fortë për ta bërë këtë gjë. Ky quhet **Rregulli 39** i postës.
- E njëjta gjë ndodh me letrat dërguar në disa organizata si avokati i popullit për burgjet dhe lirimin me kusht, deputeti i juaj dhe Samaritanët. Për një listë të organizatave të tilla shihni **Urdhrin 4411 të Shërbimit të Burgut**. Një kopje e tillë gjendet në bibliotek[.

Dërgimi i një letre tek avokati i juaj , gjyqi ose organizata të tjera zyrtare

Përveç emrit dhe adresës, ju duhet të shkruani edhe këto gjëra në zarf përpara se t'ja jepni punonjësit të burgut për ta dërguar.

- Shkruani **Rregulli 39 i Burgut** në zarfin e letrës që i dërgoni avokatit ose gjyqit.
- Shkruani **Për tu lexuar në mirëbesim** në zarfin e letrës që i dërgoni njerëzve të tjerë zyrtarë.

Të merrni letra nga avokati i juaj , gjyqi ose organizata të tjera zyrtare

Personi që po ju dërgon letrën duhet të shkruajë këto gjëra në zarf

- emrin dhe numrin tuaj të burgut
- adresën dhe numrin e telefonit të tyre
- Rregulli 39 i Burgut ose Për tu lexuar në mirëbesim
- avokati juaj duhet më pas ta nënshkruajë zarfin. Pastaj ta vendosi në një zarf tjetër dhe t'ja drejtojë guvernatorit. Ose mund të shkruajnë një shënim të shkurtër për ta shoqëruar letrën.

- Ju duhet të shkruani **Rregulli 39** në letër në qoftë se ka të bëjë me gjëra ligjore.
- Ju **nuk** duhet të fusni gjëra që nuk lejohen në letër
- Punonjësit e burgut mund ta hapin letrën përpara jush në qoftë se mendojnë se ka diçka që nuk shkon. Ata në fillim duhet të marrin leje nga guvernatori ose drejtori në qoftë se lejohen.

Vizitat dhe telefonatat prej avokatit tuaj, gjyqit ose organizatave të tjera zyrtare

- Avokati juaj vizitorë të tjerë zyrtarë (të tillë si persona që kanë të bëjnë me ligjin) mund t'ju vizitojnë ju në burg.
- Një oficer burgu do të jetë i pranishëm kur këta njerëz do t'ju vizitojnë. Por ata do të jenë në largësinë e duhur për të mos dëgjuar çfarë po flitet.
- Punonjësit e burgut **nuk** do të dëgjojnë asnjë telefonatë që ju bëni me avokatin ose me njerëz të tjerë ligjorë.

Kontakti me gazetat, TV, radion ose revistat

Ju mund t'i shkruani gazetave, TV, radios ose revistave për sa kohë që

- ju nuk i shkruani për ndonjë shkelje që keni kryer ose ndonjë shkelje të kryer nga ndokush tjetër (përveç rastit kur tregohet diçka serioze përmbi një krim, fajësi, drejtësi, dënim ose shërbimit të burgut)
- ju nuk do të shkruani për ndonjë të burgosur ose anëtarë të stafit kur është e qartë kush është ai njeri. Për shembull ju nuk mund të shkruani emrin e një personi.
- ju ndiqni rregullat për letrat
- ju **nuk** paguheni për çdo gjë që bëni (përveç rastit kur ju jeni një i burgosur i padënuar).

Ju duhet të pyesni guvernatorin ose drejtorin në qoftë se ju mund të merrni telefonata ose vizita nga gazetarë.

Do të gjeni informacion të mëtejshëm ne **Urdhrin 4470 të Shërbimit të Burgut**. Një kopje e tillë gjendet në bibliotekë.

Jeta në burg

Numri juaj i burgut

Ju do t'ju jepet një numër burgu kur të vini në fillim në burg. Numri nuk do të ndryshojë në qoftë se shkoni në një burg tjetër. Numri i ndihmon punonjësit e burgut për t'ju ndjekur ju dhe sendet e juaja.

Shënimet e burgut

Të dhënat e regjistruara të burgut janë **informacioni** që mban burgu për ju në dokumente dhe në kompjuter.

Këto përfshinë gjëra si

- emrin tuaj dhe datën e lindjes
- qelinë në të cilën jeni
- informacionin për kohën kur shkuat në gjyq
- ndonjë gjykim që mund të jetë marrë gjatë kohës së burgut
- informacioni mbi shëndetin tuaj
- informacioni për ndonjë punë ose edukim që ju po bëni.

Urdhrat e Shërbimit të Burgut (PSO) dhe Orientimet e Shërbimit të Burgut (PSI)

Këto shpjegojnë rregulloren e burgut (rregullat) dhe si funksionojnë burgjet.

Çfarë bëjnë punonjësit e burgut me informacionin për ju

- ✓ Punonjësit e burgut do ta mbajnë të fshehtë informacionin për ju. Por atyre mund t'ju duhet t'ia tregojnë këtë informacion të tjerëve si policisë dhe gjyqeve.
- ✓ Ju mund ta shikoni informacionin që burgu mban për ju. Kjo gjë do t'ju kushtojë £10 në qoftë se doni të shihni **të gjithë** informacionin.
- ✓ Për ta bërë këtë ju duhet të plotësoni një formë të quajtur **Forma e kërkesës së hyrjes së subjektit**. Pyesni një punonjës burgu për këtë. Ose mund të bëni një kërkesë me shkrim.
- ✓ Dërgojeni formën ose kërkesën tek zyra e disiplinës / mbajtjes ose departamenti i personelit.
- ✓ Ligji thotë që burgu duhet të mos ju tregojë disa informacione që mbahen rreth jush. Për shembull, ata nuk mund t'u japin informacion që po përdoret për të zgjidhur një krim.
- ✓ Do të gjeni informacion të mëtejshëm ne **Urdhrin 9020 i Shërbimit të Burgut**. Një kopje e tillë gjendet në bibliotekë.
- ✓ Për më tepër informacion se si burgjet e përdorin informacion rreth jush shkruajini

The information manager
H M Prison Service
Room 330
Bell House
John Islip Street

Kategoria e juaj e sigurimit

Fjalë ndihmuese

Burgje të hapur. Këto janë burgje në të cilët ju keni më shumë liri se burgjet e tjera për të lëvizur dhe për të bërë gjëra. Ju mund të keni qelinë tuaj me çelës. Ju mund të vendoseni në një burg të hapur në qoftë se stafi mendon që jeni i mirëbesueshëm.

Burgjet e mbyllura. Shumica e njerëzve në burgje janë në burgje të mbyllura. Këto burgje janë të sigurt dhe njerëzit nuk arratisen dot prej tyre.

Çfarë është kategoria e sigurisë tuaj?

- Kategoria e sigurisë tuaj është tipi i të burgosurit që ju jeni.
- Punonjësit e burgut do të shikojnë gjërat si për shembull nëse mos lëndoni të tjerët, ose mundoheni të arratiseni nga burgu, edhe sa i rrezikshëm mund të jeni në qoftë se arratiseni.
- Punonjësit e burgut do të vendosin çfarë kategorie sigurie do të jeni dhe pastaj do t'ju tregojnë.
- Në qoftë se jeni në një kategori të lartë sigurie (si A ose B) ju do të keni më pak liri se sa të burgosurit e tjerë për të bërë gjëra. Punonjësit e burgut do të bëjnë më tepër për t'ju kontrolluar dhe për t'ju ndaluar të arratiseni.
- Të rinjtë e dënuar kanë kategori të ndryshme nga të burgosurit e rritur.

Këto janë kategoritë e sigurisë për të rriturit

- 1. Kategoria A.** Kjo është kur punonjësit e burgut mendojnë që do të lëndoni dikë jashtë burgut dhe/ose ju mund të përpiqeni të arratiseni kështu që do të bëhet çdo gjë e mundshme për t'ju ndaluar të arratiseni.
- 2. Kategoria B.** Kjo është kur punonjësit e burgut mendojnë që ju nuk keni mundësi arratisje.
- 3. Kategoria C.** Kjo është kur punonjësit e burgut mendojnë që ju nuk do të mundoheni të arratiseni, por nuk mund të jeni të besuar në një burg të hapur.
- 4. Kategoria D.** Kjo është kur punonjësit e burgut mendojnë që ju jeni të besuar në një burg të hapur.

Këto janë kategoritë e sigurisë për të rinjtë e dënuar

- 1. Kategoria A.** Kjo është kur punonjësit e burgut mendojnë që do të lëndoni dikë dhe që çdo gjë e mundshme duhet të bëhet për t'ju ndaluar të arratiseni nga institucioni i të rinjtë të dënuar.
- 2. Statuti i kufizuar.** Kjo është kur punonjësit e burgut mendojnë që ju duhet të mbaheni në një pjesë të sigurt të institucionit për të rinjtë e dënuar.
- 3. Kushtet e mbyllura.** Kjo është kur punonjësit e burgut mendojnë që ju jeni në më pak rrezik po akoma jo i sigurt për të qenë në një institucionit të hapur të rinjtë të dënuar.
- 4. Kushtet e Hapura.** Kjo është kur punonjësit e burgut mendojnë që ju jeni të besuar në një institucion të hapur për të rinjtë e dënuar.

Kontrollimi i kategorisë së sigurimit tuaj për t'u siguruar që është i rregullt.

Punonjësit e burgut do të vazhdojnë t'ju kontrollojnë që ju jeni në kategorinë e sigurisë së duhur. Ata do ta ndryshojnë kategorinë e sigurisë tuaj në qoftë se ata mendojnë se ju jeni bërë më i sigurt ose më rrezikshëm.

- **Në qoftë se dënimi juaj është nga 1 deri 4 vjet**

Punonjësit e burgut do të rishqyrtojnë kategorinë e sigurisë tuaj çdo 6 muaj.

- **Në qoftë se dënimi juaj është më shumë se 4 vjet**

Punonjësit e burgut do të rishqyrtojnë kategorinë e sigurisë tuaj çdo vit.

- **Në qoftë se jeni një i burgosur i kategorisë A**

Punonjësit që punojnë në zyrën qendrore të Shërbimit të Burgut do ta rishqyrtojnë kategorinë e sigurisë tuaj.

- **Në qoftë se jeni një i burgosur i kategorisë D**

Punonjësit e burgut nuk kanë nevojë ta rishqyrtojnë kategorinë e sigurisë tuaj shpesh.

Ju mund të ankoheni për kategorinë e sigurisë tuaj në qoftë se mendoni se është gabim. **Shihni faqen 110.**

Ku do ta kryeni dënimin tuaj

- ✓ Ju do të filloni dënimin tuaj në një burg lokal ose një institucion lokal për të rinjtë e dënuar, afër gjyqit që ju dha dënimin.
- ✓ Ju mund të qëndroni në të njëjtin burg në qoftë se dënimi juaj është i shkurtër.
- ✓ Në qoftë se dënimi juaj është për një kohë më të gjatë, ju do të lëvizeni në një burg tjetër shumë shpejt.
- ✓ Ju **nuk** e zgjidhni dot burgun ku do të dërgoheni. Por ju mund të kërkonit që të lëvizni në një burg më afër familjes dhe miqve tuaj. Ata **mund** t'ju ndihmojnë për këtë.
- ✓ Mund të përballoheni me pritje të gjata për të lëvizur në një burg tjetër sepse ka shumë të burgosur që duan të lëvizin.

Llojet e ndryshme të burgjeve

1. Burgjet lokale

- Ju do të shkoni në fillim në një burg ose në një institucion lokal për të rinjtë e dënuar në qoftë se
 - jeni fajësuar ose dënuar në gjyq
 - jeni në paraburgim duke pritur për gjyqin tuaj.
- Ju do t'ju jepet këtu kategoria e sigurisë tuaj.
- Ju ose do të qëndroni këtu ose do të dërgoheni në një burg ose institucion tjetër për të rinjtë e dënuar. Kjo varet nga gjatësia e dënimit tuaj.
- Burgjet lokale janë të gjithë burgje të mbyllura.

2. Burgjet e trajnimit.

- Ju mund të dërgoheni në një burg të trajnimit shpejt mbas lëvizjes në burgun lokal.
- Burgjet e trajnimit mund të jenë burgje të hapura ose të mbyllura.
- Ju mund të ndiqni kurse dhe trajnime në këto burgje për t'ju ndaluar të kryeni një vepër penale tjetër kur dilni nga burgju. Mund t'ju duhet të prisni pak kohë përpara se të hyni në kurs ose trajnim.

3. Institucionet për të rinjtë e dënuar

- Këto janë vendet për të rinjtë e moshës nga 15 deri në 21 vjeç që kanë kryer një shkelje.

Më shumë mbi llojet e ndryshme të burgjeve

4. Burgjet e sigurisë së lartë

- Këto janë për të burgosurit që ju është dhënë një kategori sigurie A ose B.
- Ka 8 burgje të sigurisë së lartë në këtë moment. Ata janë: Belmarsh, Frankland, Full Sutton, Long Lartin, Manchester, Wakefield, Whitemoor, dhe Woodhill.

5. Burgjet që menaxhohen nga kompani private (disa herë të quajtur burgje të kontraktuara)

- Këto burgje menaxhohen nga kompani private.
- Të burgosurit ndjekin të njëjtat rregulla dhe kanë të njëjtat të drejta si të burgosurit në burgje të tjerë.
- Disa nga punonjësit janë ndryshe. Për shembull burgjet private janë të drejtuara nga dikush që quhet drejtor, jo guvernator.
- Oficerë e burgut quhen oficerët e mbajtjes.
- Ka 11 burgje private për momentin. Ata janë: Altcourse, Ashfield, Bronzefield (femra), Doncaster, Dovegate, Forest Bank, Lowdham Grange, Parc, Peterborough (meshkuj dhe femra), Rye Hill dhe The Wolds.

Çfarë mund ose nuk mund të mbani në burg

Pikat kryesore

- ✓ Ju nuk mund të mbani shumë gjëra në burg.
- ✓ Ju duhet t'jua jepni gjërat e tepërta që nuk mund t'i mbani vizitorëve kur vinë për t'ju takuar.
- ✓ Mund të jetë një ide e mirë që ti dërgoni jashtë ose t'jua jepni vizitorëve gjërat e vlefshme ose të kushtueshme që keni. Kjo bëhet sepse burgu nuk mundet të bëjë asgjë nëse gjërat tuaja humbin ose prishen, përveç rastit mund të vërtetohet që stafi i burgut e ka bërë këtë.
- ✓ Çdo gjë që ju nuk mund ta mbani ose t'ja jepni vizitorëve do të futet në një qese të vulosur dhe do të mbahet në një vend të sigurt brenda ose jashtë burgut deri kur të dilni.
- ✓ Punonjësit e burgut do t'ju kërkojnë që të firmosni një formë (karta e pronësisë) kur
 - ju shkoni në një burg dhe pranoni që keni parë çfarë punonjësit e burgut kanë futur në qese dhe qeset janë vulosur përpara syve tuaj.
 - kur ju hyni ose dilni në një burg të ri ku pranoni të thoni që sendet tuaja janë akoma në rregull
 - kur ju liroheni nga burgu dhe thoni që të gjitha sendet tuaja janë aty.
- ✓ Kur liroheni nga burgu ju do të merrni mbrapsht të gjitha sendet tuaja, përveç sendeve që nuk lejoheni të mbani ose sendet që janë kundra ligjit.

Çfarë mund të mbani në qelinë tuaj

- Ju mund të mbani aq sende në qelinë tuaj që të mund të futen në **2** kutia.
- Ju gjithashtu mund të mbani
 - një magnetofon ose diçka për të dëgjuar muzike në të.
 - diçka më të madhe. Për shembull, një kitarë
 - çfarëdolloj dokumentesh ligjore që jeni të lejuar të mbani.
- Punonjësit e burgut do të bëjnë shpesh kontrolle për të qenë të sigurt që ju nuk keni shumë sende, ose sende jo të duhura.
- Ju mund t'ju duhet të fitoni të drejtën për të mbajtur disa sende në qelinë tuaj. **Shihni faqen 64.**

Më poshtë vijon një listë e sendeve që ju mund të lejoheni t'i mbani në qeli. Sendet që lejohen mund të jenë të ndryshme për çdo burg dhe mund të varen nga kategoria e sigurisë tuaj.

Ju mund të mbani këto sende

- ✓ Gazeta, libra dhe revista.
- ✓ Diçka për të dëgjuar muzikë me kufje.
- ✓ Një kompjuter dhe gjërat që e shoqërojnë, si disketa.
- ✓ Gjërat që ju nevojiten për duhanin. Të burgosurit **e dënuar** mund të mbajnë deri në 62.5 gram duhan ose 80 cigare ose puro, ose një përzierje prej të dyjave.. Të burgosurit **e padënuar** mund të mbajnë deri në 137.5 gram duhan ose 180 cigare. Ju mund të lejoheni të pini duhan vetëm në qelinë tuaj.
- ✓ Disa lodra për të luajtur, duke përfshirë dhe lodrat elektronike.
- ✓ Disa sende që kanë të bëjnë me pasionet tuaja. Për shembull, art ose shkrim letrar.

Sendet e tjera që do të lejoheni të mbani në qelinë tuaj

- ✓ Një kafaz zogu dhe një zog të vogël (vetëm në burgjet që lejojnë kafaz me zog, shumë burgje nuk lejojnë).
- ✓ Një orë.
- ✓ Një pajisje elektrike për tu ruajtur.
- ✓ Sendet që ju ndihmojnë në qoftë se keni një paaftësi fizike.
- ✓ Bateri.
- ✓ Sendet e higjienës personale (të tilla si furçë dhëmbësh, pastë dhëmbësh dhe parfum).
- ✓ Një unazë martese ose një unazë tjetër të thjeshtë.
- ✓ Një medaljon ose medaljon që hapet.
- ✓ Librat ose sende të tjera që kanë të bëjnë me besimin tuaj. Dhe erë të mirë.
- ✓ Foto dhe piktura (në qoftë se ato janë në një kornizë pa xham).
- ✓ Kartolina përshëndetëse (të tilla si kartolina për ditëlindje, në qoftë se ato nuk kanë shumë shtresa).
- ✓ Një kalendar ose ditar ose organizues personal.
- ✓ Një libër adresash.
- ✓ Pulla dhe zarfe.
- ✓ Ilaçe (punonjësit do t'ju thonë nëse ju mund ti mbani ato në qelinë tuaj).

Në qoftë se shkoni në një burg tjetër dhe ju duhet ta kaloni natën diku

Ju mund të merrni këto sende: sapun, shtupë, krehër, furçë dhëmbësh, pastë dhëmbësh, brisk rroje, krem rroje, shampo, parfum, radio, libër, stilolaps dhe letër. Është detyra juaj ti ruani sendet tuaja dhe të siguroheni që ato janë të siguruara.

Paratë tuaja

Pikat kryesore

- ✓ Miqtë ose njerëzit e familjes suaj mund t'ju dërgojnë të holla kur ju jeni në burg.
- ✓ Këto para quhen **të holla personale**.
- ✓ Të hollat nuk mund ti merrni menjëherë. Ato do të ruhen për ju nga burgu.
- ✓ Ju mund t'i shpenzoni të hollat. Shuma sa mund të shpenzoni varet nga sjellja juaj në burg.
- ✓ Për shembull, në qoftë se ju jeni një i burgosur i dënuar ju mund të shpenzoni £4.00, £15.50 or £25.50 në javë. Kjo varet se sa mirë silleni.
- ✓ Në qoftë se ju jeni një i burgosur i pa dënuar ju mund të shpenzoni £22, £47.50 ose £51.00 në javë në vartësi të sjelljes tuaj.
- ✓ Ju mund të informoheni më tepër në **faqen 64**.
- ✓ Guvernatori juaj mund t'ju lejojë të shpenzoni më shumë nga paratë tuaja. Për shembull, në qoftë se ju nevojiten para për gjëra ligjore, ose në qoftë se ju jeni i burgosur i një kombësie të huaj dhe ju keni nevojë të telefononi familjen tuaj në një shtet tjetër.

Si mund t'ju dërgojnë para në burg miqtë ose familja juaj

- Ata duhet të përpiqen të dërgojnë çeqe ose urdhra poste. Këto duhet ti paguhen **Shërbimit të Burgut** të MS dhe të dërgohen tek **guvernatori**.
- Nëse ata kanë nevojë të dërgojnë para dorazi ata duhet të shkruajnë një shënim të bashkangjitur me letrën ku thuhet se sa para ndodhen në zarf.
- Ata duhet të shkruajnë këto të dhëna në zarf
 - emrin e tyre dhe adresën
 - emrin tuaj dhe numrin e burgut .

Dyqani i burgut – i quajtur edhe mensa

- ju mund të blini sende në dyqan çdo javë si për shembull duhan, bateri, ëmbëlsira dhe sende tualeti (sende si furçë dhëmbësh dhe parfum).
- Dyqanet në secilin burg do të kenë sende të ndryshme.
- Nëse keni nevojë për diçka të veçantë si ndonjë gjë për lëkurën ose flokët tuaj atëherë pyesni dyqanin në qoftë se ata mund ta porositin atë për ju.
- Ju mund të lejoheni të blini sende nga disa shoqëri tregtare me porosi (kjo është e mundshme kur shoqëritë tregtare ju dërgojnë çfarë ju keni blerë me postë). Pyesni punonjësit e burgut për të dhëna të mëtejshme për këtë.

Pirja e duhanit

- Vendi i vetëm ku ju mund të pini duhan brenda ndërtesës së burgut është në qelinë tuaj. Ju duhet ta mbani derën e qelisë të mbyllur kur të pini duhan.
- Në qoftë se ju nuk pini duhan, ju **nuk** keni për të qëndruar në një qeli me dikë që pi duhan.

Më shumë rreth pirjes së duhanit

Ju nuk mund të pini duhan fare

- në vendet për njerëzit nën 18 vjeç
- në mjetet e transportit të burgut
- në qelitë me shumë krevate (dhoma fjetjeje)
- në qelitë ose zonat në të cilat punonjësit e burgut ju thonë nuk mund të pini.

Kërkoni ndihmë nga punonjësit e kujdesit shëndetësor nëse dëshironi të lini duhanin.

Ushqimi

- Burgjet duhet të bëjnë kontrolle për t'u siguruar që ushqimi që ata ju japin ju është i mirë sa duhet.
- Flisni me punonjësit e furnizimit (punonjësit të cilët punojnë në kuzhinën e gatimit) në qoftë se keni ndonjë problem me ushqimin.
- Përpara orarit të ngrënies, ju mund të zgjidhni prej menysë, ushqimin që dëshironi të hani.

Menyja duhet të përmbajë

- Diçka me mish ose peshk
- Ushqim vegjetarian
- Ushqim vegan
- Ushqim "hallal"
- Ushqim "kosher"
- Ju mund të zgjidhni të hani oriz në vend të patateve.
- Në qoftë se keni nevojë të hani ushqim të veçantë për shkak të shëndetit tuaj, punonjësit e kujdesit shëndetësor do t'ju tregojnë rreth kësaj.
- Burgu mund të jetë në gjendje të marrë për ju ushqim të veçantë që ka të bëjë me besimin tuaj fetar kur ka një festë fetare ose ngjarje.

Veshjet

Të burgosurit e dënuar

- Ju duhet të vishni veshjet që ju jep burgju. Këto veshje përfshijnë ndëresa të brendshme, çorape dhe këmisha.
- Punonjësit e burgut duhet të sigurojnë që këto veshje janë të pastra, në gjendje të mirë dhe t'ju mbajnë ngrohtë dhe të shëndetshëm.
- Punonjësit e burgut duhet të sigurojnë që ju japin shpesh veshje të pastra.
- Në disa burgje ju ndoshta nganjëherë mund të lejoheni të vishni veshjet tuaja në qoftë se ju silleni mirë në burg. **Shihni faqen 64.**

Të burgosurit e padënuar

- Ju mund të vishni rrobat tuaja për aq kohë sa të jenë në rregull për t'u veshur në burg dhe janë të pastra e të rregullta.
- Por mund t'ju kërkohet të vishni rrobat që ju jep burgju nëse
 - ju jeni në një i burgosur i kategorisë së sigurisë A
 - guvernatori mendon që ju mund të mundoheni të arratiseni. Atëherë ju duhet të vishni rroba që e bëjnë më të lehtë për punonjësit t'ju shikojnë në qoftë se përpiqeni të arratiseni.
 - ju jeni duke shkuar në gjyq. Nëse kjo ndodh, punonjësit e burgut do të bëjnë çdo gjë që munden të ndalojnë njerëzit e tjerë për t'ju parë me këto rroba.
- Familja dhe miqtë tuaj mund t'ju sjellin veshje dhe mund të marrin rroba për t'i larë.
- Ju duhet të vishni veshjet e juaja kur
 - jeni në gjyq
 - largoheni nga burgju nëse nuk jeni dënuar.
- Kërkojini punonjësve të burgut veshje nëse nuk ju keni mjaft veshje tuajat.

Shtrojet - çarçafët dhe batanijet për krevatin tuaj

- Shtrojet duhet të jenë
 - të pastra dhe në kushte mjaft të mira
 - të ngrohta.
- Dyshekët dhe shtretërit duhet të ajrosen të paktën 1 orë në javë.
- Ndodhet një lavanteri (ku ju mund të lani rrobat) në burg. Ju keni të drejtë të lani atje rrobat dhe shtrojet një herë në javë.

Vaskat, dushet dhe banjat

- Ju duhet të keni të drejtë të përdorni banjat dhe lavamanët në çdo kohë.
- Ju duhet të keni të drejtë të bëni një vaskë të nxehtë ose dush së paku 3 herë në javë.
- Punonjësit e burgut mund t'ju japin juve sende të higjienës personale (një furçë dhëmbësh dhe parfum) nëse ju nuk keni para të mjaftueshme për t'i blerë vetë.

Koha jashtë në ajër të pastër

- Të gjithë të burgosurit duhet të kalojnë ndërmjet 30 minuta deri në 1 orë çdo ditë jashtë në ajër të pastër. Koha që lejoheni jashtë është e ndryshme në çdo burg.
- Ndonjëherë kjo nuk mund të ndodhë. Për shembull, në qoftë se moti është i keq, ose ka një arsye tjetër për t'ju mbajtur ju brenda.
- Ju keni të drejtë të bëni disa ushtrime fizike si ecje. Punonjësit e burgut do t'ju tregojnë se çfarë lloj ushtrimesh fizike ju mund të bëni në burgun tuaj.
- Shumë burgje kanë caktuar kohë kur ju bëni fizkulturë (të tilla si sport) si dhe të tjera aktivitete kështu që ju mund të shpenzoni kohë larg qelisë tuaj.

Stimuj dhe privilegje të përfituar (gjithashtu të quajtur IEPs)

Kjo është për gjërat shitesë që ju mund të merrni ose të bëni nëse ju

- zbatoni rregullat
- merrni pjesë pozitive në punë dhe aktivitete të tjera të tilla si plani i dënimi i tuaj.
- gjërat shitesë që ju mund të keni ose bëni janë të ndryshme në çdo burg.

Për shembull, në qoftë se ju zbatoni rregullat dhe silleni mirë në burg ju mund të kryeni gjëra të tilla si

- të shpenzoni më tepër nga të hollat e juaja
- të keni më tepër vizita nga familjarët dhe miqtë tuaj
- të përfitoni më tepër të holla
- të keni një televizor në qelinë tuaj
- të vishni rrobat tuaja
- të shpenzoni më tepër kohë jashtë qelisë tuaj.

Por, këto gjëra mund t'ju hiqen në qoftë se ju nuk zbatoni rregullat.

Si funksionon

Në varësi të sjelljes tuaj stafi i burgut do t'ju njoftojë sa gjëra shitesë mund të merrni ose të bëni. Ka **3** nivele të IEP-së.

Niveli fillestar. Nëse jeni në nivelin fillestar do të thotë që ju mund të keni disa gjëra të vendosura nga ligji, si disa letra dhe vizita. Nuk do t'ju lejohen asnjë gjë shitesë.

Niveli standard. Kjo do të thotë që mund t'ju lejohen më tepër vizita dhe letra. Ju mund të lejoheni të keni një televizor në qelinë tuaj dhe të shpenzoni më tepër nga të hollat tuaja.

Niveli i përparuar. Kjo do të thotë që ju mund të keni akoma më tepër gjëra shitesë. Për shembull mund t'ju lejohen më tepër vizita një televizor në qelinë tuaj, ose të shpenzoni më tepër nga të hollat tuaja.

Shëndeti juaj

Pikat kryesore – pika të tjera në faqen tjetër.

Shëndeti juaj fizik

- ✓ Të burgosurit mund të marrin të njëjtin kujdes shëndetësor si çdokush tjetër jashtë burgut.
- ✓ Është caktuar një zonë në burg për shëndetin shëndetësor. Mund të ketë dhe një spital në burg.
- ✓ Burgu do të ketë një ekip mjekësor. Këta janë njerëzit që kujdesen për shëndetin tuaj të tillë si mjekët, infermieret dhe dentistët.
- ✓ Ju mund të merrni shumë të dhëna për kujdesin shëndetësor në burg.
- ✓ Të gjithë punonjësit shëndetësorë janë trajnuar në të njëjtin nivel të lartë si edhe punonjësit e tjerë jashtë burgut.
- ✓ Tregojini punonjësve shëndetësore në qoftë se
 - Keni ndonjë problem me gjërat si droga dhe alkooli
 - Ju keni SIDËN ose HIV-në
 - Ju duhet të merrni mjekim.

Shëndeti i juaj mendor

Shumë njerëz në burg kanë nevoja të kujdesit mendor. Këta janë njerëzit që mund t'ju ndihmojnë.

Tregojini punonjësve shëndetësorë nëse

- ✓ Keni pasur një psikiatër ose një infermierë psikiatër të komunitetit ose keni qëndruar në spital për arsye të shëndetit mendor.
- ✓ Merrnit mjekim në komunitet për shëndetin tuaj mendor.
- ✓ Ndiheni të shqetësuar dhe të prekur.
- ✓ Ndiheni të mërzhitur dhe me depresion.
- ✓ Ndiheni të merakosur dhe të frikësuar.
- ✓ Keni vështirësi në gjumë ose ndiheni shumë të lodhur.
- ✓ Mendoni që njerëzit flasin për ju.
- ✓ Po dëgjoni zëra brenda kokës.
- ✓ Ndiheni i inatosur.
- ✓ Ndiheni i shpërqendruar dhe nuk mbani mend.
- ✓ Mendoni të njëjtat mendime gjatë gjithë kohës.

Punonjësit e shëndetësisë në burg

Disa nga punonjësit e shëndetësisë që punojnë në burg janë

- mjekët
- infermierët
- dentistët
- farmacistët (këta janë ata njerëz që punojnë në farmaci dhe ju japin mjekimin e dhënë me recetë nga mjeku)
- punonjësit që ju ndihmojnë me problemet e drogave dhe alkoolit.
- stafi që ju ndihmon me problemet e shëndetit mendor. Këta punonjës quhen psikiatër dhe psikologë
- stafi që iu ndihmon me shëndetin tuaj seksual ose shëndetin e përgjithshëm.

Takimi me mjekun ose infermierin

- Tregojini oficerit të bllokut të burgut nëse keni nevojë të shihni një mjek ose infermiere. Infermierët dhe farmacistët mund të shqyrtojnë shumë probleme pa pasur ju nevojë për të takuar mjekun. Nëse jeni akoma i shqetësuar kërkoni të shihni mjekun.
- Ju mund të kërkoni të shihni dikë tjetër të ekipit të kujdesit shëndetësor në qoftë se ju nuk jeni të kënaqur me çfarë ju tha mjeku, infermieri, ose punonjësi i shëndetësisë për problemin tuaj shëndetësor.
- Në qoftë se problemi juaj nuk mund të shqyrtohet nga punonjësit e shëndetësisë në burg, një nga mundësitë e më poshtme mund të ndodhë
 - punonjësit e burgut mund të marrin një mjek specialist që vjen në burg për t'ju vizituar
 - ju mund të çoheni në një burg tjetër për të marrë kujdesin shëndetësor që ju nevojitet.
 - ju mund të dërgoheni në një spital jashtë burgut. Edhe në qoftë se kjo ndodh, burgu do të jetë i përgjegjshëm për ju.

Takimi me dentistin ose okulistin (për sytë)

- Tregojini punonjësve të burgut nëse keni nevojë të vizitoheni tek një dentist ose një okulist.
- Çdo trajtim do të jetë pa pagesë, përveç rasteve kur trajtimet nuk bëhen për arsye mjekësore.
- Ju do t'ju jepen syzet pa pagesë ose dhe gjëra të tjera në qoftë se keni nevojë.

Mjekimi

- Ju **nuk** mund të mbani në burg mjekime që sillni me vete.
- Tregojini punonjësve në recepsion, mjekut ose një anëtar të ekipit mjekësor në qoftë se po merrni ndonjë mjekim.
- Një mjek në burg do t'ju japi një recetë për çdo mjekim që keni nevojë. Ju mund ta merrni këtë mjekim nga farmacia e burgut.
- Ju mund të lejoheni ti mbani ilaçet tuaj mbas kësaj. Punonjësit e burgut do të vendosin në qoftë se kjo është e mundur dhe do t'ju njoftojnë ju për këtë.

Shënimet tuaja të shëndetit (punonjësit e shëndetësisë mund të mbajnë shënime për problemet shëndetësore dhe kujdesin që merrni, ne letër ose në kompjuter)

- Burgu zakonisht do të fillojë një kartelë të re shëndetësore kur të arrini në burg. Burgu zakonisht **nuk** do të ketë kartelën tuaj të vjetër shëndetësor nga jashtë burgut.
- Mjekët e burgut mund të marrin të dhënat nga kartela juaj e vjetër në qoftë se nevojitet. Po në fillim ju duhet ta pranoni këtë.
- Ju mund të kërkoni për të shikuar shënimet e kartelës tuaj të shëndetit në qoftë se dëshironi. Normalisht ju mund të shihni informacionin që mban burgu për shëndetin tuaj. Por mund të ketë informacion që nuk lejohet për t'u parë.
- Pyesni një anëtar të ekipit shëndetësor në qoftë se dëshironi të shihni kartelën tuaj të shëndetësisë. Ose plotësoni një formë për të kërkuar të shihni kartelën tuaj të shëndetësisë.
- Një përgjigje nga punonjësit e burgut për informacionin e kërkuar nga ju, nuk duhet të vonojë me shumë se 40 ditë. Në qoftë se kartela juaj e shëndetësisë ndodhet në një burg tjetër, ajo do të dërgohen tek burgu juaj.
- Ju **mund** të shihni informacionin për shëndetin tuaj që mjeku i paraqet gjyqeve ose Bordit të lirimimit para kohe me kusht, përveç rastit kur mjeku urdhëron që kjo të mos bëhet.

Problemet shëndetësore dhe sëmundjet

HIV dhe SIDA

- AIDS shkaktohet nga një virus i quajtur **HIV** (Virusi njerëzor i mungesës imunitare).
- Njerëzit me HIV në fillim marrin SIDA-n.
- SIDA ndodh më vonë kur trupi i një personi nuk mund të ndalojë veten të preket nga sëmundjet.
- Njerëz me HIV mund të duken e të ndihen mirë. Por ata përsëri mund ta shpërndajnë HIV-në tek njerëz të tjerë.

Si ju mund ta merrni HIV / SIDA

- Ju mund të merrni HIV në qoftë se gjaku ose sperma e dikujt me HIV futet në trupin tuaj.
- Mënyrat kryesore që mund të merrni HIV-në janë nëpërmjet
 - seks pa prezervativë.
 - shkëmbim shiringash ose punësh (për shembull, për marrje droge, tatuazhe, ose shpim veshësh ose trupi). Punët është një term tjetër për shiringat dhe pajisjet për të injektuar drogë rrugësh.

Ju **nuk mund** të merrni HIV-në prej dikujt duke bërë gjëra të përditshme të tilla si

- duke folur me ta
- duke i shtrënguar dorën
- duke i prekur kur ti kaloni
- duke përdorur të njëjta pjata thika dhe pirunë
- duke përdorur të njëjtën banjë

Kurat dhe mjekimet

- **Nuk** ka kurë për HIV-në ose SIDA-n. Por ka mjekime që ju mund të merrni që kontrollojnë HIV-në dhe nëse keni SIDA.

Çfarë mund të bëni

Të mbroni veten kundrejt HIV-së/ SIDA

- ✗ **Mos** kryeni seks pa mbrojtje.
- ✗ **Mos** shkëmbeni shiringa me askënd për dhe për **asnjë arsye.**

Nëse jeni të shqetësuar për HIV-në/ SIDA-n

- ✓ Ju mund të bisedoni më vete me një anëtar të ekipit mjekësor.
- ✓ Ose mund të kërkontë të bisedoni me një këshillues ose një anëtar të ekipit të quajtur Ekipi i menaxhimit të sëmundjeve infektuese.
- ✓ Ju mund të bëni testin e HIV-së në burg. Rezultati i këtij testi do të jetë **privat.**
- ✓ Kërkojini ekipit shëndetësor prezervativë, bllokues dentare (për seks gojor) ose lubrikues për seks nëse keni nevojë. Ekipi shëndetësor duhet t'ju japi këto sende nëse ata mendojnë se ka një rrezik që ju mund të merrni HIV-në.
- ✓ Nëse për ndonjë arsye shkëmbeni shiringat me njerëz të tjerë, flisni me dikë në ekipin shëndetësor. Ata mund t'ju japin diçka për t'i bërë shiringat dhe sendet e tjera (punët) të pasta.

Hepatiti B dhe Hepatiti C

- Këto janë viruse që ju mund të merrni prej dikujt tjetër. Ju mund ti merrni ato me anë të gjakut të dikujt ose duke bërë seks me ta.
- Ka një vaksinë që ju mund të merrni për Hepatitin B por jo për Hepatitin C. Vaksina është diçka që ju mund të merrni për të ndaluar marrjen e infeksionin në fillim.
- Bisedoni me dikë nga ekipi shëndetësor nëse jeni të shqetësuar për Hepatitin B ose C ose nëse kërkon më shumë të dhëna.

Sëmundjet dhe infeksionet e transmetuara seksualisht – sëmundje që ju mund të merrni duke kryer seks me dikë. Gjithashtu të quajtura STD

- Ka një shumëllojshmëri sëmundjesh infeksionesh të transmetuara seksualisht. Disa shembuj janë klamidia dhe herpesi gjenital.
- Shumica e tyre mund të trajtohen dhe kurohen nëse ju vizitoheni nga punonjësit e shëndetësisë përnjëherë.
- Shumica e burgjeve kanë punonjës shëndeti të specializuar me të cilët mund të bisedoni për çdo problem shëndetësor që ka të bëjë me seksin. Por shumica e mjekëve dhe punonjësve të tjerë të shëndetit gjithashtu mund të trajtojnë sëmundjet e transmetuara seksualisht dhe infeksionet.
- Bisedoni me ekipin shëndetësor nëse jeni të shqetësuar se keni marrë sëmundje duke bërë seks. Ju mund të bisedoni me ta privatisht.

Problemet e drogës dhe të alkoolit

Pikat kryesore

- ✓ Në qoftë se ju keni ndonjë problem me alkoolin ose drogat, kërkoni ndihmë nga një pjestar i ekipit shëndetësor sa më shpejt që të jetë e mundur.
- ✓ Ata do të bëjnë të mundur që ju të merrni llojin e ndihmës më të mirë.
- ✓ Ju mund t'ju ofrohet shumë ndihmë për të ndaluar përdorimin e drogës ose alkoolit në burg.
- ✓ Tregojini oficerit tuaj personal ose një anëtar tjetër të stafit të burgut nëse të burgosurit e tjerë po mundohen që t'ju bëjnë të përdorni drogë ose alkool ose ti sillni këto në burg.

Testimi juaj për drogë

Punonjësit e burgut mund të bëjnë një analizë tek ju për të parë në qoftë se ju keni marrë drogë. Për të bërë këtë ata do të marrin një analizë të urinës tuaj dhe do ta analizojnë atë për të parë në qoftë se ajo tregon ndonjë shenjë marrje droge.

- Ju mund të testoheni për drogë ndërkohë që jeni në burg nëse
 - Punonjësit vendosin t'ju testojnë ju. Punonjësit e burgut do të zgjedhin rastësisht për të analizuar çdo muaj një numër të vogël të burgosurve
 - punonjësit e burgut mendojnë që ju mund të keni marrë drogë
 - ju keni përdorur shumë drogë në të kaluarën dhe keni pasur testime që tregojnë ju keni marrë drogë të shkallës A gjatë kohës në burg. Nëse kjo ndodh ju mundeni të testoheni shumë shpesh.

Më tepër rreth testimit të drogës

- Punonjësit duan të sigurohen që ju nuk keni marrë drogë para se t'ju lejojnë të bëni gjëra të përcaktuara. Për shembull, para se t'ju lejojnë për një kohë të shkurtër jashtë burgut, ose para se t'ju lejojnë të keni një punë që do të përfshijë besimin e të tjerëve.
- Ju mund të analizoheni nëse dërgoheni në një burg tjetër ose kur të arrini në burg në fillim.

Çfarë do të ndodhë kur bëni një analizë droge?

1. Punonjësit e burgut do t'ju tregojnë ju çfarë po ndodh dhe arsyen përse po kryeni analizën e drogës.
2. Ju duhet ti jepni punonjësve të burgut një kampion urine për ta testuar.
3. Ju mund ta bëni këtë në fshehtësi por punonjësit e burgut duhet të jenë të bindur që ju nuk po i bëni diçka kampionit tuaj të urinës.
4. Kampioni juaj i urinës do të testohet në një vend të quajtur laborator për t'u siguruar që nuk përmban drogë.
5. Punonjësit e burgut do t'ju japin rezultatet e analizës sa më shpejt që të jetë e mundur.
6. Punonjësit e burgut do t'i tregojnë ekipit shëndetësor në qoftë se rezultatet tregojnë marrje droge. Kjo bëhet për t'u siguruar që ju nuk jeni duke marrë ndonjë mjekim që mund të ndikojë rezultatin e analizës. Ju duhet bini dakord përpara se punonjësit e burgut t'i tregojnë ekipit shëndetësor.
7. Nëse testi tregon që ju keni marrë drogë ju duhet të pohoni se jeni **fajtor** ose i **pafajshëm** për marrje droge. Ju duhet të shkoni në një gjykim për të dëshmuar për këtë. (ka më shumë të dhëna për këtë më poshtë).

Nëse deklaroheni i pafajshëm

- Ju do të bëni dhe një test tjetër për të parë nëse rezultati i testit të parë ishte i drejtë apo i gabuar.
- Nëse rezultatet i këtij testi janë të njëjta ju mund të dërgoni analizën në një laborator jashtë burgut për ta analizuar përsëri.
- Punonjësit e burgut do t'ju japin disa dokumente nëse rezultati i analizës tregon që ju keni marrë drogë ose nëse keni dëshirë të paguani për një analizë të mëtejshme. Këto dokumente quhen
 - Informacioni i të burgosurve në analizën e detyruar të drogës
 - Informacioni i avokatëve dhe i të burgosurve për të marrë analizën e pavarur të testit të detyrueshëm të drogës.

Nëse pranoni se jeni fajtor ose nëse analiza akoma tregon që keni marrë drogë

1. Nëse keni marrë drogë, do të thotë që keni shkelur **Rregullin e Burgut numër 51(9)** ose **Rregullin e shkelësit të ri numër 55(10)**.
2. Ju zakonisht do të paditeni për shkelje dhe duhet të shkoni në një seancë gjyqësore. Një seancë gjyqësore ndodh kur ju dhe guvernatori ose gjykatësi nga jashtë burgut bisedoni për shkeljen dhe vendosni nëse jeni i fajshëm.
3. Nëse jeni gjetur fajtor, burgu do të vendosi cila është gjëja më e mirë për të bërë. Ju mund të merrni një ndëshkim ose do t'ju hiqen disa nga privilegjet. Ose ju mund të dërgoheni të merrni ndihmë për problemin tuaj të drogës. Për shembull tek një grup i quajtur CARAT (Këshillim, Vlerësim, Referim, Këshillë dhe Kujdes i Përgjithshëm).

Kur i kërkonti punonjësve të bëni një analizë për drogë (kjo quhet analiza me dëshirë e drogës)

Ju mund të kërkonti të kryeni analiza e drogës nëse dëshironi. Ju mund të dëshironi të bëni këtë sepse ju kërkonti të ndaloni përdorimin e drogave. Punonjësit e burgut do t'ju ndihmojnë sa shumë që të jetë e mundur nëse pohoni se do të ndaloni përdorimin e drogës.

Ka 2 gjëra që mund të bëni

1. Kërkonti të shkoni në një pjesë të burgut të quajtur **qendra e analizës me dëshirë të drogës**. Kjo është një pjesë e sigurt e burgut ku ju mund të qëndroni dhe të merrni ndihmë për të ndaluar përdorimin e drogave. Ju do t'ju duhet të nënshkruani një formë ku thuhet që ju pranoni disa rregulla për praninë tuaj në këtë pjesë të burgut. Ju gjithashtu do të keni disa analiza droge.
2. Ju mund të vazhdoni të merrni ndihmë për të mos iu afruar drogave pa pasur nevojë të lëvizni në një pjesë tjetër të burgut. Ju mund të kërkonti të jeni pjesëtar i një programi të quajtur programi i analizave me dëshirë të drogave. Ju duhet të nënshkruani një formë ku pranoni që do të ndiqni rregullat për këtë. Ju gjithashtu do të keni disa analiza droge.

- ✓ Ju duhet të nënshkruani një formë ku thoni që pranoni të ndiqni disa rregulla nëse kërkonti të ndaloni përdorimin e drogës.
- ✓ Forma do t'ju tregojë çfarë do të ndodhë nëse analiza tregon se jeni duke marrë drogë akoma.
- ✓ Ju do të merrni një ndëshkim nëse kapeni duke marrë drogë. Por punonjësit e burgut mund të bëjnë gjëra të tjera si t'ju heqin nga ajo pjesë e burgut.

- Në disa burgje, ju mund të merrni gjëra shtesë të quajtura privilegje, nëse pranoni të merrni analizën e drogës dhe analiza tregon që nuk po merrni drogë. Për shembull, ju mund të merrni më shumë vizita ose të lejoheni të shpenzoni më shumë nga të hollat e juaja.
- Pyesni punonjësit e burgut për këtë. Ju duhet të nënshkruani një formë ku thoni që pranoni të ndiqni disa rregulla dhe do të ndaloni marrjen e drogës. Forma do t'ju tregojë çfarë duhet të bëni dhe çfarë do të ndodhë nëse jeni kapur duke marrë drogë përsëri.

Ndihma që mund të merrni për problemet e drogës dhe alkoolit

Çdo i burgosur mund të marrë ndihmë për ndalimin e përdorimit të drogës dhe alkoolit

Ju mund të merrni ndihmë prej

- 1. Ekipit shëndetësor.** Ata mund të bëjnë shumë për t'ju ndihmuar të mos merrni më drogë ose alkool.
- 2.** Ju mund të merrni ndihmë përgjatë kohës që jeni në bllokun tuaj të burgut ose duke lëvizur në një tjetër pjesë të burgut të quajtur qendra e analizës me dëshirë të drogës. **Shihni faqen 76.**
- 3. Shërbimi CARAT** (Këshillim, Vlerësim, Referim, Këshillë dhe Kujdes i Përgjithshëm). Këta janë njerëz jashtë burgut ose janë oficerë burgu. Ata punojnë të ndihmojnë të burgosurit të ndalojnë përdorimin e drogës. Ju mund të takoni dikë nga CARAT shumë shpejt mbasi vini në burg. Ata do të punojnë me ju për të përgatitur një plan që t'ju ndihmojë të ndaloni përdorim e drogës.
- 4. Programet e rehabilitimit të drogës.** Personi nga CARAT me të cilin ju po punoni mund t'ju tregojë për një larmi tjetër ndihmash që mund të merrni. Punonjësi i juaj i CARAT-it duhet së pari të thotë se është në rregull që ju të merrni këtë ndihmë. Ju mund ta merrni këtë ndihmë nëse lëvizni në një burg tjetër.

Me këtë larmi ndihmash, ju mund t'ju duhet të bëni analiza për testim droge. Nëse jeni zbuluar duke marrë drogë ju mund t'ju ndalohet kjo ndihmë.

- Mos u shqetësoni për bisedën me njeriun që ju ndihmon për përdorimin e drogës. Ata do t'ju tregojnë çfarë informacioni ata mund të mbajnë privat dhe çfarë informacioni ata mund t'ia tregojnë të tjerëve.
- Nëse ju jeni i shqetësuar për dikë në familjen tuaj që merr drogë, ose se si po ndikon në ta problemi i juaj i drogës, bisedoni për këtë me dikë nga CARAT. Personi i CARAT-it mund të sigurojë që familja juaj të marrë ndihmë ose informacion.

Besimi juaj

- ✓ Ju keni të drejtë ta ushtroni besimin tuaj në burg.
- ✓ Ju mund t'i tregoni punonjësve të burgut të çfarë besimi jeni kur ju të arrini në burg. Atëherë ata do t'ju ndihmojnë juve të merrni çfarë keni nevojë për të ushtruar besimin tuaj.
- ✓ Burgu duhet t'ju sigurojë që të ketë një vend ku ju mund të shkoni të ushtroni besimin tuaj. Për shembull, për të thënë lutjet ose për të shkuar në takimet besimtare.
- ✓ Çdo burg do të ketë një ekip njerëzish për t'ju ndihmuar të ushtroni besimin tuaj. Ky quhet **ekipi klerik**.
- ✓ Ju mund të kërkonte të shihni klerikun edhe në qoftë se nuk jeni besimtar. Klerikët janë aty për të dëgjuar çdo të burgosur që kërkon dikë për të biseduar. Për shembull, në qoftë se ata ndihen të lënduar ose të shqetësuar.
- ✓ Burgu do të shënojë datat dhe oraret për lutjet dhe festat e shërbimeve besimtare dhe festivalet fetare.
- ✓ Ju mund të shkoni gjithmonë në shërbimin kryesor për besimin tuaj. Për shembull, ju mund të shkoni edhe në qoftë se jeni në izolim, në listën e të arratisurve ose në spital. Tregojini klerikut përpara shërbimit në qoftë se ju dëshironi akoma të shkoni tek shërbimi.
- ✓ Bisedoni me një nga klerikët ose me dikë që quhet **punonjësi i shumëllojshmërisë** në qoftë se nevojat tuaja besimtare nuk janë plotësuar në burg.
- ✓ Informacion i mëtejshëm gjendet në **Urdhrin 4550 të Shërbimit të Burgut**. Një kopje e tillë gjendet në bibliotekë.

Njerëzit që mund t'ju ndihmojnë të ushtroni besimin tuaj

- Ekipi i klerikëve është një ekip me njerëz prej besimeve të ndryshme të cilët ju ndihmojnë të ushtroni besimin tuaj.
- Ekipi është i ndryshëm në çdo burg por zakonisht në këto ekipe do të ketë klerikë të cilët janë prej këtyre besimeve dhe feve
 - Kishës së Anglisë
 - Katolikë, Metodistë dhe Kishat të Lira
 - Myslimanë
 - Budistë
 - Hebrenj
 - Indianë
 - Sikë

Njerëzit e feve ose besimeve të tjera mund të vinë në burg në qoftë se nevojitet.

Rastafarismi nuk është i njohur si një besim në burg, por ekipi i klerikëve do të mundohet t'ju ndihmojë nëse ju jeni një Rastafarian. Ju do të keni mundësi të ushqeheni me ushqim vegjetarian ose vegan, dhe do t'ju sigurohen dhe sende të tjera që ju nevojiten, si libra.

Të siguroheni që punonjësit e burgut e dinë besimin tuaj

- Ju duhet t'i tregoni punonjësve të burgut kur arrini në fillim në burg në qoftë se kërkonit të ushtroni fenë tuaj. Kjo bëhet me qëllim që punonjësit të sigurojnë gjithçka që keni nevojë për ushtrimin e fesë tuaj.
- Kur arrini në burg në fillim ju do t'ju kërkohet të cilësoni i çfarë besimi jeni. Ju mund t'i tregoni punonjësve çfarë besimi keni, ose mund ti tregoni që nuk keni ndonjë besim.
- Kjo quhet **regjistrimi** i besimit tuaj.

Më shumë për besimin tuaj

- Në qoftë se ju dëshironi të merrni pjesë në shërbimet fetare ose aktivitetet mbas tyre, ju do të drejtoheni tek shërbimet e besimit që jeni regjistruar.
- Një klerik do t'ju vizitojë shumë shpejt mbasi të arrini në burg në fillim për t'u siguruar që besimi i caktuar është regjistruar për ju dhe për të mësuar në qoftë se keni nevoja fetare.

Në qoftë se doni të ndryshoni besimin

- Ju mund ta ndryshoni besimin në të cilin jeni regjistruar në një tjetër.
- Ju duhet të plotësoni një formë dhe ta nënshkruani në të cilën tregoni se ju dëshironi të ndryshoni në një fe tjetër.
- Ekipi i klerikëve do tu ndihmojë ju për të gjetur klerikun e duhur të fesë tuaj.

Në qoftë se kërkoni të takoni një klerik të një besimi tjetër pa ndryshuar fenë tuaj

Ju mund ta bëni këtë për sa kohë që

- Guvernatori dhe klerikët janë të kënaqur që ju me të vërtetë kërkoni të mësoni më tepër për, ose të ushtroni një besim tjetër.
- Guvernatori dhe klerikët mendojnë që ju po e bëni këtë për një arsye të shëndoshë dhe për të mos krijuar probleme.

Vajtja në shërbimet ose aktivitete të tjera fetare

- Burgu duhet të lejojë 1 orë së paku në çdo javë për aktivitete fetare.
- Ekipi i klerikëve do t'ju tregojnë datat dhe orarin e shërbimeve fetare, takimeve ose aktiviteteve.
- Ju mund të shkoni te shërbimi kryesor i besimit tuaj të regjistruar.
- Ju mund të shkoni tek aktivitete të tjera të besimit tuaj për sa kohë që ka vende të tjera bosh.
- Ju mund të shkoni në një shërbim fetar edhe në rastin kur keni pohuar që nuk keni besim.
- Ju mund të shkoni në takimet e besimeve të ndryshme. Bisedoni me klerikun tuaj për këtë në fillim.
- Disa herë aktivitete të tjera që kryeni në burg, si ushtrimet e përditshme ose vizitat, ndodhin në të njëjtën kohë me gjëra të rëndësishme të besimit tuaj. Në qoftë se kjo ndodh, punonjësit e burgut mund t'ju ndihmojnë të shkoni në ngjarjen e besimit tuaj.

Çfarë mund të bëjë kleriku për ju

- Klerikët mund t'ju ndihmojnë që të mbaheni në kontakt me botën jashtë burgut. Për shembull, ata mund të sigurojnë vizitën në burg të një personi fetar prej kishës, xhamisë, tempullit ose komunitetit tuaj.
- Ata gjithashtu mund t'ju ndihmojnë të mbani kontakt me familjen tuaj. Ata mund të bashkëpunojnë me familjen tuaj ose njerëz të tjerë për këtë gjë, të tillë si shërbimi i rehabilitimit.
- Në qoftë se jeni nga një shtet tjetër (një i burgosur i kombësisë së huaj) kleriku mund t'ju ndihmojë që të mbani kontakte me familjen tuaj në atë shtet..

Ndihmë tjetër. Për shembull, me gjërat e tilla si, lirimi me kusht

- Ju mund ti kërkonte klerikut që të thotë ose të shkruajë diçka mbi ju për çdo raport që është plotësuar për ju gjatë kohës së qëndrimit tuaj në burg.
- Punonjësit e burgut do të shkruajnë raporte rreth jush me informacione mbi sjelljen tuaj, dhe gjërat që keni kryer të tilla si punë ose edukim. Këto raporte do të përdoren për të marrë vendime mbi ju. Për shembull, njerëzit nga Bordi i Lirimit para kohe me kusht do të shikojnë raportet për të vendosur në qoftë se ju mund të merrni lirim para kohe ose jo.

Rregullat e burgut

Pikat kryesore

- Rregullat e burgut zbatohen në çdo burg por guvernatori mund të ketë edhe rregulla vendoret brendëshme.
- Kur prishni rregullat e burgut kjo quhet një **shkelje**.
- Ju mund të paditeni për shkelje dhe mund t'ju jepet një ndëshkim.
- **Rregulli i burgut me numër 51** dhe **Rregulli i institucionit të të rinjve të dënuar me numër 55** i përshkruajnë këto shkelje.
- Rregullat e burgut mund të jenë të vështira për t'u kuptuar. Ju mund t'i shihni në një libër të quajtur Udhëzuesi i disiplinës në burg. Kjo gjithashtu quhet **Urdhri 2000 i shërbimit të burgut 2000**. Një kopje e librit duhet të jetë në secilin bllok dhe në bibliotekë.

Nëse kryeni ndonjë nga gjërat e renditura në faqet e mëposhtme, do të thotë që ju keni shkelur rregullat e burgut dhe keni kryer një shkelje.

Të sjellurit në mënyrë që mund të ofendojë, kërcënojë ose të lëndojë dikë tjetër

- Në qoftë se ofendon ose qëllon një njeri ose ziheni me ndonjë.
- Në qoftë se ofendon ose qëllon një njeri për arsye të racës (raca nënkupton gjëra të tilla si ngjyra e lëkurës dhe e kaluara dhe kultura e tyre).
- Në qoftë se thoni ose bëni diçka që mund të lëndojë, kërcënojë ose frikësojë dikë tjetër. Dhe në qoftë se e bëni këtë për arsye të racës së dikujt.
- Në qoftë se mbani dikë larg nga njerëz të tjerë, në qoftë se ata nuk dëshirojnë këtë. Për shembull, në qoftë se i ndryni diku.
- Nëse silleni në një mënyrë që mund të vërë në rrezik dikë tjetër ose të dëmtoni shëndetin tuaj.
- Në qoftë se ju jeni të pasjellshëm kundrejt çdonjërit që punon në burg ose në institutin e të rinjve të dënuar ose çdo personi që viziton.

Të pengosh punonjësit e burgut të kryejnë detyrën e tyre

- Në qoftë se ju pengoni ndonjë njeri që punon në burg për të shkuar atje ku kanë nevojë në burg. Për shembull, me anë të ndërtimit të një barrikade për të ndaluar dikë të hyjë në qelinë tuaj.
- Në qoftë se ndaloni ndonjë që punon në burg për të kryer detyrën e tyre.

Arratisje nga burgu

- Në qoftë se arratiseni nga burgu ose mbajtja. Për shembull, në qoftë se largoheni me vrap nga rojet.
- Në qoftë se nuk ktheni kur jeni lejuar të dilni nga burgu për një kohë të shkurtër. Kjo quhet mosparaqitje.

Droga dhe alkooli

- Në qoftë se jeni urdhëruar për të analizuar urinën dhe kjo tregon që keni marrë ndonjë drogë që nuk lejoheni ta merrni, dhe në qoftë se e keni marrë kur keni qenë jashtë burgut për një kohë të shkurtër.
- Në qoftë se vendosni të merrni alkool ose drogë ose jeni gjetur i dehur mbasi keni pirë alkool.

Të shkaktosh dëme në burg ose në institucionin e të rinjve të dënuar

- Në qoftë se i vini zjarrin ndonjë pjese të ndërtesës ose ndonjë gjëje në të.
- Në qoftë se ju dëmtoni ose shkatërroni ndonjë pjesë të ndërtesës ose ndonjë gjëje në të.
- Në qoftë se vendosni ndonjë gjë në mure ose shkruani ose vizatoni ndonjë gjë që të shqetësojë, kërcënojë ose të frikësojë ndonjë njeri.
- Ose në qoftë se ju bëni ndonjë nga këto gjëra për arsye të racës së dikujt.

Sendet që mund ose nuk mund të mbani

- Në qoftë se ju keni diçka që nuk e keni të lejuar. Për shembull, një telefon celular, një thikë ose drogë.
- Në qoftë se keni më shumë se sa duhet të një gjëje të veçantë që nuk e keni të lejuar.
- Në qoftë se pranoni nga dikush që ju viziton diçka që nuk ju lejohet në burg. Për shembull drogë.
- Në qoftë se shisni ose jepni diçka që nuk ju lejohet në burg.
- Në qoftë se shisni ose i jepni diçka një personi që vetëm juve ju lejohet ta keni.
- Në qoftë se merrni ose vidhni prej një personi tjetër ose prej burgut ndonjë gjë që nuk është e juaja.

Të qenit në një vend në të cilin nuk duhet të jeni

- Në qoftë se ju largoheni nga një vend në të cilin duhet të jeni.
- Në qoftë se ju shkoni në një vend në të cilin **nuk** duhet të jeni.

Mos zbatimi i udhëzimeve të stafit të burgut

- Në qoftë se ju është kërkuar që të bëni punë dhe në qoftë se ju **nuk** e bëni si duhet ose nuk e bëni fare.
- Në qoftë se ju **nuk** ndiqni një urdhër ose rregulloren që duhet të ndiqni.
- Në qoftë se ju shkelni ndonjë nga rregullat e burgut ose mundoheni të ndihmoni dikë tjetër që ta bëjë atë.

Shkelja e rregullave kur jeni jashtë burgut për një kohë të shkurtër.

- Në qoftë se ju shkelni rregullat në rast se jeni të lejuar jashtë burgut për një kohë të shkurtër. Kjo ka të bëjë me **Rregullin e Burgut numër 9** ose **Rregulloren e Institutit të rinjve të dënuar numër 5**.

Shkelja e rregullave të burgut

Kur ju thyeni rregullat e burgut kjo quhet **shkelje**.

Çfarë ndodh në qoftë se ju bëni një shkelje?

1. Një oficer burgu do t'ju njoftoj përnjëherë (ose brenda **48** orësh) në qoftë se ata mendojnë që ju keni bërë një shkelje dhe çfarë shkelje kjo është. Ata do t'ju japin një formë që do t'ju tregojë për shkeljen.
2. Ju duhet të shkoni në një dëgjim gjyqësor (gjithashtu i quajtur gjykim). Kjo ndodh kur ju dhe stafi i burgut bisedoni për shkeljen dhe për atë që të gjithë ju mendoni që ndodhi. Ky dëgjim gjyqësor do të drejtohet nga guvernatori ose nga dikush jashtë burgut i quajtur një gjykatës i pavarur.
3. Në dëgjimin gjyqësor, ju duhet të thoni nëse e pranoni ose jo fajësinë për shkeljen.
4. Guvernatori ose gjykatësi i pavarur do të vendosi në qoftë se ju jeni i fajshëm ose i pafajshëm për shkeljen. Ato do ta bëjnë këtë mbasi të kenë dëgjuar ju dhe njerëzit e tjerë të cilët kanë dijeni për çka ka ndodhur.
5. Në qoftë se ju gjendeni fajtor, ju do t'ju jepet një ndëshkim. Ka një listë ndëshkimesh **në faqen 87**. Në qoftë se ju gjendeni i pafajshëm nuk do të ndodhi asgjë më tepër.

Ndëshkimet

Pikat kryesore

- ✓ Ndëshkimet që merrni përshkruhen në **Rregullin e burgut 55 & 55A** dhe **Rregulli i të rinjve shkelës 60 & 60A**.
- ✓ Ndëshkimi që do merrni varet nga sa e rëndë është shkelja.
- ✓ Burgu mund të përshijë policinë në qoftë se ata mendojnë që është një shkelje e rëndë.
- ✓ Në qoftë se ju kryeni më shumë se 1 shkelje ju do të ndëshkoheni për secilën nga ato. Ndëshkimet mund të renditen njëri pas tjetrit.
- ✓ Ju mund të shpenzoni ditë më shumë ditë në burg në qoftë se shkelja është aq e rëndë.
- ✓ Por në qoftë se do tu jepen ditë më shumë, numri i ditëve më shumë për secilën shkelje nuk duhet të jetë më shumë se 42.
- ✓ Çdo ndëshkim përveç këshillimit mund të pezullohet deri në 6 muaj. Kjo do të thotë se ndëshkimi i juaj mund të fillojë në qoftë se ti bën një shkelje tjetër në atë kohë.
- ✓ Një guvernator mund t'ju japi çdo lloj dënimi përveç ditëve shtesë.
- ✓ Një gjykatës i pavarur (një gjykatës i qarkut) është i vetmi person që mund tu japë ditë shtesë, si edhe çdo dënim tjetër.

Këtu më poshtë është një listë e ndëshkimeve që mund të merrni nëse kryeni një shkelje

- Ju mund të merrni një këshillim.
- Privilegjet (si televizori në qelinë tuaj) mund t'ju hiqen deri në 42 ditë. Ose deri në 21 ditë për një të ri shkelës.
- Mund t'ju mbahen deri 84 ditë pune pagesë. Deri 42 ditë për një të ri shkelës. Megjithatë ju do të merrni mjaft të holla për të blerë pulla poste dhe të bëni telefonata për të qenë në kontakt me familjen tuaj.
- Ju mund të mbylleni në qeli vetëm dhe larg të burgosurve të tjerë deri në 35 ditë. Ose deri në 16 ditë për një të ri shkelës mbi 18 vjeç. Ky quhet izolim. Ju do të vizitoheni nga mjeku ose infermieri në fillim për t'u siguruar që ju jeni i shëndetshëm për ta bërë këtë.
- Ju mund të mos lejoheni të punoni me të burgosur të tjerë deri në 21 ditë.
- Në qoftë se ju jeni në paraburgim privilegjet tuaja mund të ndalohen.
- Ju mund të largoheni nga blloku i burgut ose qendra e banimit për deri 28 ditë. Ose deri 21 ditë për një të ri shkelës.

Këto ndëshkime janë vetëm për një të rinjtë shkelës

- Ju mund të mos lejoheni të merrni pjesë në aktivitete deri në 21 ditë.
- Ju mund të bëni 2 orë më shumë punë në ditë për deri 21 ditë.

Ditë shtesë

- Në qoftë se shkelja është e rëndë juve mund t'ju jepen deri 42 ditë shtesë në burg dhe çdo ndëshkim tjetër.
- Ditët shtesë nuk janë pjesë e dënimit tuaj por ju do të qëndroni më shumë kohë në burg.
- Vetëm gjykatësit e pavarur (ata janë gjykatës të qarkut) mund t'ju japin ditë shtesë.

Më tepër për ditët shtesë

- Në qoftë se jeni në paraburgim, ju do të kryeni ditët shtesë vetëm në rast se jeni dënuar dhe ju është dhënë një dënim me burg.
- Ju nuk do t'ju jepen ditë shtesë në qoftë se jeni i dënuar me burgim të përjetshëm, jeni burgosur për të mbrojtur publikun, jeni i burgosur civil, ose një shtetas i huaj i mbajtur brenda derisa çështja e imigracionit të zgjidhet.

Gjykimet e burgut – gjithashtu të quajtura seanca

Pikat kryesore

- ✓ Ju duhet të paraqiteni në një seancë burgu për të folur mbi shkeljen.
- ✓ Seanca do të drejtohet ose nga guvernatori ose një gjykatës i qarkut nga jashtë burgut (i quajtur gjykatës i pavarur).
- ✓ Seanca do të mbahet zakonisht ditën mbasi punonjësit e burgut t'ju kenë njoftuan për shkeljen që ata mendojnë se ju keni kryer.
- ✓ Ju do të keni së paku 2 orë për tu përgatitur për seancën.
- ✓ Ju mund të mbaheni veças të burgosurve të tjerë derisa të zhvillohet seanca juaj.
- ✓ Ju do të keni mundësinë për të treguat se çfarë mendoni ju se ka ndodhur.
- ✓ Ju gjithashtu mund të merrni dëshmitarë për të dëshmuar në seancë.
- ✓ Ju mund të keni mundësinë të merrni disa njerëz të tjerë për t'ju ndihmuar. Për shembull, një avokat ose dikë të quajtur një mik i McKenzie-it. **Shihni faqen 94.**
- ✓ Bisedoni me një punonjës burgu ose avokatin në qoftë se nuk kuptoni çfarë po ndodh ose keni nevojë të bëni pyetje.

Çfarë do të ndodhë përpara seancës?

- Ju do të vendoseni **në raport**. Kjo ndodh kur një oficer burgu do t'ju tregojë për shkeljen që ata mendojnë se keni kryer.
- Oficeri i burgut duhet t'ju tregojë përnjëherë (ose brenda 48 orëve) çfarë shkelje mendojnë ata që keni kryer.
- Seanca do të bëhet zakonisht një ditë pas (përveç rastit kur është ditë e dielë ose ditë festash).
- Ju do të keni së paku dy orë për t'u përgatitur për seancën.

Juve do t'ju jepen **2** forma përpara seancës.

1. **Forma 1127A**. Kjo ju tregon për shkeljen që oficeri i burgut mendon që keni kryer. Ju **duhet** të tregoni në qoftë se nuk kuptoni çfarë është shkruar në këtë formë.

2. **Forma 1127C**. Kjo ju tregon çfarë do të ndodhi në seancë.

Në këtë formë ju mund të

- shkruani një deklaratë për atë çfarë mendoni që ndodhi. Bëjeni këtë mbrapa formës. Kërkoni për më tepër letër në qoftë se ju nevojitet
- shkruani emrin e ndonjë dëshmitari që kërkoni të vijë në seancë, në qoftë se i dini kush janë ata në këtë kohë. Ju mund të pohoni në seancë se cilët dëshironi si dëshmitarë në qoftë se keni dëshirë.

Më shumë për seancat

- Ju mund tu kontrollohet shëndeti nga një mjek ose infermiere përpara seancës për t'u siguruar që jeni në gjendje të mirë shëndetësore për të shkuar në gjykim.
- Ju mund të mbaheni të veçuar nga të burgosurit e tjerë deri në seancën tuaj.

Çfarë të bësh përpara seancës

- ✓ Mendohuni për çfarë doni të thoni në seancë.
- ✓ Mendohuni në qoftë se ndonjë njeri tjetër pa se çfarë ndodhi. Ata mund të jenë dëshmitarë për ju në seancë.
- ✓ Mund të jetë e dobishme për ju që të lexoni një libër që quhet Udhëzuesi i disiplinës së burgut para seancës. Ky gjithashtu quhet **PSO 2000**. Një kopje e këtij libri gjendet në bllokun tuaj dhe në bibliotekën e burgut. Kërkoni të lexoni një kopje në qoftë se nuk shkoni dot në bibliotekë.
- ✓ Ju mund të kërkoni që seanca të shtyhet për një datë më vonë në qoftë se ju nuk e keni lexuar Udhëzuesin e disiplinës së burgut para seancës suaj.
- ✓ Në qoftë se e ke të vështirë të lexosh ose të shkruash, ose nuk kupton diçka, atëherë kërkoni ndihmë një punonjësi burgu ose avokatit tuaj.

Çfarë do të ndodhë në seancë?

1. Guvernatori do të kontrollojë në qoftë se
 - ju i keni format **1127A** dhe **1127C**
 - ju e kuptoni përse ndodheni në seancë dhe çfarë do të ndodhë
 - ju keni kohë të mjaftueshme për t'u përgatitur për seancën. Për shembull, për t'u menduar çfarë kërkoni të thoni në seancë.
 - Ju kërkoni ndonjë ndihmë, si këshillim ligjor ose një përkthyes
2. Dikush do të lexojë me zë padinë. Padia është shkelja që punonjësit e burgut mendojnë që keni kryer.
3. Ju do t'ju pyesin të thoni nëse jeni **fajtor** ose i **pafajshëm** për shkeljen.

Në qoftë se e pranoni fajësinë

- Oficeri i burgut që ju vendosi në raport do të lexojë një deklaratë për atë çfarë ka ndodhur.
- Ju pastaj duhet të thoni çfarë mendoni për këtë. Për shembull ju mund të bëni pyetje.
- Tregoni në qoftë se **nuk** e pranoni atë çfarë ka thënë oficeri i burgut. Ju gjithashtu mund të kërkonti të thërrisni dëshmitarë në qoftë se **nuk** e pranoni atë që oficeri i burgut ka thënë.
- Guvernatori duhet të shqyrtojë gjithçka që ju thoni se nuk e pranoni.
- Guvernatori mund të vendosi që faktet janë të drejtë dhe nuk ka më asgjë për t'u shqyrtuar. Në qoftë se është kështu, ai ose ajo do t'ju pyesin në qoftë se kërkonti të bëni një **pranim fajësie me rrethana lehtësuese**. Kjo është kur ju i thoni guvernatorit ndonjë gjë që mendoni se do ta bëjë shkeljen tuaj të duket më pak e rëndë.
- Atëherë një anëtar i personelit të burgut do t'ju lexojë me zë informacionin se si ju jeni sjellë që kur ju mbërritët në burg. Dhe rreth ndonjë seance që keni pasur më parë.
- Më pas ju mund të thoni se çfarë mendoni rreth informacionit që ata ju kanë lexuar me zë.
- Atëherë guvernatori to t'ju komunikojë se cili është ndëshkimi juaj. Më pas juve do t'ju jepet një kopje e formës që shpjegon se cili është ndëshkimi juaj. Forma quhet **Forma 256D**.
- Në çdo moment kur guvernatori mendon se shkelja juaj është mjaft e rëndë për të marrë ditë shtesë, ai do ti kërkojë një gjykatësi të pavarur ta shqyrtojë çështjen tuaj.
- Ju mund të prisni deri më 28 ditë për të parë gjykatësin e pavarur.

Në qoftë se ju nuk pranoni fajësinë, ose nuk jeni i sigurt se si ti drejtoheni gjyqit

- Oficeri i burgut që ju vendosi në raport do të lexojë një deklaratë për atë çfarë ata mendojnë se ka ndodhur.
- Ju pastaj duhet të thoni se çfarë mendoni për këtë ose të bëni pyetje.
- Guvernatori do ti bëjë oficerit të burgut disa pyetje. Ata gjithashtu mund të dëgjojnë disa dëshmitarë.
- Ju dhe guvernatori mund t'i bëni pyetje dëshmitarëve.
- Pastaj do të pyeteni se çfarë mendoni për padinë (çfarë thonë punonjësit e burgut që keni kryer) dhe evidencën që kanë dhënë.
- Ju mund të thërrisni dëshmitarë për të folur në favorin tuaj në qoftë se dëshironi (përveç rastit kur guvernatori mendon që ka një arsye shumë të fortë që ata mos të paraqiten).
- Ju, oficeri i burgut dhe guvernatori mund t'i bëni pyetje dëshmitarëve.
- Ju do të keni mundësinë të cilësoni arsyet kryesore pse mendoni që jeni i pafajshëm.
- Guvernatori do t'ju komunikojë vendimin që ai ose ajo ka marrë. Ky quhet gjykimi. Guvernatori duhet të jetë shumë i sigurt që ju e keni kryer këtë shkelje përpara se ai ose ajo t'ju ngarkojë me faj.
- Në qoftë se ju jeni gjetur të fajshëm guvernatori do t'ju komunikojë dënimin. Guvernatori do t'ju japë një kopje të një forme që ju tregon dënimin tuaj. Forma quhet **256D**.
- Në çdo kohë kur guvernatori mendon se shkelja juaj është mjaft e rëndë dhe duhet të marrë ditë shtesë, ai do ti kërkojë një gjykatësi të pavarur ta shqyrtojë çështjen tuaj.

Ndihmë të mëtejshme që mund të merrni në seancë

Ju mund të merrni këto lloj ndihmash në seancën tuaj

- këshillë ligjore
- përfaqësim ligjor (një avokat që vjen në seancë për t'ju përfaqësuar)
- një mik ose këshillues që vjen në seancë (ky person quhet një mik i McKenzie-it). Ky person mund të vijë dhe të mbajë shënime dhe t'ju japi këshilla. Por ata **nuk mund** t'ju përfaqësojnë dhe mund të flasin vetëm në qoftë se guvernatori pranon. Miku i juaj i McKenzie-it mund të jetë dikush si kleriku, një oficer burgu ose një i burgosur tjetër.

Në qoftë se seanca drejtohet nga guvernatori

Ju **mund** të merrni këshillë ligjore. Kjo mund të bëhet me anë të telefonit, letrës ose duke u takuar me avokatin tuaj.

Ju **nuk mund** të merrni përfaqësi ligjore përveç rasteve kur guvernatori thotë që ju mundeni të merrni për shkak të gjërave si

- sa seriozë është shkelja dhe ndëshkimi që mund të merrni
- çështje të mundshme që mund të dalin rreth ligjit.
- sa jeni në gjendje të kuptoni për atë se ç'ka ndodh
- gjërat që mund të ngadalësojnë ose të shkaktojnë probleme. Për shembull, në qoftë se keni pasur probleme për t'u përgatitur për mbrojtjen sepse keni qenë të izoluar nga të burgosurit e tjerë.

Ju **nuk mund** të keni një mik të McKenzie-it ose një këshilltar te këto lloj seancash.

Por ju mund të jeni në gjendje të merrni një mik të McKenzie-it ose një këshilltar në qoftë se ju nuk kuptoni se çfarë po ndodh, çështja është shumë e vështirë ose guvernatori mendon që është e drejtë që ta lejojë këtë.

Në qoftë se seanca është drejtuar nga një gjykatës i pavarur (një gjykatës i qarkut)

- Ju **mund** të merrni gjithmonë përfaqësim ligjor (një avokat që vjen t'ju përfaqësojë).
- Guvernatori ose oficeri i shërbimeve ligjore mund t'ju ndihmojnë me problemet që keni për të marrë përfaqësim ligjor.

Të kërkosh rishqyrtimin e çështjes ose të dënimit

Ju mund

- ✓ Të kërkoni rishqyrtim në qoftë se mendoni që seanca u zhvillua në mënyrë të gabuar ose ju mendoni që ndëshkimi ishte shumë i rëndë.
- ✓ Guvernatori mund të bëjë diçka nëse ai ose ajo mendon që seanca u zhvillua në mënyrë të gabuar.
- ✓ Aplikoni të merrni ditët shtesë që ju kthyen.

Çfarë ndodh nëse seanca është kryer në një mënyrë të gabuar ose mendoni që ndëshkimi që ju dha ishte shumë i rëndë?

1. Nëse guvernatori mendon që seanca është kryer në një mënyrë të gabuar

Në qoftë se seanca ishte drejtuar nga guvernatori

- Guvernatori mund të ndryshojë rezultatin e seancës. Për shembull, ata mund të ndryshojnë faktin që ju u gjykuat fajtor dhe të ndryshojë ndëshkimin që ju morët.

Në qoftë se seanca është drejtuar nga një gjykatës i pavarur (një gjykatës i qarkut)

Guvernatori mund

- t'ia japi çështjen për ta rishikuar përsëri gjyqtarit më lartë të qarkut.

2. Në qoftë se ju mendoni se seanca është kryer në mënyrë të gabuar ose ndëshkimi juaj ishte shumë i rëndë.

Në qoftë se seanca juaj është drejtuar nga një guvernator.

- Kërkojini një punonjësi burgu në bllokun tuaj për një formë që quhet **Forma ADJ1**.
- Plotësojeni formën dhe dërgojani atë guvernatorit brenda 6 javësh pas seancës.
- Dikush i quajtur menaxher i zonës do të vendosi për çështjen tuaj.
- Në qoftë se menaxheri i zonës mendon se seanca juaj ishte e gabuar, ai ose ajo mund ta ndryshojë faktin që ju u gjykuat i fajshëm ose mund ta ndryshojë ndëshkimin.

Në qoftë se seanca juaj është drejtuar nga një gjyqtar i pavarur.

- Shkruajini guvernatorit një **letër të qartë** për t'i shpjeguar pse kërkon që vendimi i seancës tuaj të rishikohet. **Mos** e plotësoni Formën ADJ1. Ju duhet t'i shkruani guvernatorit brenda 14 ditësh pas seancës.
- Letra juaj do t'i dërgohet për shqyrtim një gjykatësi të quajtur gjyqtari i lartë i qarkut. Gjykatësi është nga Gjyqi i Magjistraturës së Westminster-it
- Gjyqtari i lartë i qarkut mund të vendosë të ndryshojë ndëshkimin tuaj. Por ata **nuk mund** të ndryshojnë faktin që ju jeni gjetur fajtor.

Në qoftë se jeni akoma të pakënaqur mbas kësaj

- Ju mund të pyesni dikë i quajtur **avokat i popullit për burgjet dhe lirimit me kusht** që ta shoh çështjen tuaj. Ky person nuk punon për burgun. Puna tyre është të shqyrtojnë ankesat e të burgosurve rreth jetës në burg.
- Ju mund t'i shkruani avokatit të popullit dhe t'i kërkonit atij të shohë çështjen tuaj. Ose ju mund t'i kërkonit avokatit tuaj që ta bëjë këtë për ju.
- Avokati i popullit do të mundohet në fillim të rregullojë situatën ndërmjet jush dhe guvernatorit.

Më tepër rreth avokatit të popullit

- Në qoftë se kjo nuk arrihet avokati i popullit do të shkruajë një raport rreth çfarë mendojnë ata që duhet të ndodhi.
- Ju **nuk** do të keni mundësinë që të keni përsëri një seancë. Por **avokati i popullit** mund të sugjerojë që burgu të ndryshojë faktin që ju u gjetët i fajshëm ose të ndryshojë ndëshkimin që morët.

Shkruajini avokatit të popullit në adresën

Prison and Probation Ombudsman
Ashley House
2 Monck Street
LONDON
SW1P 2BQ

Një rishqyrtim juridik

- Ju mund t'i kërkonit një gjykatësi të shohë çështjen tuaj. Por kjo mund të mos lejohet të bëhet. Prandaj është më mirë që të bëhet një ankesë në mënyrën e sapo përshkruar në fillim.
- Në qoftë se ju do t'i kërkonit gjykatësit që të shqyrtojë çështjen tuaj, shkruajni avokatit tuaj dhe kërkojini ta bëjë këtë gjë.

Kthimi i ditëve shtesë

- Ju mund të aplikoni që t'ju kthehen ditët shtesë.
- Ju normalisht mund të aplikoni që t'ju kthehen deri **gjysma** e këtyre ditëve mbrapsht.
- Ju mund të aplikoni që t'ju kthehen ditët shtesë **6 muaj** mbas herës së fundit që u gjetët fajtor për kryerjen e një shkeljeje. Ose 6 muaj mbas herës së fundit që ju aplikuat që t'ju kthehen mbrapsht ditët shtesë.
- Në qoftë se jeni një i ri i dënuar, ju mund të aplikoni **4muaj** mbas.

Si të aplikoni që t'ju kthehen ditët shtesë

- Bisedoni me një anëtar të stafit në bllokun tuaj. Anëtari i stafit do të kontrollojë për të parë nëse ju mund t'ju kthehen mbrapsht ditët shtesë.
- Ju atëherë do të kërkoheni të shkruani diçka ku shpjegoni përse mendoni që duhet t'ju kthehen mbrapsht ditët shtesë.
- Një anëtar stafi në bllokun tuaj do të shkruajë një raport për ju dhe do t'ja dërgojë guvernatorit. Ata do të dërgojnë gjithashtu informacion për shkeljet që keni kryer së bashku me raportin.
- Ka shumë mundësi që të mos ju kthehen të gjitha ditët mbrapsht. Por ju mund të aplikoni përsëri më vonë që t'ju kthehen më shumë ditë mbrapsht.

Izolimi, kontrollimi i qelisë tuaj dhe gjëra të tjera që mund të ndërmerren nga punonjësit e burgut për të mbajtur burgun të sigurt.

- ✓ Ekzistojë gjëra të tjera që punonjësit e burgut mund të bëjnë për të mbajtur në kontroll çfarë ndodh në burg.
- ✓ Këto gjëra **nuk mund** të përdoren si ndëshkim. Por këto gjëra mund të përdoren kur janë të nevojshme për të ndaluar lëndimin e njerëzve dhe për të mbajtur burgun të sigurt.
- ✓ Këto gjëra përdoren shumë rrallë.

Izolimi (më shumë informacion gjendet në **rregullin 45 të Shërbimit të Burgut**)

Çfarë është izolimi?

- Izolimi ndodh kur ju mbaheni veças të burgosurve të tjerë.
- Guvernatori vendos nëse ju do të vendoseni në izolim ose jo.
- Ju mund të vendoseni në një pjesë tjetër të burgut të quajtur qendra e izolimit. Ju mbaheni veças të burgosurve të tjerë. Ju mund të vendoseni bashkë me të burgosur të tjerë që janë në izolim.
- Ju nuk mund të punoni dhe mund të duhet të qëndroni në qeli më shumë se të burgosurit e tjerë.

Përse do të futeni në izolim?

- Në qoftë se punonjësit e burgut mendojnë që ju jeni në rrezik. Për shembull, ju dëshironi të rrini veças të burgosurve të tjerë nëse mendoni se ata do t'ju lëndojnë ju për shkak të shkeljes ligjore që keni kryer. Për shembull, nëse ju keni kryer një shkelje seksuale. Avokati i juaj ose policia mund t'ju kenë dhënë këshillë për këtë.
- Në qoftë se silleni në një mënyrë të atillë që i bën punonjësit e burgut të mendojnë që ju do të vini në rrezik të tjerët ose do të shkaktoni probleme për pjesën tjetër të burgut.

Për sa kohë do të qëndroni në izolim?

- Guvernatori si fillim mund t'ju vendosi deri në 3 ditë izolim.
- Mbas kësaj ju mund të vendoseni në izolim deri në 1 muaj. Pastaj deri në 1 muaj për çdo herë mbas saj.
- Të burgosurit nën 21 vjeç mund të vendosen në izolim vetëm deri në 14 ditë.
- Mbas 3 ditëve të para, guvernatori duhet t'ju kontrollojë çdo 14 ditë për tu siguruar nëse ju duhet të vazhdoni qëndrimin në izolim.

Gjërat që duhet të konsideroni nëse doni të shkoni në izolim

- ✓ Vendosja në izolim është një gjë shumë serioze. Mendohuni mirë përpara se të kërkonte të vendoseni në izolim.
- ✓ Ju mund të shkoni në izolim vetëm në qoftë se guvernatori mendon që është e drejtë.
- ✓ Në qoftë se ju shkoni në izolim të burgosurit e tjerë mund të fillojnë të mendojnë keq për ju dhe kjo do ta bëjë më të vështirë kthimin tuaj në bllok.

Ndihma që mund të merrni në izolim

Në qoftë se jeni të shqetësuar për ndonjë gjë përgjatë kohës në izolim, bisedoni me një punonjës burgu ose me guvernatorin.

Këta persona e vizitojnë qendrën e izolimit **çdo ditë**

- një oficer burgu
- guvernatori
- një mjek ose infermier.

Këta njerëz gjithashtu e vizitojnë qendrën e izolimit – por jo çdo ditë

- kleriku
- dikush prej Bordit të pavarur të vëzhgimit (këta janë njerëzit që kontrollojnë burgjet për t'u siguruar që ata drejtohen në një mënyrë të mirë e të drejtë).

Strehimi i veçantë dhe të përmbajturit në mënyrë mekanike

Këto gjëra nuk përdoren zakonisht. Por punonjësit e burgut mund ti përdornin në qoftë se

- Ju silleni në një mënyrë të dhunshme
- Ju mund të lëndoni ose dëmtoni veten ose njerëz të tjerë në burg.

Strehimi i veçantë është një qeli që punonjësit e burgut ju mbyllin nëse po silleni në mënyrë të dhunshme. Qelia mund të mos ketë asnjë mobilje në të. Ju do të mbylleni në qeli derisa të qetësoheni.

Të përmbajturit në mënyrë mekanike janë gjëra që mund të vendosen në trupin tuaj për t'ju ndaluar të lëndoni veten dhe të tjerët. Një **rrip trupi** do të jetë lloji i përmbajtjes mekanike që do të përdoret. Është një rrip që shkon përreth mesit tuaj i lidhur tek prangat.

- Ju do t'u vendoset rripi i trupit në qoftë se mbyllja në një qeli të veçantë nuk ka funksionuar.
- Ju do t'u vendoset rripi i trupit vetëm në qoftë se jeni mbi 17 vjeç.
- Punonjësit e burgut do t'ju kontrollojnë si jeni çdo 14 orë.
- Dikush prej Bordit të pavarur të vëzhgimit (këta janë njerëzit që kontrollojnë burgjet për t'u siguruar që ata drejtohen në një mënyrë të mirë e të drejtë) do t'ju vizitojë brenda 1 dite. Ky person do të jetë i pranishëm nëse është e mundur kur punonjësit e burgut ju kontrollojnë si jeni.

Pikat kryesore

- ✓ Guvernatori në fillim duhet të japë aprovimin përpara se punonjësit e burgut t'ju mbyllin në një qeli të veçantë ose t'ju vendosin rripin e trupit.
- ✓ Punonjësit e burgut duhet t'i tregojnë ekipit shëndetësor për atë që ka ndodhur.
- ✓ Një mjek ose një infermier do t'ju kontrollojë sa më shpejt që të jetë e mundur.
- ✓ Dikush prej Bordit të pavarur të vëzhgimit (njerëzit që kontrollojnë burgjet për t'u siguruar që ata drejtohen në një mënyrë të mirë e të drejtë) duhet t'ju vizitojë brenda 1 dite.
- ✓ Bordi i pavarur i vëzhgimit për t'u siguruar, do të kontrollojë gjithashtu nëse ishte e drejtë që punonjësit e burgut ju mbyllën në një qeli të veçantë ose ju vunë rripin e trupit.
- ✓ Punonjësit do t'ju kontrollojnë shpesh për të parë si jeni. Kur sjellja e juaj e rrezikshme të ndalojë, punonjësit e burgut do t'ju nxjerrin jashtë qelisë së veçantë dhe / ose do t'ju heqin rripin e trupit.

Rebelimet në burg

Në qoftë se ju merrni pjesë në një turbullirë serioze në burg, ju mund të paditeni për **rebelim në burg**.

Rebelimi në burg ndodh kur ju dhe të burgosur e tjerë bëni gjëra për të marrë komandën e burgut dhe të mos lejoni guvernatorin dhe punonjësit e tjerë të burgut të jenë në komandë dhe të drejtojnë burgun.

Ju mund të paditeni me rebelim në burg në qoftë se

- stafi ose të burgosurit janë lënduar
- burgu është dëmtuar
- guvernatori humb kontrollin e një pjese ose të gjithë burgut.

Në qoftë se paditeni për rebelim në burg ju mund

- të merrni një dënim me burg deri në 10 vjet
- merrni një gjobë ku ju duhet të paguani disa të holla
- ose të dyja këto.

Në qoftë se të burgosurit e tjerë rreth jush fillojnë të shkaktojnë një rebelim në burg

- **mos** u bashko me ta
- largohuni nga vendi në të cilin po ndodh
- në qoftë se nuk i bëni këto gjëra, punonjësit e burgut mund të mendojnë që ju po merrnit pjesë në rebelim dhe mund t'ju padisin për rebelim në burg.

Kontrollimi i qelisë dhe i sendeve tuaja

- për të mbajtur burgun e sigurt, oficerët e burgut mund t'ua kontrollojnë qelinë dhe sendet tuaja në çdo kohë.
- Nuk ka rregull se sa shpesh mund të ndodhi kjo gjë. Varet nga burgu në të cilin ndodheni dhe sa i pa-rrezikshëm personeli i burgut mendojnë që ju jeni.

Çfarë do të ndodhi kur t'ju kontrollohet qelia dhe sendet?

- Ju do t'ju kontrollohet trupi plotësisht në qelinë tuaj përpara se t'ju kontrollohet qelia.
- Ju duhet të dorëzoni te punonjësit e burgut gjithçka që nuk ju lejohet të mbani.
- Ju do të dërgoheni në një zonë tjetër të burgut gjatë kontrollit të qelisë.
- Punonjësit e burgut mund të marrin gjëra me vete për t'i kontrolluar. Makineri me reze-X mund të përdoren për t'i kontrolluar sendet më në hollësi.
- Stafi mund të kontrollojë dokumentet tuaja ligjore por nuk do t'i lexojë ato.

Kur kontrolloheni

Ka 2 lloj kontrollesh që punonjësit e burgut mund t'ju bëjnë

1. Një kontroll me prekje

Kjo ndodh kur punonjësit e burgut mund

- të kërkojnë që të hiqni këpucët dhe boshatisni xhepat
- t'ju kontrollojnë gojën, hundën (vrimat e hundës), veshët dhe flokët.

- ✓ Punonjësit e burgut mund t'ju kontrollojnë trupin me prekje në çdo kohë
- ✓ Çdo anëtar i stafit të burgut, përfshirë femrat, mund t'ju kontrollojnë trupin me prekje. Tregojini punonjësve të burgut në qoftë se nuk mendoni se duhet të kontrolloheni në trup nga një femër. Për shembull, për arsye fetare.
- ✓ Kontrolli i trupit me prekje mund të bëhet përpara ose mbasi ju lëvizni nga një zonë e burgut në një tjetër.

2. Një kontroll i plotë i trupit

Kjo gjë bëhet kur stafi mund

- T'ju kontrollojë rrobat tuaja.
- T'ju kontrollojë trupin tuaj. Punonjësit mund t'ju kërkojnë të përuleni kështu që ata të shikojnë në qoftë se keni ndonjë gjë të fshehur në pjesët tuaja të anusit ose ato gjenitale. Ata nuk duhet t'ju prekin për të bërë këtë.
- Ju do të keni gjithmonë disa rroba të veshura gjatë kontrollit. Punonjësit e burgut do t'ju kontrollojnë gjysmën e rrobave një herë dhe ju mund ti vishni këto përpara se ata të kontrollojnë gjysmën tjetër.

Më shumë përreth kontrollit të plotë trupit

- ✓ Çdo oficer burgu, oficer me përgjegjësi, oficer kryesor, ose guvernatori mund t'ju bëjnë një kontroll të plotë trupor.
- ✓ Kontrolli do të bëhet gjithmonë nga një anëtar mashkull i stafit të burgut.
- ✓ Kontrollet e plota trupore mund të bëhen në çdo kohë. Për shembull
 - sa herë që ju dilni ose vini në burg
 - përpara se qelia juaj të kontrollohet
 - kur ju arrini në qendrën e izolimit
 - pasi të keni vizituar miq, familjarë ose me avokatin tuaj
 - mbas çdo vizite në qoftë se ju jeni një i burosur i kategorisë A të sigurisë së lartë.
- ✓ Stafi i burgut duhet t'ju shpjegojë saktësisht çfarë do të ndodhi përpara se të bëjnë kontrollin e plotë trupor.
- ✓ Kontrollet e plota trupore duhen të bëhen në një mënyrë të mirë dhe të pa rrezikshme.
- ✓ Normalisht vetëm anëtari i stafit të burgut që bën kontrollin duhet të jetë aty gjatë kontrollit.

Si duhet të trajtoheni në burg

Në burg, duhet të trajtoheni në mënyrë të drejtë. Në qoftë se nuk trajtoheni në mënyrë të drejtë, ju mund të provoni të bëni diçka për këtë.

Në faqen tjetër ka informacion rreth disa ligjeve që ekzistojnë që ju të jeni i ruajtur, si dhe gjërave që burgu duhet të kryejë për t'u siguruar që ju trajtoheni në mënyrë të drejtë.

Ligji i vitit 1998 për të drejtat e njeriut

- Ky ligj flet rreth të drejtave të njeriut. Çdo person ka të drejta të njeriut, siç janë të e drejta për të jetuar ose e drejta për të patur një gjykim të drejtë.
- Në qoftë se mendoni se nuk ju janë respektuar drejtat tuaja ju mund ta dërgoni çështjen tuaj në gjyq.
- Për t'u informuar më shumë rreth Ligjit për të drejtat e njeriut lexoni fletëpalosjen që quhet **Udhëzuesi mbi të drejtat e njeriut** dhe paketën e informacionit që quhet **Ligji i të drejtave të njeriut**. Të dyja këto gjenden në bibliotekë.

Dhuna ose ngacmimi

- Çdo i burgosur ka të drejtë të ndihet i pa rrezikuar.
- Në qoftë se dikush ka përdorur dhunë tek ju ose ngacmim kundrejt jush, tregojini punonjësve të burgut menjëherë. Ju mund t'i tregoni çdo anëtar të stafit të burgut si oficerëve të burgut, klerikut dhe nëpunësit të edukimit.
- Dhuna dhe ngacmimi janë kur njerëzit ju godasin ose kërcënojnë (për shembull, kur ata thonë që duan t'ju dëmtojnë ose t'ju bëjnë diçka juve).
- Stafi do t'ju ndihmojë në qoftë se kjo do ndodh.

Barazia Racore – njerëz nga raca të ndryshme

- Raca e një personi përfshin shumë gjëra si prejardhjen, kulturën dhe ngjyrën e lëkurës së tyre.
- Me ligj, burgjet duhet të sigurojnë që njerëzit nga të gjitha racat e ndryshme të trajtohen në mënyrë të mirë dhe të drejtë. Guvernatori dhe menaxherët me përgjegjësi kanë për detyrë të sigurojnë që kjo gjë bëhet.
- **Urdhri 2800 i Shërbimit të Burgut** shpjegon se çfarë duhet të bëjë burgu që të sigurohet që njerëzit e të gjitha racave të ndryshme trajtohen në mënyrë të mirë dhe të drejtë. Një kopje e urdhrin gjendet në bibliotekën e burgut.
- Ju gjithashtu mund të lexoni një kopje të planit të burgut për të siguruar që njerëzit nga të gjitha racat trajtohen në mënyrë të mirë dhe të drejtë. Ky quhet **Plani i veprimit për barazinë racore**.

Si duhet të trajtoheni

Burgu duhet të sigurohet që ju

- trajtoheni në mënyrë të mirë dhe të drejtë
- mund të bëni gjërat që kanë të bëjnë me besimin dhe kulturën tuaj. Për shembull, të vishni rroba që i përkasin besimit tuaj, të mbani libra fetare dhe të ndiqni ngjarjet fetare.
- mund të hani ushqim e lejuar nga besimi dhe kultura juaj.
- mund të merrni informacione të tilla si ky libër në gjuhë të tjera në qoftë se keni nevojë, ose kërkoni ndihmë nga një përkthyes gjuhe.

Çfarë të bëni në qoftë se jeni trajtuar keq për arsye të racës tuaj, ose në qoftë se e vëreni që kjo ndodh te dikush tjetër.

- ✓ Flisni me një anëtar të stafit ose plotësoni një formë të quajtur **COMP 1** ose një formë të quajtur **Forma e raportimit të incidentit racor**.
- ✓ Në qoftë se nuk mund t'i bëni këto, ju mund t'i kërkonti në një mënyrë private guvernatorit, menaxherit të zonës, ose kryetarit të Bordit të vëzhgimit të pavarur të shqyrtojnë çfarë ndodhi.
- ✓ Plotësoni një formë të quajtur **forma-ankesa COMP2 që duhet lexuar në mirëbesim** për ta bërë këtë. Ju mund të vendosni formën në një zarf të mbyllur i cili do mbahet privat.
- ✓ Në qoftë se nuk jeni i kënaqur mbas kësaj ju mund të kontaktoni dikë që quhet Avokati i popullit për burgjet dhe lirimet me kusht.
- ✓ Ose ju mund të kontaktoni një organizatë të quajtur Komisioni i barazisë dhe të drejtave të njeriut. Ata japin këshilla dhe ndihmojnë të burgosurit kur mendojnë që janë keqtrajtuar për arsye të racës. Ju mund t'i kontaktoni ata në

The Equality & Human Rights Commission
3 More London Riverside
Tooley Street
London SE1 2RG

Telefoni 0203 117 0235

Kush mund t'ju ndihmojë ta bëni këtë

Ju mund të merrni ndihmë prej

- ✓ çdo anëtari të stafit të burgut
- ✓ një anëtari të stafit të quajtur oficeri i barazisë racore
- ✓ një ekip i stafit i quajtur Ekipi i aksionit të racës dhe barazisë
- ✓ përfaqësuesit e të burgosurve. Këta janë të burgosur që shkojnë në takime që kanë të bëjnë me racën dhe përfaqësojnë pikëpamjet e të burgosurve të tjerë
- ✓ pjesëtarë të tjerë të stafit të quajtur koordinatori i kundër-ngacmimeve ose koordinatori i burgjeve më të sigurta.
- ✓ një anëtar i Bordit të pavarur të mbikëqyrjes (njerëzit që kontrollojnë burgjet të sigurohen që ato janë drejtuar në një mënyrë të mirë dhe të drejtë).

Në qoftë se ju jeni një i **burgosur i një kombësie të huaj** (kjo do të thotë që ju **nuk** keni një pasaportë të MB)

Ju mund të merrni ndihmë nga

- ✓ një anëtar i stafit i quajtur oficeri i barazisë raciale
- ✓ një anëtar i stafit i quajtur oficeri i nëdrilidhës për shtetasit e huaj.
- ✓ ambasada tuaj. Ju mund t'i shkruani atyre t'i kërkonin ndihmë ose ju mund t'i kërkonin oficerit të barazisë racore ose oficerit të ndërlidhjes të shtetasve të huaj që ta bëjnë këtë për ju.
- ✓ disa adresa të cilave mund t'ju drejtoheni janë në bibliotekën e burgut. Ju mund të kërkonin një listë që quhet **Lista e përfaqësive diplomatike në Londër** ose shihni **Urdhrin 4630 të Shërbimit të Burgut**
- ✓ Ju mund të gjeni informacion, si ky libër, në gjuhë të tjera.

Të burgosurit invalidë

Ekziston një ligj i quajtur Ligji për mosdiskriminimin e invalidëve që të sigurojë që personat janë të sigurt dhe nuk janë duke u trajtuar në mënyrë të pa drejtë.

Burgu duhet ta zbatojë këtë ligj. Duhet të bëjë çka mundet që të sigurojë

- ju të merrni pjesë në jetën e burgut
- ju trajtoheni në mënyrë të mirë dhe të drejtë

Më shumë informacion gjendet në **Urdhërin 2850 të Shërbimit të Burgut**. Një kopje e tij gjendet në bibliotekë.

Kush mund t'ju ndihmojë nëse jeni një i burgosur invalid?

- ✓ Oficeri personal i juaj ose oficeri i bllokut. Bisedoni me ta për çdo gjë që keni nevojë në lidhje me invaliditetin. Për shembull, në qoftë se keni nevojë që informacioni t'ju jepet në një formë tjetër.
- ✓ Një anëtar i stafit i quajtur oficeri i ndërlidhjes së invaliditetit.
- ✓ Dikush nga ekipi mjekësor.
- ✓ Ose mund t'i shkruani guvernatorit (ju ka shumë mundësi që të duhet të plotësoni një formë të quajtur **COMP1** për këtë).
- ✓ Ose ju mund të kontaktoni një organizatë të quajtur Komisioni i barazisë dhe të drejtave të njeriut. Ata japin këshilla dhe ndihmojë të burgosurit që mendojnë se janë trajtuar keq për arsye të invaliditetit. Ju mund t'i kontaktoni ata në

The Equality and Human Rights Commission
3 More London
Riverside
Tooley Street
London SE1 2RG

Telefoni 0203 117 0235

Si të bëni një ankesë zyrtare

Informacion i mëtejshëm mund të gjendet në **Urdhrin 2510 të Shërbimit të Burgut** .
Një kopje e tillë gjendet në bibliotekë

Të bëni një kërkesë (kjo do të thotë të kërkonti për diçka)

- Ju mund të pyesni një oficer burgu për diçka në çdo kohë.
- Për të kërkuar diçka ju mund t'ju duhet të plotësoni një formë. Në qoftë se punonjësit e burgut vendosin që ju nuk mund të merrni çfarë kërkuat, ata duhet t'ju shpjegojnë përse.

Si të bëni një ankesë

- Ju mund të bëni një ankesë në qoftë se mendoni se jeni trajtuar në mënyrë të keqe në burg.
- Ju duhet të bëni një ankesë brenda 3 muajve që kur ka ndodhur incidenti.
Për të bërë një ankesë ju mund të bëni njërën nga gjërat më poshtë
 - bëjini një ankesë punonjësve të burgut në fillim
 - bëjini një ankesë njerëzve **jashtë** burgut (si Deputetit tuaj).
- Mundohuni ta zgjidhni problemin në fillim në burg. Njerëzit jashtë burgut zakonisht shpresojnë që ju të jeni munduar për ta zgjidhur problemin me punonjësit e burgut në fillim.

1. Të bëni një ankesë për gjërat e tilla si

- Gjykimet (seancat).
- Kategoria e sigurisë që ju është dhënë.
- Vendimet nëse mund të lejoheni të dilni nga burgu më shpejt për arsye të gjërave si sëmundje vdekjeprurëse ose sepse mundësitë për të kryer një shkelje tjetër janë shumë të vogla. Kzy quhet **lirim mëshire**.

- Këto lloj ankesash quhen **subjekte të rezervuara**. Ato mund të vendosen vetëm nga menaxheri i zonës ose stafi tjetër jashtë burgut.
- Ka një listë të subjekteve të rezervuara në **Urdhrin 2510 të Shërbimit të Burgut Shtojca H**. Këtë do ta gjeni në librari.
- Ju mund të bëni një kërkesë ose një ankesë për këto gjëra vetëm duke i shkruar menaxherit të zonës.
- Menaxheri i zonës do t'ju shkruajë ju për t'ju njoftuar çfarë kanë vendosur brenda 6 javësh nga marrja e letrës tuaj.
- Ju mund të ankoheni te Avokati i popullit për burgjet dhe lirimet me kusht ose avokati juaj në qofte se ju jeni akoma i pakënaqur. **Shihni faqen 115**.

2. Bërja e një ankese për gjërat të tjera

Si të bësh një ankesë

1. Bisedoni me një anëtar të stafit për problemet. Në qoftë se keni një oficer personal bisedoni me atë. Kjo gjë mund ta zgjidhi problemin.
2. Në qoftë se kjo nuk funksionin, kërkoni të flisni me oficerin e sheshpushimit tuaj ose menaxherin e bllokut.

Më shumë për bërjen e ankesës

3. Në qoftë se kjo nuk funksionin shkruani diçka rreth ankesës tuaj. Ju duhet të plotësoni një formë të quajtur **COMP 1** për ta bërë këtë. Ju duhet ta fusni formën e plotësuar në një **kuti ankesash**. Mos ia jepni formën tuaj një anëtar të stafit drejtpërdrejt.
4. Forma do t'ju kthehet mbrapsht juve me një përgjigje që ju shpjegon se çfarë thonë punonjësit e burgut për ankesën tuaj. Ju duhet të merrni përgjigjen tuaj brenda 3 ditësh pune.
5. Në qoftë **nuk** jeni të kënaqur me përgjigjen e dhënë nga punonjësit e burgut, ju mund të kërkonte që ankesa e juaj të rishqyrtohet duke plotësuar një formë **Comp 1A**.

Bërja e një ankesë në mënyrë më të fshehtë

- Për të bërë një ankesë në mënyrë më privatet fshehtë, ju duhet të plotësoni një formë të quajtur **COMP2 forma-ankesa për tu lexuar në mirëbesim**. Shkruani në formë përse po ankoheni në këtë mënyrë më në fshehtë.
- Ju mund të dërgoni formën në një zarf të mbyllur tek guvernatori, kryetari i Bordit i pavarur mbikëqyrës ose menaxheri të zonës.
- Ju duhet ta bëni këtë vetëm në rastet kur ankesa juaj është shumë serioze ose shumë e vështirë për tu biseduar me punonjësit e burgut.
- Personi të cilit ja dërguat formën do të vendosi mënyrë më të mirë për të shqyrtuar ankesën tuaj. Ata mund të kenë nevojë të bisedojnë me njerëz të tjerë, duke përfshirë edhe personin për të cilin ju jeni ankuar.

Bërja e një ankese për stafin

- Në qoftë se ju mendoni që stafi i burgut ka shkelur rregullat e burgut dhe ju kanë trajtuar në një mënyrë të keqe, ju mund të ankoheni te guvernatori ose menaxheri i zonës. Në qoftë se ju jeni në një burg privat, ju duhet të ankoheni te kontrolluesi për ankesat që kanë të bëjnë me oficerin e paraburgimit të burgut.
- Plotëso një formë ankese të quajtur **COMP1** ose ju mund të ndjeheni më të kënaqur të plotësoni formën **COMP 2**. Shkruani në formë detajet për çfarë mendoni që stafi ka vepruar keq. Për shembull, thuaj çfarë ka ndodhur, ku ka ndodhur dhe kur dhe në qoftë se dikush tjetër pa çfarë ndodhi.
- Një anëtar me përgjegjësi i stafit do ta shohë ankesën. Ata do bisedojnë me ju, me personin për të cilin ju jeni ankuar dhe me dikë tjetër që ka parë çfarë ka ndodhur.

Në qoftë se ju keni të drejtë, guvernatori do të

Veprorë kundrejt anëtarit të stafit për të cilin ju u ankuat.

- Telefonojë policinë në qoftë se është e nevojshme.
- T'ju shkruajë për t'ju njoftuar çfarë është vendosur. Kjo zakonisht zgjat 2 javë. Menaxheri i zonës do t'ju shkruajë në qoftë se ju jeni ankuar në mënyrën të fshehtë e quajtur për tu lexuar në mirëbesim.

Kur ndryshoni mendjen për ankesën tuaj

- Në qoftë se ndryshoni mendjen ju mund ta ndaloni ankesën në çdo kohë.
- Tregojini një anëtar të stafit. Ata do të kërkojnë të shkruani një formë ku thoni që dëshironi të ndaloni ankesën tuaj.

Njerëz të tjerë me të cilët mund të bisedoni në burg

- Ju gjithashtu mund të bisedoni me një grup të quajtur **Bordi i pavarur i mbikqyrjes** për ankesën tuaj, mbasi jeni munduar ta zgjidhni me stafin. Ky grup kontrollon burgjet për t'u siguruar që ata janë drejtuar në një mënyrë të mire dhe të drejtë.
- Njerëzit në Bordin e pavarur të mbikqyrjes janë vullnetarë prej komunitetit lokal. Ekziston një fletëpalosje që mund të shihni për Bordin e pavarur të mbikqyrjes. Kjo ndodhet në bllokun tuaj.
- Ju duhet të plotësoni një formë për të kërkuar që Bordi i pavarur i mbikqyrjes të shqyrtojë ankesën tuaj. Ju mund ta gjeni këtë formë në bllokun tuaj të burgut.

Bordi i pavarur i shqyrtimit mund

- Pyesë guvernatorin të shpjegojë një vendim për ankesën tuaj.
- Këshillojë guvernatorin se çfarë mund të bëhet tjetër.
- Të vërë në pah informacion që nuk është shqyrtuar.

Ata nuk munden

- Ndryshojnë vendimin që është marrë nga burgu.

Persona jashtë burgut të cilëve mund t'i dërgoni ankesën tuaj – mbasi jeni munduar të zgjidhni ankesën me punonjësit e burgut

1. Avokati i popullit për burgjet dhe lirimet me kusht

- Ju mund t'i shkruani dikujt të quajtur Avokati i popullit për burgjet dhe lirimet me kusht në qoftë se jeni munduar ta zgjidhni ankesën tuaj me punonjësit e burgut dhe nuk jeni akoma i kënaqur.
- Avokati i popullit nuk punon për burgun. Puna e atyre është të shqyrtojnë ankesat e të burgosurve për jetën e burgut.
- Avokati i popullit mundet vetëm të shqyrtojë ankesat që ju keni dërguar.
- Ju duhet t'i shkruani avokatit të popullit brenda **1** muaji mbasi keni marrë përgjigjen nga punonjësit e burgut për ankesën tuaj.
- Tregojini avokatit të popullit sa më shumë që mundeni kur t'i shkruani atyre. Ata normalisht nuk vinë të bisedojnë me ju kështu që ju duhet t'i tregoni sa më shumë që të keni mundësi në letrën tuaj.
- Avokatit të popullit do t'i duhet zakonisht **12** ose më pak javë për të shqyrtuar ankesën tuaj. Ju do të merrni diçka me shkrim që ju tregon se çfarë vendimi është marrë.
- Nëse Avokati i popullit mendon që ju nuk jeni trajtuar në mënyrë të drejtë, ata mund t'i kërkojnë guvernatorit të ndryshojë vendimin e tij ose t'i rekomandojë ndryshime kryetarit të Shërbimit të burgut.

Shkruajini mbledhësit të ankesave në

Prisons and Probation Ombudsman
Ashley House
2 Monck Street
London
SW1P 2BQ

Ka një fletëpalosje që ju mund të lexoni për Avokatin e popullit dhe mënyrën si të ankoheni. Kjo fletëpalosje është në bibliotekë.

2. Ankesat për shëndetin tuaj

- Në qoftë se ankesa juaj ka të bëjë me shëndetin ju duhet të flisni në fillim me ekipin e shëndetësisë së burgut.
- Në qoftë se kjo nuk funksionon, ju mund t'i shkruani Trustit të kujdesit parësor që t'i tregoni për ankesën tuaj. Trusti i kujdesit parësor është kujdeset për shërbimet shëndetësore si doktorët, dentistët dhe okulistët në zonën lokale.
- Në qoftë se ju akoma nuk jeni të kënaqur ju mund t'i kërkonit Komisionit të kujdesit shëndetësor të shohë ankesën tuaj. Ky grup punon të sigurohet që shërbimet e kujdesit shëndetësor janë të drejtuar në një mënyrë të mirë.

Shkruani atyre për ankesat e juaja në

Healthcare Commission
FREEPOST NAT 18958
Complaints Investigation Team
Manchester
M1 9XZ

- Në qoftë se nuk jeni të kënaqur me vendimin e marrë nga Komisioni i kujdesit shëndetësor, ju mund t'i kërkonit Avokatit të popullit për çështjet parlamentare dhe shërbimet shëndetësore ta shohë çështjen tuaj. Shkruajini Avokatit të popullit në adresën..

The Parliamentary and Health Service Ombudsman
Millbank Tower
Millbank
London
SW1P 4QP

- Në qoftë se kërkonit ndonjë ndihmë për të bërë një ankesë për shëndetin tuaj, pyesni një organizatë të quajtur Shërbimi i pavarur i këshillave të ankesave (ICAS) për ndihmë.
- Ju mund të merrni kontaktet e tyre nga punonjësit e burgut, biblioteka ose duke telefonuar NHS Direct në 0845 4647.

3. Deputeti i juaj

- Ju mund t'i shkruani Deputetit të zonës tuaj.
- Sigurohuni që të keni shkruar adresën e shtëpisë tuaj në letrën tuaj adresuar atyre.
- Ju mund t'i kërkoni Deputetit tuaj t'ja kalojë ankesën tuaj Avokatit të popullit për çështjet parlamentare dhe shërbimet shëndetësore në mënyrë që edhe ata ta shqyrtojnë atë.

4. Avokati juaj.

Avokati juaj mund të ndihmojë me çdo pyetje që ka të bëjë me ligjin.

5. Shefi i policisë.

Ju mund ti shkruani policisë lokale në qoftë se mendoni se është kryer një krim. Pyesni dikë të quajtur oficeri i ndërlidhjes i policisë në burg për adresën e duhur ku të dërgoni letrën tuaj.

6. Ju mund t'i shkruani peticion Mbretëreshës, parlamentit ose anëtarit tuaj të Parlamentit Evropian.

Informacion i mëtejshëm gjendet ne **Urdhrin 2510 të Shërbimit to Burgut**. Në të ka një formë të cilën mund ta fotokopjoni për të bërë peticionin tuaj.

7. Autoriteti i kompensimeve të dëmtimeve kriminale.

Në qoftë se ju jeni dëmtuar për shkak të kryerje së një krimi të dhunshëm të dikujt kundrejt jush ju mund t'i shkruani kësaj organizate. Ata punojnë për t'i dhënë njerëzve kompensim (të holla) për dëmtimet që ata marrin për shkak të një krimi të dhunshëm ose një arsyeje tjetër. Ju mund t'i shkruani atyre në

The Criminal Injuries Compensation Authority
Tay House
300 Bath Street
Glasgow
G2 4LN

Menaxhimi i të dënuarit, planifikimi i dënimit dhe përgatitja për lirim

Menaxhimi i të dënuarit

Kjo ka të bëjë me mënyrën se si menaxhohet koha që ju shpenzoni në burg ose nën mbikëqyrje në komunitet.

Menaxhimi i dënimit bëhet për t'u siguruar që në të ardhmen keni më pak mundësi të kryeni shkelje ligjore.

Kjo është vënë në punë në faza për të gjithë të dënuarit.

Vlerësimi i juaj dhe plani i dënimit

Burgjet dhe shërbimet e lirit me kusht përdorin Sistemin e vlerësimit të të dënuarit. Kjo shkurt quhet **OASys**.

I ndihmon ata që të kuptojnë pse ju shkelni ligjin dhe çfarë ju nevojitet që të mos e shkelni.

Gjithashtu përdoret të dalluar nëse ju mund të dëmtoni veten tuaj ose njerëz të tjerë dhe të punojnë së bashku me ju për t'ju ndihmuar që të mos e bëni atë.

Të gjithë ata që do jenë në burg për 12 muaj ose më tepër ju është përgatitur një plan nga OASys.

Ju merrni pjesë në vlerësim dhe ju tregohet gjithçka që është shkruar.

Vlerësimi përdoret për të hartuar një plan veprimi. Ky plan veprimi quhet **plani i dënimit tuaj**.

Për shembull, plani i dënimit mund t'ju tregojë se çfarë do të bëni për të ndryshuar mënyrën si silleni herë pas here ose si do ti përballoni problemet me drogën ose me alkoolin.

Plani i dënimit tuaj ndikon shumicën e vendimeve ose ndryshimeve përgjatë dënimit dhe mbas lirit tuaj.

Menaxheri i të dënuarve dhe punonjës të tjetër

Menaxheri i të dënuarve është dikush nga shërbimet lirimit me kusht. Ato punojnë në komunitet dhe zakonisht do të punojnë me ju për gjithë kohën që jeni në burg ose nën mbikëqyrje në komunitet.

Ato do t'ju ndihmojnë që të bëni ndryshime në jetën tuaj me qëllim që të jetë sa më pak e mundur për të bërë shkelje në të ardhmen.

Kur jeni në burg ju gjithashtu mund të keni një mbikëqyrës për të dënuarit si dhe një oficer personal.

Ata do t'ju ndihmojnë që të ndiqni planin e dënimit.

Mbikëqyrësi i të dënuarve dhe/ose oficeri personal do të punojnë me menaxherin tuaj për të dënuarit. Në disa vende, mbikëqyrësi i të dënuarve dhe oficeri personal është i njëjti person.

Në qoftë se ju keni ndonjë pyetje rreth OASys ose menaxherit për të dënuarit, bisedoni me punonjësit e burgut.

Marrëveshja shumë-angjecore për mbrojtjen e publikut (MAPPA)

Kjo përdoret nga policia, shërbimet e lirimit me kusht dhe burgut që të punojnë me profesionalë të tjerë për menaxhimin e të dënuarve të dhunshëm dhe seksualë. Është përdorur për të mbrojtur publikun nga rreziqet.

Ju do t'ju thuhet në qoftë se kjo gjë zbatohet për ju.

Në qoftë se ju keni një vlerësim të MAPPA-s, do të përdoret për të bërë një plan të menaxhimit të rrezikut. Ky vlerësim gjithashtu do të ndihmojë stafin të vendosë nëse ju jeni i rrezikshëm për njerëzit e tjerë, si fëmijë.

Plani i juaj i dënimit

Plani juaj do të ketë objektiva në të.

Këto janë gjëra që ju dëshironi të bëni ose të ndryshoni.

Për shembull, ju mund të keni objektiva që kanë të bëjnë me shkollimin të tillë si

- ✓ Shkrim-lexim – lexim dhe shkrim
- ✓ numërim – matematikë dhe menaxhimi i të hollave
- ✓ mësimi i një profesioni të ri kështu që të jeni përgatitur më mirë për të gjetur një punë kur ju të dilni nga burgu
- ✓ kryerja e provimeve dhe marrja e kualifikimeve.

Si pjesë e planit tuaj ju mund të duheni të merrni pjesë në grupe ose kurse që ju ndihmojnë të mendoheni për arsyet e shkeljeve dhe që ju ndihmojnë të ndryshoni sjelljen tuaj.

Disa shembuj

Ekzistojnë kurse që ju mund të shkoni për t'ju ndihmuar të gjeni zgjidhje situatash dhe të kontrolloni si reagoni. Për shembull

- Kurse të quajtur Aftësi mendore të thelluara dhe Forcimi i aftësive mendore. Mendore do të thotë që ka të bëjë me mënyrën si mendoni.
- Një kurs që t'ju ndihmojë të menaxhoni ndjenjat tuaja i quajtur Kontrollimi i inatit dhe e mësuara e kontrollimit të tij (CALM).
- Programe Trajtimi për të dënuarit për çështje seksuale (shpesh të quajtur SOTPs).

Më tepër për programet

Ka programe që ju ndihmojnë nëse ju keni probleme me dhunën.

Për shembull

- Programi i marrëdhënieve të shëndetshme nëse keni keqtrajtuar bashkëshortët tuaj.
- Programi i vetë-ndryshimit mendor në qoftë se jeni shpesh i dhunshëm.
- Programi Chromis për njerëz që janë të dhunshëm dhe kanë probleme të veçanta që nuk mund të ndihmohen nga grupet e tjera.
- Programe që ju ndihmojnë të rivendoseni në komunitet mbas burgut.

Edukimi

Në çdo burg ka një bibliotekë dhe një departament edukimi.

Biblioteka është për t'u përdorur nga ju si bibliotekat publike jashtë burgut.

- Ju mund të huazoni dhe të porositni libra.
- Ju duhet të keni mundësinë të shkoni në bibliotekë për të paktën 20 minuta çdo javë.
- Shumica e bibliotekave ka libra në gjuhë të huaja.
- Informacion të mëtejshëm do të gjeni në **Urdhrin 6710 të Shërbimit të Burgut**.

Mësimi

Përpara se të filloni në çdo klasë ju do të bëni në një intervistë për të parë çfarë ndihme mund të keni nevojë me gjëra të tilla si leximi dhe shkrimi. Kjo ju ndihmon të zgjidhni kursin që është më i përshtatshëm për ju.

Juve do t'ju jepet orari dhe plani i mësimit tuaj që ju keni pranuar më parë me punonjësit e edukimit.

Më tepër për mësimin

Ju mund të shkoni në klasa për lëndë të ndryshme. Për shembull

- shkrim dhe lexim
- matematikë
- mësimet anglishteje për njerëz që flasin gjuhë të huaj
- art
- studime biznesi.

Të gjithë kurset që ju do të ndiqni do të shkojnë kundrejt kualifikimeve që janë të njohura jashtë burgut, si GCSE ose NVQ. Kjo bëhet për arsye se ju mund të vazhdoni me edukimin tuaj kur të dilni nga burgu nëse keni dëshirë.

Ju mund të merrni ndihmë për kurset me korrespondencë, si kurset nga Universiteti i Hapur (OU).

Të burgosur **mbi 21 vjeç** duhet të kenë mundësinë të marrin pjesë në veprimtari sportive dhe edukim fizik të paktën një orë në javë.

Punë dhe trajnim

Trajnimi

Shërbimi i Burgut bashkëpunon me Këshillin e mësimin dhe të aftësive. Kontaktoni oficerin e edukimit për të marrë informacion të mëtejshëm për çfarë ju ofron Këshilli i mësimin dhe i aftësive përgjatë kohës që jeni në burg dhe kur të dilni jashtë.

Trajnimi bëhet që t'ju ndihmojë të mësoni aftësi që do t'ju ndihmojnë të gjeni punë. Kjo quhet **trajnim profesional**.

Trajnimi profesional është shpesh i lidhur me klasat e edukimit. Në këtë mënyrë, ju mund të shkoni në një kurs trajnimi dhe të merrni kualifikime.

Për shembull, ju mund të shkoni në një kurs trajnimi në lyerje dhe dekorim. Në të njëjtën kohë, ju mund të shkoni në klasa matematike dhe leximi që të merrni GCSE ose një Kualifikim Profesional Kombëtar (NVQ).

Çdo burg ka një libër të quajtur **adresari i shkollimit dhe trajnimit** që ju tregon çfarë kursesh janë duke u bërë në burg.

Punë

Puna duhet të jetë një nga gjërat kryesore që bëni gjatë ditës kur jeni në burg. Puna duhet të jetë një pjesë e madhe e ndihmës që merrni për të përfituar aftësi dhe kualifikime kështu që ju mund të gjeni një punë kur të dilni nga burgu.

Shumë shpejt mbasi të keni arritur në burg, ju do të vlerësoheni për çfarë lloj pune do të jeni më të përshtatshëm.

Puna në burg është zakonisht e organizuar ndërmjet reparteve industriale dhe/ose bujqësore (kultivim) dhe hortikulturale (kopshtare). Ju do të prodhoni gjëra dhe do të drejtoni shërbime që janë të nevojshme në burg dhe për shitje në komunitet.

Punë në këto qendra duhet t'ju japin ju aftësi dhe eksperiencë në fusha të tilla si

- tekstile
- inxhinieri
- zdrukthëtari
- shtypshkronjë
- regjistrim të dhënash
- derdhje plastike
- vizatim i kompjuterizuar
- mirëmbajtje mjedisi.

Ju do të paguheni për punën tuaj në burg. Ju gjithashtu do të paguheni nëse ju do të dëshironi të punoni por nuk ka punë të përshtatshme në burg për ju. Kjo pagesë është zakonisht gjysma e asaj që ju do të merrnit në qoftë se do të punonit.

Punë në komunitet

Puna në komunitetin afër burgut quhet **të punuarit jashtë**. Është një mundësi për të krijuar bindjen në vetvete përpara se të dilni nga burgu. Gjithashtu do t'ju ndihmojë të kuptoni më tepër rreth të qenurit përgjegjës për komunitetin tuaj dhe njerëzit që jetojnë dhe punojnë me ju. Puna jashtë do të përfshijë punën

- në projekte për mjedisin
- me njerëz të moshuar
- me njerëz me aftësi të kufizuara
- në aktivitete sportive.

Klube pune

Disa burgje kanë klubet e tyre të punës që t'ju ndihmojnë të gjeni punë kur të liroheni. Klubet e punës do t'ju ndihmojnë me gjëra të tilla se si të përgatiteni për intervista dhe si të kërkoni për punë.

Pyesni stafin e burgut në qoftë se ka një klub pune në burgun tuaj.

Shumica e burgjeve kanë punonjës me përvojë që ju japin këshilla dhe përkrahje me punësimin.

Puna vullnetare

Ju mund të dilni vullnetar në burg si një dëgjues.

Ose ju mund të keni një punë të veçantë si përfaqësues i të burgosurve të tjerë në mbledhje ose të ndihmoni në qendrën fetare ose në bibliotekë.

Përgatitja për të dalë nga burgu

Përpara se të dilni do t'ju duhet të dini se

- ✓ Ku do të jetoni.
- ✓ Si t'i rregulloni ndihmat sociale tuaja.
- ✓ Për çfarë ndihmash në të holla mund të aplikoni për t'ju ndihmuar që të keni një vend për të jetuar.
- ✓ Të dini në qoftë se ju duhet të dërgoni format e taksave, nëse keni punuar përpara se të shkonit në burg.
- ✓ Në qoftë se rrobat që keni veshur kur mbërritët në burg ju bëjnë akoma.
- ✓ Në qoftë se jeni i liruar me kusht dhe duhet të takoheni me shërbimin e lirimit me kusht.

Sendet tuaja

Kur ju dilni nga burgu të gjitha sendet tuaja, si rrobat që kishit kur erdhët brenda, do t'ju kthehen mbrapsht. Në shumicën e burgjeve ju do t'ju jepet mundësia t'i provoni rrobat tuaja disa ditë përpara se të dilni. Në qoftë se ato nuk ju bëjnë ose janë të një stine tjetër të vitit, ju mund t'i kërkonti familjes ose miqve t'ju sjellin rroba.

Në qoftë se kjo nuk është e mundshme, shërbimet e burgut duhet tu japin **rroba të lirisë**. Këto janë rroba për t'u larguar nga burgu që ju bëjnë dhe që janë të përshtatshme për stinën e vitit.

Pyesni për veshje disa ditë përpara lirimit.

Leje udhëtimi

Ju do të merrni një fletë udhëtimi që t'ju dërgojnë në shtëpinë tuaj ose një adresë tjetër ne MB. Kjo ju lejon ju të udhëtoni në autobus, tren, ose autobus kombëtar.

Grante për daljen nga burgu

Ky grant në të holla do t'ju mbulojë deri sa të merrni Ndhimën mbi të ardhurat ose ndihmën për të papunët. Kjo është një sasi e vogël të hollash – afërsisht £46.

Ju nuk do të merrni dhuratë të hollash për daljen nga burgu nëse

- jeni nën 18 vjeç
- ju po kryeni një dënim prej 14 ditë ose më pak
- ju jeni në burg për mospagesë gjobe
- jeni një i burgosur civil
- jeni në paraburgim ose në pritje të largimit nga vendi
- do të shkoni menjëherë në spital
- do të shkoni për të jetuar diku jashtë MB
- nuk keni mundësi për të marrë ndihmë mbi të ardhurat
- jeni ri-sjellë në burg për më pak se 14 ditë.

Guvernatori gjithashtu mund t'i paguajë një ndihmë të hollash siguruesit të strehimit (pronarit të shtëpisë) për t'ju ndihmuar që të gjeni një vend për të jetuar.

Kjo ndihmë të hollash varet nga guvernatori, dhe burgu do të kontrollojë nëse strehimi për të cilin kërkoni të hollat, është i përshtatshëm.

Strehimi

Në qoftë se jeni të pastrehë kur të liroheni, ekzistojnë organizata që ju ndihmojnë për të gjetur strehim. Shumica e strehimit do të jetë në formën e bujtinave ose shtëpive të ndara me të tjerë. Në qoftë se keni një menaxher për të burgosurit, ata gjithashtu do ta bisedojnë këtë me ju.

Pyesni njësinë e rivendosjes në burg t'ju ndihmojë për këtë gjë.

Disa burgje mund të përdorin informacionin e të dhënave të kompjuterit të Shërbimit e hyrjes së lehtë të NACROs. Pyesni në qoftë se burgu juaj mund të bëjë këtë. Ky është informacion në kompjuter.

Më shumë për strehimin

NACRO është një shoqëri bamirëse që punon me njerëz që kanë qenë në burg.

Ju mund të kontaktoni ata në numrin 0800 0181 259.

Shelter është një shoqëri bamirëse që ndihmon ata që janë të pastrehë.

Ju mund të kontaktoni Shelter në 0808 800 4444.

Të hollat dhe ndihmat

Ju aplikoni për ndihmat nëpërmjet qendrës së punës plus.

Ju mund ti kërkonti qendrës së punës plus dhe këshilltarëve të qendrës së ndihmave që punojnë në burgun tuaj për t'ju ndihmuar që të aplikoni për ndihma **përpara** se të dilni nga burgu.

Në qoftë se ju nuk mund të takoheni me një këshilltar përpara se të dilni nga burgu, telefononi ose shkoni në qendrën e punës sa më shpejt që të mundeni mbasi keni dalë nga burgu.

- Tregojini atyre që doni të takoheni me një këshilltar për **Skemën fillim i ri**. Kjo është një skemë për njerëzit që kanë qenë në burg.
- Ju duhet ta sistemoni këtë brenda 7 ditëve mbasi keni dalë nga burgu. Kjo bëhet për arsyen që të bëni kërkesën për ndihmat që nga dita që ju dilni nga burgu.

Kur të shkoni për takimin tuaj në qendrën e punës plus, ju duhet të **merrni me vete**

- Ndonjë lloj identifikimi (ID) si pasaporta juaj, patentat e shoferit ose certifikata e lindjes.
- Numrin tuaj të sigurimit kombëtar.
- Një letër zyrtare nga burgu.

Në qoftë se nuk po ktheheni në zonën tuaj të mëparshme të banimit, ose i keni lënë këto dokumente tek miq ose familje, siguronit një mënyrë për ti marrë ato. Siguronit që ta bëni këtë **përpara** se të dilni nga burgu.

Taksa mbi të ardhurat

Në qoftë se ju nuk keni një formë **P45** nga puna juaj e fundit, juve do t'ju jepet një formë e zyrës së taksave **P80-1** përpara se ta dilni nga burgu.

Ju duhet ta plotësoni këtë dhe t'ia dërgoni zyrës së taksës që është marrë me punën tuaj të fundit.

Ju duhet ta plotësoni këtë formë për të marrë ndihmën për të papunët dhe mbështetjen mbi të ardhurat.

Në qoftë se do punoni për veten tuaj, kontaktoni zyrën lokale të taksave.

Ndihma dhe kredi

Në qoftë se ju do të merrni mbështetje mbi të ardhurat ose ndihmë për të papunët bazuar në të ardhurat tuaja ju mund të merrni një **ndihmë të hollash të kujdesit të komunitetit**.

Kjo ndihmë të hollash është për t'ju ndihmuar nëse nuk keni rroba ose orendi. Ata do të marrin parasysh sa kohë keni qëndruar në burg. Ata do të marrin parasysh nëse ju janë vjedhur rrobat, ose keni rënë ose shtuar shumë në peshë kështu që rrobat nuk ju rrinë.

Ju nuk duhet ta paguani mbrapsht këtë ndihmë.

Ndihma të tjera të hollash

Nëse ju nuk mund të merrni ndihmë të hollash të kujdesit të komunitetit ju mund të merrni një **hua në raste krize**. Ju duhet ta paguani këtë mbrapsht. Pagesat do të merren drejtpërdrejt nga ndihmat deri sa të paguhet e gjithë kredia.

Shëndeti juaj

Ju mund të kërkonti të vizitoheni tek mjeku ose infermieri përpara se të dilni nga burgu nëse keni ndonjë shqetësim për shëndetin ose mjekimin tuaj.

Përdorimi i drogave të rrugëve është gjithmonë i rrezikshëm. Nëse keni përdorur drogë të paligjshme në burg keni parasysh se ato ka shumë mundësi të jenë më pak të forta se ato jashtë. Ju do të keni më shumë rrezik mbidoze me drogat jashtë burgut.

Në qoftë se po trajtoheni për problem droge, ju do të referoheni te një shërbim komuniteti të trajtimit të drogave për të vazhduar trajtimin tuaj.

Koha e lirit

Në ditën e lirit ju ka shumë mundësi të dilni nga burgu përpara orës 8.45 në mëngjes.

Në qoftë se dita e lirit bie të shtunën ose të dielën ju do të dilni të premtën.

Në qoftë se dita e lirit bie në një ditë festash, ju do të dilni në ditën e fundit të punës përpara ditës së festës. Kjo zakonisht do të jetë e premtë.

Në qoftë se po dilni me lirim para kohe dhe dita e lirit bie në fundjavë, atëherë ju do të liroheni të hënën. Në qoftë se bie në një ditë festash ju do të dilni mbas ditës së festës. Kjo është zakonisht e martë.

Lirimi me kusht dhe mbikëqyrja

Në qoftë se keni pasur një dënim më pak se 1 vit ju do të liroheni me kusht. Të rinjtë e dënuar duhet të lexojnë **faqen 159** sepse ata kanë të drejtë të lirohen me kusht nëse janë nën 21 vjeç. Ju duhet të bëni gjërat që kërkohen nga lirimi me kusht, si qëndrimi në një vend të caktuar dhe takimi me menaxherin tuaj të të dënuarve.

Arrestimi në momentin e lirit

Në qoftë se ekziston mundësia të arrestoheni ndërsa liroheni, kjo gjë do t'ju komunikohet nga guvernatori përpara se të dilni, përveç rasteve kur policia kërkon që ju të mos jeni në dijëni. Nëse guvernatori ju tregon se kjo do të ndodhi, ju mund t'i tregoni miqve, familjes dhe avokatit tuaj.

Ligji për rehabilitimin e shkelësve

Ky është një ligj për dënimet kriminale që mund ta ulë (ta zbresë) dënimin tuaj mbas një periudhe kohe.

Kjo predhë kohe quhet **periudha e rehabilitimit**.

- Periudha e rehabilitimit është gjatësi kohe e caktuar prej ditës që jeni dënuar.
- Kohëzgjatja varet nga dënimi që ju është dhënë, jo nga shkelja ose koha e kryer në burg.
- Kur një dënim është ulur, ju nuk keni nevojë ta përmendi kur të aplikoni për një punë, të merrni sigurim ose të përfshiheni në procedurë civile ose kriminale.
- Kur një dënim ulet ai ngelet i ulur, edhe në qoftë se ju dënoheni për një shkelje tjetër më vonë.

Dënimet më të mëdha se 2 ½ vjet nuk ulen asnjëherë.

Këto tabela ju tregojnë që një periudhë rehabilitimi ka mundësi të jetë e një gjatësie të ndryshme nga gjatësia e dënimit. Këto janë për dënimet me burg.

Dënimi	Periudha e rehabilitimit për 18 vjeç e sipër	Periudha e rehabilitimit nën 18 vjeç
Më shumë se 2 ½ vite	Këto nuk ulen kurrë	Këto nuk ulen kurrë
Më shumë se 6 muaj dhe deri më 2 ½ vjet	10 vjet	5 vjet
6 muaj ose më pak	7 vjet	3 ½ vjet
Gjoha, lirim me kusht, shërbim në komunitet, dëmshpërblim, kombinim dhe urdhra mos-dalje	5 vjet	2 ½ vjet
Lirim i pakushtëzuar	6 muaj	6 muaj

Për disa dënime periudha e rehabilitimit mund të ndryshojë

Dënimi	Periudha e rehabilitimit për 18 vjeç e sipër	Periudha e rehabilitimit nën 18 vjeç
Rehabilitimi, mbikëqyrja, urdhër kujdesi, lirim i kushtëzuar ose përlje	1 vit ose deri më sa urdhri të skadojë (ndalojë), kush të jetë më i gjatë	1 vit ose deri më sa urdhri të skadojë (ndalojë), kush të jetë më i gjatë
Urdhër i paraqitjes në qendër, urdhër spitali (me ose pa urdhër kufizimi)	5 vjet ose 2 vjet mbasi të skadojë urdhri, (kush të jetë më i gjatë)	1 vit mbasi urdhri skadon

Kur ju duhet të deklaroni dënimet e ulura

Ju **duhet** të përmendni dënimet e ulura në qoftë se bëni disa punë të caktuara si.

- avokat
- mjek
- dentist
- llogaritar
- infermier
- farmacist

Ju duhet të deklaroni dënimet e ulura në qoftë se aplikoni për një punë ose të jeni vullnetar për një punë me fëmijë dhe te rinj nën moshën 18 vjeç.

Ju **duhet** të përmendni dënimet e ulura në qoftë se punoni si

- shitës armësh
- punonjës kazinoje
- drejtor dhe menaxher i kompanie sigurimesh dhe trustesh
- menaxher i shtëpisë së kujdesit
- disa punë shtetërore
- kontraktor mbrojtje

Ju **duhet** të përmendni dënimet e harxhuara në qoftë se aplikoni për certifikata për

- armë dore
- armë krahu
- eksplozivë

Në qoftë se jeni duke aplikuar për një punë dhe në formën e aplikimit kërkohet informatë për dënimet e pa shpenzuara ju duhet t'i deklaroni ato.

Në qoftë se nuk i deklaroni dhe me vonë zbuloheni, ju mund të pushoheni nga puna për mosdeklarimin e tyre tek punëdhënësit.

Në qoftë se ju do të lëvizni jashtë shtetit ju duhet të kontrolloni si janë rregullat në atë shtet për deklarimet e dënimeve kriminale. Ju mund ta zbuloni këtë nga ambasada e atij vendi.

Shënime kriminale

Të gjitha shkeljet e ulura dhe jo të ulura qëndrojnë tek shënimet tuaja kriminale. Këto shënime janë në kompjuterin kombëtar të policisë.

Këto shënime mund të fshihen në qoftë se nuk i keni krijuar probleme policisë për një kohë të gjatë.

Disa shënime nuk fshihen asnjëherë, edhe në qofte se nuk i keni krijuar probleme policisë për shumë vite. Kjo ndodh për shkak të shkeljes që keni kryer.

Lirimi i përkohshëm me kusht

Lirimi i përkohshëm me kusht do të thotë që të keni mundësi të dilni nga burgu për pak kohë.

Për shembull mund t'ju jepet lirim i përkohshëm me kusht

- ✓ sepse një prind ose bashkëshort është shumë sëmurë
- ✓ për t'ju ndihmuar ju të vendoseni në komunitet kur të mbaroni dënimin

Lirimi përkohshëm me kusht është zakonisht i shkurtuar në ROTL.

- ✗ Jo të gjithë marrin ROTL.

Informacion të mëtejshëm mund të shihni në **Urdhrin 6300 të Shëbimit të Burgut**.

Jo të gjithë marrin ROTL. Të burgosurit të cilët nuk mund të lirohen përkohësisht me kusht janë

- Kategoria A ose ata që janë në listën e arratisjes.
- Të padënuarit ose të dënuar por pa ju dhënë dënimin me burg akoma.
- Subjekt i një procedure shkëmbimi – kërkoheni nga një shtet tjetër sepse mund të keni kryer një shkelje atje.
- I dënuar por në paraburgim nën akuza të tjera ose duke pritur të dënohet për vepra penale të tjera.
- I burgosuri i kategorisë B nuk mund të marrë ditën e rivendosjes ose një lirim përgjatë natës por mund të lejohet të shkojë nëse një anëtar i afërm i familjes po vdes.
- Nëse ju po shërbeni një dënim dhe më vonë merrni dhe një tjetër përmospagesë urdhri konfiskimi, ju mund të aplikoni për ROTL pak më vonë, jo në dënimin tuaj origjinal.
- Të burgosurit me dënim të përjetshëm do të lirohen zakonisht me përkohësisht me kusht nëse ata janë në burg të hapur ose gjysmë të hapur.
- Të burgosurit me dënim të përjetshëm në kushte të mbyllura do të lirohen me përkohësisht me kusht nëse ata mund të jetojnë në burgje të hapura ose gjysmë të hapura por nuk mund të lëvizin për arsye mjekësore.

Ekzistojnë 4 lloje të ndryshme lirimi me kusht, në qoftë se guvernatori mendon se ju jeni të parrezikshëm të dilni nga burgu.

Lirimi i përkohshëm për arsye të veçanta

Kjo është për disa orë dhe jepet për

- të vizituar familjarë në prag të vdekjes të cilët janë anëtarë të afërm të familjes.
- të vajtur në varrim të anëtarëve të afërm të familjes.
- martesë ose shërbime fetare
- trajtime mjekësore – për sa kohë zgjasin vizitat ose trajtimet në spital.
- vajtja në gjyq, seancë ose një hetim.

Lirimi i përkohshëm ditor për rivendosje

Kjo është për

- të marrë pjesë në projekt për punë në komunitet ose veprimtari të tjera që do të bëni jashtë burgut si pjesë e dënimit tuaj që të përgatiteni lirim.
- të jeni në kontakt të vazhdueshëm me familjen.
- trajnim ose kurse edukimi për jetën dhe punën.

Lirimi i përkohshëm përgjatë natës për rivendosje

Këto janë për gjëra të ngjashme me lirim ditor, por gjithashtu që ju të shpenzoni kohë në vendin që do të jetoni mbasi të liroheni nga burgu.

Lirimi i përkohshëm për rivendosje për tu kujdesur për fëmijët

Kjo është për të burgosur të veçantë të cilët janë prindërit ose kujdestarët e vetëm të një fëmije nën 16 vjeç. Kjo leje mund të merret çdo 2 muaj – pra 6 herë në vit.

Skema e lirit të përkohshëm të mbarimit të dënimit (gjithashtu e quajtur ECL)

Kjo është një skemë e përkohshme e cila filloi në vitin 2007.

- ✓ Kjo është për të gjithë të burgosurit që janë të përshtatshëm dhe kanë dënime prej 4 javësh ose më tepër, por më pak se 4 vjet.
- ✓ Fundi i skemës së lirit nga burgimi do të thotë që ju mund të liroheni deri në 18 ditë përpara ditës së caktuar të lirit.
 - × Disa njerëz mund të mos kenë ECL.

Ka më tepër informacion në **Udhëzuesin 42/2007 të Shërbimit të Burgut**. Kjo do të jetë në bibliotekën e burgut.

Në qoftë se ju jeni liruar nën skemën ELC ju duhet të ndiqni rregullat e dënimit tuaj. Ju do të paraqiteni përsëri në burg në qoftë se ju nuk zbatoni kushtet (rregullat) e lirit.

Ju mund të merrni ndihmë të hollash në qoftë se ju jeni liruar nën këtë skemë. Ju nuk mund të kërkonit ndihma sociale deri në ditën e caktuar të lirit.

Për shembull, në qoftë se ju jeni liruar nën skemën me 1 mars por dënimi juaj kishte për t'u mbaruar në 18 mars, ju nuk mund të merrni ndihma sociale deri në 18 mars.

Të burgosur të cilët **nuk mund** të lirohen nën ECL

- Shkelësit seksual të regjistruar.
- Të burgosur që shërbejnë dënimin për dhunë të rëndë.
- Të burgosur që janë arratisur nga arresti më parë.
- Të burgosur që kanë shkelur më parë ndonjë nga kushtet e lirit të përkohshëm.

Më tepër për të burgosurit që nuk mund të lirohen nën ECL

- Të burgosur që nuk kanë një vend për të banuar.
- Të burgosur që do të përzihen në fund të dënimit të tyre.
- Të burgosur që do të ekstradohen.
- Të paraburgosurit që kanë më tepër se një akuzë ose që presin të dënohen për diçka tjetër.
- Të burgosur që janë kërkuar të paraqiten përsëri në burg, arrest shtëpie, urdhër mos dalje ose nën licenca të tjera.
- Të burgosur që duhet të ndjekin një program trajtimi kur lirohen, përveç rastit kur menaxheri juaj i dënimit mund ta organizojë atë në një kohë më të përshtatshme.

Lirimi dhe mbikëqyrja

Ka shumë shkurtime që kanë të bëjnë me lirimimin dhe mbikëqyrjen

- SED – Data e Mbarimit të Dënimit
- LED – Data e Mbarimit të Lirimit të parakohshëm
- SLED – Data e Mbarimit të Dënimit dhe Licencës
- ACR – Lirimi me Kusht i Përnjëhershëm
- ADA – Ditës Shtesë të Shtuara
- AP – Licenca për të gjitha Rrethanat
- HDC – Dënimi me Mos-dalje nga Shtëpia
- ARD – Data e Lirimit të Përnjëhershëm
- NPD – Data e Mos-Lirimit të Parakohshëm
- CRD – Data e Lirimit të Kushtëzuar

Data në të cilën liroheni me ose pa mbikëqyrje, dhe për sa kohë do të zgjasë mbikëqyrja, varen nga gjatësia e dënimit tuaj dhe kur jeni dënuar.

Është paksa e ndërlikuar.

Nëse keni ndonjë pyetje ju duhet të pyesni punonjësit e burgut ose menaxherin tuaj të shkeljeve.

Dënimi me mos-dalje nga Shtëpia (HDC)

Të burgosurit që po kryejnë dënime prej 3 muajsh deri në 4 vjet mund të lirohen nën dënimin me mos-dalje nga shtëpia. Kjo gjithashtu quhet tagim.

Kjo do të thotë që do të mbani një tag elektronik që do të përdoret për t'ju kontrolluar.

Ju duhet të ndiqni rregullat për vendet ku mund të shkoni dhe në çfarë kohe duhet të ktheheni mbrapsht në shtëpi.

Më tepër përmbi HDC

Në qoftë se ju do të liroheni në bazë të dënimit me mos-dalje nga shtëpia, ju **duhet** të keni një vend për të jetuar kur të lëshoni burgun. Nëse nuk keni ku të shkoni pyesni **Shërbimin përkrahës të strehimit Clearsprings** nëse mund t'ju gjejnë një vend për të jetuar.

Ata mund t'ju japin një vend për të jetuar në një shtëpi të vogël ose apartament. Ajo mund të jetë diku që ju ndani vendbanimin deri me 4 veta. Ju duhet të gatuani, pastroni dhe të paguani qira.

Strehimi Clearsprings është vetëm për kohën që ju jeni në dënimin me mos-dalje nga shtëpia.

Ju duhet të shërbeni tre të katrat ose 30 ditë (kush të jetë më e gjatë) të dënimit tuaj në burg. Ju mund të jeni në HDC deri në 135 ditë (4 muaj e gjysmë).

Stafi do të kontrollojë dhe do shohë në qoftë se HDC-ja do t'ju përshtatet. Kjo varet në qoftë se ju nuk jeni i rrezikshëm kundrejt të tjerëve nëse ju dilni nga burgu.

Ju mund të zgjidhni të **mos** liroheni nën HDC-në.

Në qoftë se nuk iu jepet HDC-ja ju mund të apeloni. Përdorni procedurën e ankesave ta bëni këtë.

Në qoftë se ju nuk zbatoni mos-daljen nga shtëpia për arsye që janë jashtë kontrollit tuaj, të tilla si pamundësia të vazhdoni të jetoni në adresën tuaj të rënë dakord, ju mund të kërkoni të liroheni përsëri nën HDC-në.

Në qoftë se ju jeni paraqitur përsëri në burg për shkelje të HDC-së tuaj ju mund të mos liroheni më në të ardhmen nën HDC-ën. Kjo do të varet në qoftë se Ligji i drejtësisë kriminale i vitit 1991 ose 2003 aplikohet në rastin tuaj. Në qoftë se nuk jeni i sigurt bisedoni me një anëtar të stafit.

Më tepër për HDC

Në qoftë se ju jeni paraqitur përsëri në burg ju mund të apeloni kundër kësaj.

Disa të burgosur nuk do të marrin **asnjëherë** HDC. Për shembull

- Të burgosur që duhet të firmosin regjistrin e të dënuarve seksualë.
- Të dënuar të dhunshëm dhe seksual, të cilët po vuajnë një dënim të zgjatur.
- Të dënuarit që nuk kthehen mbas lirit parakohshëm me kusht.
- Të burgosur në burg me urdhër nga spitali, udhëzime nga spitali ose udhëzim transferimi.
- Të burgosur që po kryejnë dënim për moszbatimin e urdhrit të mos-daljes.
- Disa të burgosur të paraqitur përsëri në burg për moszbatimin e kushteve të mos-daljes së HDC-së.
- Të burgosur që mund të largohen nga MB.
- Disa të burgosur të cilët, janë kthyer në burg ndonjëherë për kryerjen e një shkelje përpara mbarimit të periudhës së tyre 'në rrezik'.
- Të burgosurit të cilët, në momentin e dënimit kanë më pak se 14 ditë të mbetura për të arritur gjysmën e dënimit me burg.
- Të burgosurit të cilët nuk kanë paguar një gjobë ose nuk kanë përmbushur udhëzimet e gjyqit (mospërfillje gjyqi).

Informacion i mëtejshëm gjendet në **Urdhrin 6700 të Shërbimit të Burgut**.

Lirim i parakohshëm

Ekziston informacion i veçantë përmbi lirimin para kohe të burgosurve që janë në dënime të gjata – si burgime të përjetshme ose burgime pa afat për mbrojtjen e publikut. Pyesni punonjësit e burgut ose menaxherin tuaj të shkeljeve për këtë informacion.

- ✓ Lirimi para kohe ndodh kur liroheni më herët nga burgu nën mbikëqyrjen e shërbimit të rehabilitimit përpara fundit të dënimit tuaj.
- ✓ Ju mund të aplikoni (të kërkon) për lirim para kohe 6 muaj përpara ditës më të afërt që ju mund të liroheni.
- ✓ Shumica e vendimeve për lirim para kohe merren nga një grup i pavarur njerëzish i quajtur Bordi i lirit para kohe.
- ✓ Rregullat për lirim para kohe janë të ndryshme për të burgosurit që janë qytetarë të MB dhe shtetasve të huaj.
- ✓ Ju mund të pyesni zyrtarin e lirit para kohe në burg nëse dëshironi informata përmbi lirim para kohe.

Lirimi para kohe për të burgosurit të cilët janë qytetarë të MB

Lirimi është një mënyrë që ju mund të liroheni nga burgu me kusht. **Shihni faqen 136.**

Për shumicën e të burgosurve, lirimi me kusht është vendosur nga një grup i pavarur njerëzish i quajtur **Bordi i lirit para kohe**. Bordi nuk është pjesë e shërbimit të burgut ose Ministrisë së Drejtësisë. Ata janë tërësisht të pavarur.

Për të vendosur nëse ju mund të liroheni para kohe, Bordi merr në konsideratë

- ✓ Raporte nga punonjësit e burgut.
- ✓ Raporte nga punonjësit e rehabilitimit.
- ✓ Të dhëna për shkeljen tuaj fillestare (shkakun që u dërguat në burg).
- ✓ Sjelljen tuaj në burg.
- ✓ Nëse keni ndihmë nga miqtë dhe familja dhe një vend për të jetuar.
- ✓ Çfarë plani ka për lirim tuaj – të tilla si, keni një punë?

Më shumë për lirim para kohe për shtetasit e MB.

Ju mund të aplikoni (të kërkontë) lirim para kohe 6 muaj përpara se të arrini gjysmën e dënimit tuaj. Data në të cilën ju mund të lëshoheni me lirim para kohe quhet Data e përshtatshme për lirim para kohe (PED).

Ju nuk jeni i detyruar të aplikoni për lirim para kohe nëse nuk dëshironi.

4 muaj përpara PED-së tuaj, ju do të pyeteni nëse dëshironi të shihni të gjithë raportet që janë dërguar tek Bordi i lirimit para kohe. Këto raporte quhen **Dosja e juaj e lirimit para kohe**.

Ju mund t'i përdorni këto raporte për t'ju ndihmuar të shpjegoni me shkrim përse ju kërkontë të merrni lirim para kohe dhe çfarë do të bëni nëse do të liroheni.

2 muaj përpara PED-së tuaj disa njerëz nga Bordi i lirimit para kohe do të mblidhen për të shqyrtuar çështjen tuaj. Ky grup i vogël quhet **Paneli**.

Ata mund të dëshirojnë të bisedojnë me ju përpara se të marrin vendim.

Ju do t'ju tregohet data dhe koha e këtij takimi. Ju do të takoheni me 1 anëtar Paneli.

E gjithë kjo duhet të kryhet që ju të merrni vendimin nga Bordi i lirimit përpara kohe përpara datës së përshtatshme për lirim përpara kohe.

Bordi i lirimit përpara kohe do të marrë parasysh rreziqet kundrejt publikut dhe përfitimet tuaja nëse liroheni përpara kohe.

Çfarë	Kur
Kërkoni lirim para kohe	6 muaj para datës së përshtatshme për lirim përpara kohe
Data e përshtatshme e lirimit përpara kohe (PED)	Data më e afërt ju mund të liroheni para kohe
Shihni dosjen e lirimit përpara kohe dhe shkruani përse ju kërkontë lirim para kohe.	4 muaj përpara PED-it tuaj
Mblidhet Paneli nga Bordi i lirimit para kohe	2 muaj përpara PED-it tuaj
Takimi me dikë nga paneli	Në një kohë gjatë 2 muajve
Bordi i lirimit para kohe merr vendimin	Përpara PED-i i juaj në kohë të mjaftueshme kështu që të jeni gati për të marrë lirim tuaj para kohe

Të informohesh për lirim para kohe

Bordi i lirit para kohe me të marrë vendimin për lirim tuaj para kohe do t'ju tregojë ju dhe burgut.

Ka 2 përjashtime në këtë rregull

1. Nëse ju keni kryer 15 vjet ose më shumë.
2. Nëse ju është dhënë dënimi me burg para 1 tetorit 1992.

Nëse ju përbëni një rast të tillë, Bordi i lirit para kohe duhet ti tregojë Sekretarit të Shtetit se çfarë mendojnë. Sekretari i Shtetit atëherë merr vendimin për lirim tuaj para kohe.

Nëse ju refuzoheni (nuk ju jepet) liri para kohe

Arsyet e refuzimit të Bordi të lirit para kohe do ti dërgohen me shkrim burgut. Ju mund të shihni një kopje.

Ju **nuk mund** të apeloni kundër këtij vendimi thjesht se ju nuk pajtoheni me të.

Ju **mund** të ankoheni për mënyrën në të cilën u trajtua aplikimi juaj nëse mendoni se kjo nuk u krye në mënyrë korrekte.

Ju mund të gjeni më shumë informacion për ankesat në **faqen 110**.

Për shembull, ju mund të ankoheni nëse mendoni që

- I gjithë informacioni për të mbështetur kërkesën tuaj për lirim para kohe nuk është dërguar te Bordi i lirit para kohe.
- Procedura (si duhet të bëhen gjërat) e kërimit për lirim para kohe nuk ishte ndjekur në mënyrë të rregullt.

Ju duhet të bisedoni me një avokat në qoftë se ju mendoni që vendimi ishte i gabuar.

Më tepër rreth refuzimit të lirit para kohe

Në qoftë se liri juaj i parakohshëm ishte refuzuar çështja juaj mund të rishqyrtohet çdo vit. Kjo varet nga gjëra si, sa kohë keni të mbetur në dënimin tuaj përpara Datës së mos-lirit të parakohshëm (NPD).

Ju gjithashtu mund të keni një rishqyrtim të ri ose të veçantë. Kjo do të thotë që kërkesa juaj për lirim para kohe do të shqyrtohet përsëri së shpejti.

- Rishqyrtime të mëparshme ose të veçanta nuk jepen shumë shpesh.
- Ato shumicën e rasteve përdoren të kontrollojnë se si i ndiqni kurset për punësim, rehabilitim droge, e kështu me radhë.
- Ju gjithashtu mund t'ju jepen një rishqyrtim i veçantë në qoftë se nuk kishte kohë të mjaftueshme për të rishqyrtuar kërkesën tuaj për lirim para kohe përpara mbarimit të dënimit tuaj.

Lirimi para kohe dhe shtetasit e huaj

Ekzistojnë 2 ndryshime të mëdha për lirim të parakohshëm të shtetasve të huaj

- Në qoftë se i plotësoni kushtet për lirim të parakohshëm ju do të konsideroheni vetvetiu për atë. Ju nuk mund të zgjidhni.
- Vendimet për lirim të parakohshëm merren nga guvernatori i burgut, përveç rasteve kur jeni dënuar për një vepër penale seksuale ose të dhunshme, kur vendos Ministria e Drejtësisë.

Në qoftë se ju jeni i burgosur i një kombësie të huaj, ju mund të dërgoheni shpejt në vendin tuaj nën Skemën e kthimeve të parkohëshme. **Shih faqen 151.**

Mbikëqyrja e institucioneve për të dënuarit e rinj – shih faqen 159

Në qoftë se ju keni një dënim prej më pak se 12 muaj atëherë do të jeni nën mbikëqyrje për të paktën 3 muaj mbas lirimit, pavarësisht nga sa i shkurtër është dënimi juaj.

- Ju duhet të raportoni rregullisht te menaxheri i lirimit të parakohshëm të të dënuarve.
- Mbikëqyrja do të përfundojë mbas 3 muajsh ose kur ju mbushni 22 vjeç, kushdo që të vijë e para.
- Në qoftë se ju shkelni kushtet e mbikëqyrjes suaj ju mund të gjobiteni ose të dënoheni me 30 ditë në burg.

Dënimet e të rriturve deri në 12 muaj.

Lirimi juaj do të jetë i pakushtëzuar (AUR).

Ju **nuk** do të jeni të mbikëqyrur nga një menaxher i të dënuarve.

Ju do t'ju jepet informacion i quajtur njoftim. Njoftimi do të shpjegojë kuptimin e tij dhe ju duhet ta nënshkruani.

- **Në qoftë se ju e keni kryer veprën tuaj penale përpara 4 prillit 2005 lexoni pjesën që fillon në faqen 146.**
- **Në qoftë se ju e keni kryer veprën tuaj penale në ose pas 4 prillit 2005 lexoni pjesën që fillon në faqen 148.**

➤ Veprat penale përpara 4 prillit 2005

Pikat kryesore

Kohëzgjatja e dënimit	Lloji i lirimit
12 muaj deri në 4 vjet	Lirimi me kusht i përnjëhershëm ARC
4 vjet e sipër	Mbarimi i dënimit ose lirimit para kohe
Dënim i zgjatur	Mbarimi i dënimit ose lirimit para kohe por do të jetë më i gjatë në lirim me kusht

Mbi 12 muaj ose më pak se 4 vjet (përpara 4 prillit 2005)

- Lirimi me kusht dhe mbikëqyrja do të zgjasin deri sa të keni pothuajse mbaruar dënimin – 3 të katërtat e kryerjes së dënimit.
- Disa të burgosur të dënuar për çështje seksuale mbikëqyren deri në fund të dënimit të tyre.
- Çdo ditë tjetër e shtuar (ADA) që ju është dhënë në një gjykim do t'ju shtohet. **Shih faqen 89.**
- Data kur ju mbaron lirim me kusht quhet Data e përfundimit të lirimit.
- Ju mund të ktheheni në burg në qoftë se ju nuk e zbatoni lirim me kusht.
- Gjyqi mund tu dërgojë përsëri në burg në qoftë se ju kryeni një shkelje tjetër përpara Përfundimit të datës së lirimit tuaj me kusht.

Përpara lirimit tuaj ju do t'ju jepet Licenca e lirimit me kusht të përnjëhershëm.

Kjo shpjegon kushtet e lirimit tuaj dhe jep emrin dhe adresën e oficerit mbikëqyrës tuaj.

Kushtet do të jenë

- Raportimi i rregullt te menaxheri juaj i të dënuarve.
- Banimi te një adresë e aprovuar.
- Të keni vizita nga menaxheri i juaj i të dënuarve.
- Të mos përziheni në ngatërresa.

Në qoftë se ju nuk zbatoni kushtet e lirimit tuaj ju mund të thirreni përsëri në burg.

Në qoftë se ju e keni kryer veprën penale për të cilën u dërguat në burg **përpara 1 janarit 1999** dhe shkelni kushtet e lirimit, kjo atëherë do të sqarohet nga gjyqi.

Në qoftë se ju e keni kryer veprën penale për të cilën u dërguat në burg **pas 1 janarit 1999** dhe nuk zbatoni marrëveshjen e lirimit, shërbimet e lirimit me kusht duhet të aplikojnë në Ministrinë e Drejtësisë që të kërkojnë ri-thirrjen tuaj.

4 vjet e sipër (përpara datës 4 prill 2005)

- Kur ju jeni të liruar, në lirim përpara kohe ose në Datën tuaj të mos-lirimit përpara kohe, licenca dhe mbikëqyrja do të zgjasë deri sa ju të keni pothuajse përfunduar dënimin tuaj – treçerekun e dënimit.
- Për disa të dënuar për çështje seksuale lirimi dhe mbikëqyrja zgjat deri në fund të dënimit të tyre.
- Ju do të jeni në rrezik deri në Datën e përfundimit të dënimit.

Dënime të zgjatura (shkelje përpara 4 datës prill 2005)

Një dënim i zgjatur ka 2 pjesë

- Kohë në burg.
- Kohë në lirim me kusht.

Për shembull

Në qoftë se dënimi juaj është 4 vjet, është i përbërë prej 2 vitesh në burg dhe 2 vite në lirim me kusht.

Ju duhet të shërbeni gjysmën e dy viteve në burg – kjo është 1 vit. Atëherë ju duhet të bëni 6 muaj në licencë, që është normale për këtë gjatësi kohe në burg, plus një 2 vjeçar shtesë në lirim me kusht. Dënimi juaj përfundon mbas 4 vjetësh.

Lirimi përpara kohe do të vendoset nga Bordi i lirimit përpara kohe në qoftë se dënimi i juaj është 4 vjet ose më shumë kjo mund të ndodhë në çdo kohë mbasi keni shërbyer gjysmën e dënimit tuaj.

Në qoftë se ju shkelni kushtet e lirimit tuaj menaxheri juaj i të dënuarve mund të aplikojë që ju të ri-thirreni në burg.

➤ Shkeljet e kryera në ose mbas 4 prillit

Dënime standardë prej 12 muajsh ose më tepër por më pak se 4 vite (për shkelje në ose mbas 4 prillit 2005)

Ju do të liroheni nën një Lirim me kusht gjithëpërfshirës. Ju do të jeni në lirim me kusht dhe nën mbikëqyrje deri në fund të dënimit tuaj (SLED).

Përpara lirimit tuaj ju do t'ju jepet Lirimi me kusht gjithëpërfshirës. Kjo ju tregon kushtet e lirimit tuaj dhe ju jep emrin dhe adresën e oficerit tuaj mbikëqyrës.

Kushtet për dënimin standard prej 12 muajsh por më pak se 4 vjet do të jenë

- Raportimi rregullisht te menaxheri i të dënuarve
- Banimi në një adresë të aprovuar.
- Të vizitoheni nga menaxheri i të dënuarve.
- Të mos përfshiheni në ngatërresa.

Në qoftë se ju shkelni kushtet e lirit tuaj ju mund të gjobiteni ose të riktheheni përsëri në burg.

Dënime të zgjatura (për dënime në ose mbas 4 prillit 2005)

Një dënim i zgjatur ka 2 pjesë

- Kohë në burg.
- Kohë në licencë.

Për shembull, dënimi juaj është 8 vjet dhe bëhet prej 3 vitesh në burg dhe 5 vite në lirim me kusht. Në gjysmën e kohës tuaj në burg (1 ½ vite), bordi i lirit përpara kohe do të vendosë në qoftë se ju mund të liroheni.

Në qoftë se ju nuk liroheni, ju do të qëndroni në burg deri në fund të kohës që ka thënë gjyqi se ju duhet të shërbeni.

Kur liroheni, ju jeni në lirim me kusht për të gjithë pjesën tjetër të dënimit tuaj.

Ri-thirrja ose rikthimi i lirit me kusht

Nëse jeni paraqitur përsëri në burg ju do t'ju jepet një dosje e quajtur **Pako Përfaqësuese**. Kjo pako është për t'ju ndihmuar të apeloni kundër vendimit për t'u rikthyer në burg.

Bordi i lirit para kohe shqyrton ri-thirrjet në burg. Ata shqyrtojnë çështjen tuaj brenda 28 ditëve që nga koha që ju do të ri-thirreni në burg. Bordi i lirit vendos nëse kjo është e drejtë.

Nëse kërkonte të apeloni, bëjeni shpejt këtë gjë. Ju mund t'i shkruani Bordit të lirit para kohe dhe mund të kërkonte të takoni e të bisedoni me ta.

Më shumë rreth ri-thirrjes

Nëse jeni liruar nga burgu me kushte, ose nën licencë e cila shpjegon çfarë duhet të bëni, në qoftë se nuk ndiqni rregullat ju mund të ri-thirreni përsëri në burg. Kjo mund të jetë sepse kryeni përsëri një vepër penale ose shkelni disa rregulla të tjerë. Kjo quhet shkelje e licencës.

Në qoftë se ju nuk i përmbajeni kushteve të licencës suaj, kjo është çfarë do të ndodhi

- Çfarëdo lirim me kusht që keni pasur do t'u hiqet (zhvlerësohet) përnjëherë.
- Do të njoftohet policia (ajo lokale dhe kombëtare) si dhe shërbimet e rehabilitimit dhe të burgut ku ju ishit herën e fundit.
- Ju do të arrestoheni dhe do të ktheheni në burgun më të afërt.
- Burgu që po mbaheni, si dhe shërbimi i rehabilitimit, do të njoftojnë drejtorinë për kthimin tuaj në burg.
- Një pako përfaqësimi do t'ju dërgohet dhe do ju pyesin në se dëshironi të apeloni kundër vendimit për rikthimin tuaj përsëri në burg.
- Bordi i rehabilitimit duhet të shqyrtoj çështjen tuaj të rikthimit me ose pa apelimin tuaj brenda 28 ditësh. Ata do të kundërshtojnë ose do të pranojnë vendimin për t'ju rikthyer, do të caktojnë një datë për ri-lirimin tuaj ose do të caktojnë një datë në të ardhmen që rikthimi juaj të shqyrtohet përsëri.
- Ju mund të bisedoni me një avokat për këtë në qoftë se keni nevojë.

Të burgosurit e kombësive të huaja

Skema e largimit të shpejtë e të burgosurve të kombësisë së huaj - ERS

Kjo skemë i lejon të burgosurit e kombësisë së huaj të largohen nga MB përpara se dënimi i tyre të ketë mbaruar.

Informacioni mbi ju do ti dërgohet Agjencisë të kufijve dhe emigracionit.

Agjencia e kufijve dhe emigracionit do t'ju tregojë ju nëse ju duhet të largoheni nga MB dhe do të organizojnë udhëtimin tuaj për në vendin tuaj.

Ju do të kryeni në burg një periudhë minimale përpara se të ktheheni mbrapsht.

Koha më e gjatë për ERS është deri më 270 ditë. Disa të burgosurve nuk do t'ju jepet ERS. Për shembull

- Të burgosurit të cilët duhet të nënshkruajnë regjistrin e shkelësve seksualë.
- Shkelësit e dhunshëm dhe seksualë tashmë me një dënim të zgjatur.
- Të burgosurit që po kryejnë një dënim për mos kthim mbasi janë liruar në një lirim të përkohshëm.
- Të burgosurit me një urdhër spitali, urdhëresë spitali ose urdhëresë transferimi.
- Të burgosurit që po kryejnë një dënim për një mos zbatim të një urdhri mos dalje.
- Të burgosurit që janë paraqitur përsëri në burg në çfarë do kohë për mos ndjekje të kushteve të ndalimit HDC.
- Të burgosurit që përgjatë dënimit të tanishëm janë liruar me HDC ose ju është dhënë lirim i mëshirshëm dhe janë paraqitur përsëri në burg.
- Të burgosurit të cilët në çfarë do kohe janë paraqitur përsëri në burg përpara se të ketë mbaruar periudha në rrezik e dënimit të tyre.
- Të burgosurit që në pikën e dënimit i kanë ngelur më pak se 14 ditë përpara se të arrijnë gjysmën e dënimit të tyre.
- Të burgosurit që nuk kanë paguar një gjobë dhe nuk kanë ndjekur çfarë ju ka kërkuar të bëjnë gjyqi (mos përfillje gjyqi).

Në qoftë se ju nuk jeni larguar në bazë të ERS, ju do të vazhdoni me dënimin tuaj.

Përzënia

Agjencia e kufijve dhe emigracionit do t'ju tregojë nëse ju do të përziheni në fund të dënimit tuaj.

Ata do t'i dërgojnë (japin) burgut një Urdhër mbajtje imigracioni.

Ju ose do të qëndroni në burg mbasi të përfundojë dënimi ose do të dërgoheni në një qendër mbajtje imigracioni ku do të qëndroni deri sa të përziheni (largoheni) nga MB-ja.

Në qoftë të se ju nuk doni të përziheni ju duhet të bisedoni me një avokat për të marrë vesh nëse mund të apeloni.

Ju mund të gjeni informacion të mëtejshëm në **Urdhrin 5630 të Shërbimit të Burgut**.

Riatdhesimi

MB-ja ka marrëveshje riatdhesimi me disa vende. Kjo do të thotë se disa të burgosur mund të kthehen mbrapsht në vendin e tyre.

Ju mund të riatdhesoheni nëse

- Ju jeni një shtetas i vendit në të cilin kërkonit të ktheheni.
- Dënimi juaj është përfundimtar dhe nuk keni apel pezull.
- Shkelja që keni kryer do të jetë edhe në vendin tuaj një shkelje e ndëshkuar me burg.
- Në kohën që bëni aplikimin ju keni së paku 6 muaj të mbetur nga dënimi para se të liroheni.

Punonjësit e burgut do të kontrollojnë nëse MB ka një marrëveshje riatdhesimi me vendin tuaj.

Ju duhet të përdorni procedurën e kërkesë/ankesë të burgut që të fillojë procesi për të parë nëse mund të riatdhesoheni.

MB-ja dhe vendi juaj duhet të bëjnë një kërkesë zyrtare për riatdhesim.

Ju mund të pyesni një punonjës zyrtar që punon në ambasadën e vendit tuaj për të bërë një aplikim për ju.

Ju mund të gjeni listën e ambasadave në **Urdhrin 4630 të Shërbimit të Burgut**. Mund të ketë një vonesë të gjatë për të vendosur kërkesën e riatdhesimit, disa herë deri në 2 vjet.

MB-ja zakonisht do të refuzojë kërkesa për riatdhesim vetëm në qoftë se

- Ju do të shërbeni më pak kohë në burg në qoftë se ju jeni transferuar jashtë
- Ju keni një gjobë ose urdhër juridik ose urdhër pagese pezull.

Në qoftë se ju jeni riatdhesuar, ju duhet të kryeni periudhën e mbetur të dënimit që ju është dhënë në MB.

Ju do të ndiqni rregullat e vendit që ju do të shkoni për rishqyrtim dënimi, lirim dhe mbikëqyrje.

Ju do t'ju thuhet çdo ndryshim përpara se të firmosni marrëveshjen e riatdhesimit tuaj.

Ju mund të gjeni më tepër informacion për **Ligjin e vitit 1984 për riatdhesimin e të burgosurve – Informacione për të burgosurit e huaj**, në bibliotekën e burgut.

Ky informacion është gjithashtu në danisht, holandisht, anglisht, finlandisht, frëngjisht, gjermanisht, greqisht, italisht, portugalisht, spanjisht, suedisht dhe turqisht.

Transferimet në burgjet e Skocisë, Irlandës së Veriut, Ishujt e Kanalit dhe Ishullin e Robit

Transferimi nga burgjet e Anglisë ose të Uellsit në këto vende quhen **transferime në juridiksione të tjera**.

Ju mund të kërkonte një transferim të përhershëm që t'ju mundësojë të keni vizita nga familja dhe miqtë.

Burgjet e të dy vendeve duhet të bien dakord për transferimin.

Ka 2 lloje transferimi.

- I pakufizuar – dënimi juaj do të jetë i menaxhuar plotësisht nga zona që ju do të dërgoheni dhe ju do të zbatoni rregullat e tyre për lirim dhe mbikëqyrjen në lirim.
- Të kufizuar – Angli dhe Uells do të kenë kondita të pa ndryshueshme transferimi. Ato mund të jenë për lirim, mbikëqyrjen në lirim ose ri-paraqitjen.

Më tepër për transferimet

Për të pasur një shans të mirë që t'ju pranohet kërkesa transferimi, ju

- Duhet të keni të paktën 6 muaj të mbetura për t'u bërë përpara datës tuaj të lirimit.
- Nuk duhet të keni apele të pa kryera kundër një dënimi ose burgimi.
- Nuk duhet të shkoni më në gjyq.

Gjëra që do të shikohen si pjesë e aplikimit të transferimit tuaj janë

- Pse ju doni të transferoheni.
- Në qoftë se ju keni jetuar shumicën e kohës në vendin që ju doni të ktheheni.
- Në qoftë se ju keni familje dhe miq e të afërm atje.
- Në qoftë se ju keni treguar që ju keni plane për të jetuar atje mbas lirimit.

Ju gjithashtu mund të kërkonte që liri juaj me kusht të mbikëqyret në Skoci, Irlandë të Veriut, Ishujt e Kanalit ose Ishullin e Robit. Pyesni menaxherin e shkelësve, si ta bëni këtë.

Të rinjtë e dënuar dhe institucionet e të rinjve të dënuar

Kjo pjesë është për shkelësit e rinj nga 18 deri në 21 vjeçar. Tregon disa nga ndryshimet ndërmjet Institucioneve të shkelësve të rinj dhe burgjeve të tjerë.

- Ju duhet të dini gjërat që janë biseduar në pjesën tjetër të këtij libri.
- Institucionet e shkelësve të rinj quhen zakonisht për shkurt **YOIs**.

Një anëtar stafi i quajtur **oficeri personal** do t'ju ndihmojë përgjatë kohës që qëndroni në YOI. Bisedoni me ta nëse keni ndonjë pyetje ose kërkoni ndihmë.

Ku do ta kryeni dënimin tuaj

- Ju do ta kryeni dënimin tuaj në një institut për të rinjtë shkelës (**YOI**). YOI i juaj mund të jetë më vete ose pjesë e një burgu për të rritur.
- Në qoftë se jeni në arrest, ju mund të jeni në një qendër arresti të YOI-t ose në një burg lokal të rriturish deri në përfundimin e gjyqit.

Kush e vendos se ku do ta kryeni dënimin tuaj

Nëse keni çdo lloj dënimi të përjetshëm

(mbajtje e përjetshme, burgim i përjetshëm, nën Autoritetin Madhësisë së Saj)

- Stafi i YOI-t në të cilin dërgoheni në fillim mbasi jeni dënuar, duhet të plotësojë një numër raportesh mbi ju.
- Kur këto të kryen, ju do të dërgoheni në një vend të quajtur 'Qendra e të burgosurve të përjetshëm' për të pritur vendim përfundimtar ku do të shkoni. Punonjësit e zyrës qendrore do të vendosin ku do të shkoni përfundimisht për të kryer dënimin tuaj.

Për dënimet e quajtura dënime të burgosjes

- Burgu i juaj lokal ose qendra e paraburgimit ku po mbaheni do të vendosi në cilin YOI do të shkoni.

Çfarë do të ndodhë kur të shkoni në fillim në YOI

Për disa ditë mbasi ju shkoni në YOI ju do të keni diçka të quajtur një **prezantim**. Këtu keni mundësinë që

- Ju të pyesni punonjësit e burgut pyetje ose bisedoni me ata për çdo gjë që jeni të shqetësuar.
- Ju dhe punonjësit e burgut të bisedoni gjithashtu për çfarë mund të bëni përgjatë kohës që jeni në YOI.

Plani i dënimit tuaj (nëse dënimi juaj është 4 javë ose më shumë)

- Punonjësit e burgut do të punojnë me ju për të bërë një plan të quajtur **plani i dënimit**.
- Ky plan përshkruan gjërat që ju dhe stafi keni pranuar që do të bëni përgjatë kohës në YOI. Për shembull, do të përshkruajë edukimin dhe punën që do të kryeni.
- Në qoftë se ju keni më pak se 3 muaj të mbetura në YOI tuaj, plani do të tregojë çfarë duhet të bëni për t'u bërë gati për jetën mbasi të dilni.
- Plani i dënimit tuaj do të vazhdoj të paktën për 3 muaj mbasi ju të largoheni nga YOI-në. Kjo ndodh pasi dikush nga shërbimi i rehabilitimit (zakonisht menaxheri i juaj i dënimit) do të punojë me ju që të shohë si ju jeni duke vazhduar mbasi jeni larguar nga YOI.
- Njerëz të quajtur **menaxherët e dënimit** dhe **mbikëqyrësit e të dënuarve** do t'ju ndihmojnë të bëni të gjitha gjërat në planin tuaj të dënimit. Menaxheri i dënimit është dikush nga shërbimet e rehabilitimit jashtë burgut. Mbikëqyrësi i të dënuarit është dikush brenda burgut. Oficeri juaj personal do t'ju ndihmojë gjithashtu me këtë.

Gjëra që mund të bëni ndërkohë që jeni në YOI

Edukim

- Ju do të keni mundësin të mësoni gjëra të tjera ndërkohë që ju jeni në YOI.
- Të gjithë YOI-të kanë klasa ku ju mund të shkoni dhe të mësoni gjëra. Për shembull, ju mund të merrni ndihmë me gjëra si lexim, shkrim dhe përdorim i numrave në qoftë se keni nevojë.
- Shumica e klasave janë gjatë ditës por mund të ketë disa dhe mbas dite.

Trajnimi

- Ka shumë trajnime që ju mund të merrni. Trajnimi mund t'ju ndihmojë të mësoni profesione të tjera ose të gjeni punë.
- Trajnimi gjithashtu mund t'ju ndihmojë të merrni kualifikime. Kualifikimet janë diçka që ju mund të merrni mbas ju keni kaluar një provim, si NVQ.
- Ju gjithashtu mund të keni mundësinë të punoni si vullnetar në komunitetin lokal, por vetëm në qoftë se stafi i burgut mendon që kjo nuk është e rrezikshme.

Edukimi fizik (gjërat si sportet ose palestra)

- Ju do të keni mundësinë të bëni gjëra si ushtrime dhe sport për të paktën 2 orë në javë.
- Ju mund t'i bëni këto gjëra përgjatë ditës, në mesditë ose në fundjavë.
- Kjo mund të ndodhë brenda dhe jashtë ndërtesës së burgut. Ju duhet të keni mundësinë që çdo ditë të shpenzoni një pjesë të kohës jashtë në ajër të pastër.
- Në qoftë se ju keni një dëmtim ose keni nevojë për një lloj të veçantë ushtrimi atëherë ju duhet të keni mundësinë të merrni ndihmë për këtë.

Kohë e lirë (disa herë e quajtur shoqërim)

- Në shumicën e YOI-ve ju mund të keni të paktën 1 orë në ditë të kryeni gjëra të tilla si, të shpenzoni kohë më të burgosur të tjerë, të luani lojëra ose të shikoni TV.

Besimi

- Ju mund të shkoni në një shërbim fetar të YOI-në tuaj çdo javë.
- Duhet të ketë shërbime për besime të ndryshme. **Shih faqen 78.**

Duhani

- Ju **nuk mund** të pini duhan në zonat për njerëzit nën 18 vjeç.
- Ju mund të lejoheni në **disa** zona të YOI-së për njerëzit të moshës 18 deri më 20 vjeç, ka shumë mundësi jashtë, dhe disa herë në qelinë tuaj.

Përgatitja për jetën mbas YOI-së

- Ju do të merrni ndihmë nga stafi i burgut të bëheni gati për jetën mbasi largoheni nga YOI-në.
- Ato do të bisedojnë me ju për gjëra si, të takimet me menaxherin e të dënuarve, ku do të jetoni, puna, shëndeti, droga, të hollat dhe familja juaj.

Çfarë do të ndodhë mbasi ju largoheni

Mbasi të largoheni nga YOI-ja ju duhet të ndiqni disa rregulla për së paku 3 muaj mbasi të jeni liruar ose deri kur të mbushni 22 vjeç, cila prej tyre të jetë më afër. Do të jetë më gjatë nëse shpenzoni më shumë kohë në një YOI.

Kjo quhet të qenit në **mbikëqyrje**. Dikush nga shërbimi i rehabilitimit, ka shumë mundësi menaxheri i juaj i shkelësve, do të punojë me ju dhe të shikojë si po shkoni mbas lirit nga YOI.

- Ju do të jeni në mbikëqyrje përveç rasteve të renditura
 - ju u dënuat për mos pagesën e një gjobe ose mos zbatimin e udhëzimeve të gjyqit (kjo quhet shpërfillje e gjyqit)
 - ju jeni 22 vjeçar kur dilni nga YOI.
- Dikush nga shërbimi i rehabilitimit do t'ju kontrollojë ju për së paku 3 muaj mbasi jeni liruar nga YOI.
- Kur të largoheni nga YOI-ja ju do t'ju jepet një dokument i quajtur licencë. Licenca do t'ju tregojë rregullat që duhet të ndiqni mbasi jeni liruar.
- Ligji thotë që ju duhet të ndiqni udhëzimet e licencës. Ju duhet të tregoni në qoftë se nuk kuptoni çfarë thotë licenca.
- Në qoftë se thyeni rregullat e licencës tuaj ju mund t'ju duhet të paguani një gjobë ose mund të shkoni përsëri në YOI.
- Nëse liroheni në **lirim para kohe**, ju duhet të ndiqni rregullat e licencës deri në datën që do të liroheshit në fillim. Kjo quhet Data e mos lirit para kohe.

Indeksi

Subjekti (Lënda)	Faqe
A	
Adjudications (gjykimet)	89
- on report (në raport)	90
- pleading guilty (pranon fajësinë)	92
- pleading not guilty (nuk pranon fajësinë)	93
AIDS(SIDA)	70-71
alcohol problems (problemet e alkoolit)	73, 77
appealing (apelimi)	22
arrival (mbërritja)	5
assessment (vlerësimi)	118
B	
benefits (ndihmat)	30, 127
bills (faturat)	33
C	
cell (qelia)	6, 57-58
chaplain (kleriku)	79, 81-2
children (fëmijët)	29

civil partnership in prison (partneritet civil në burg)	46
civil prisoners (të burgosurit civilë)	16
- early release (lirimi i hershëm)	17
- contempt of court (shpërfillje gjyqi)	17
- visits from family and friends (vizitat nga familja dhe miqtë)	40
clothes (veshjet)	62
complaints (ankesat)	110
D	
declaring convictions (shpallja e dënimeve)	132
deportation (përzënia)	152
disabled prisoners (të burgosurit invalidë)	109
doktor (mjeku)	67
drug problems (problemet e drogës)	73, 77
drug testin (analiza e drogës)	73 - 76
F	
faith (besimi)	78-82
family and friends (familja dhe miqtë)	39
- letters (letrat)	43-44
- telephone calls (thirrjet telefonike)	44-45
- visits (vizitat)	39 – 42

H	
health (shëndeti)	65-72
help in prison (ndihma në burg)	37-38
hepatitis (hepatiti/verdhëza)	72
high security prisons (burgjet e sigurisë së lartë)	55
HIV (HIV)	70-71
home (shtëpia)	
- bills (faturat)	33
- council tax (taksa a bashkisë)	33
- income tax (taksa mbi të ardhurat)	36
- mortgage (kredia e shtëpisë)	32
- national insurance (sigurimi kombëtar)	34
- pension (pensioni)	35
- rent (qiraja)	30-31
home detention curfew (urdhri për mos dalje nga shtëpia)	138-140
I	
immigration detainees (të mbajturit e emigracionit)	18
- bail (lirimi me kusht)	19
- help and advice (ndihma dhe këshilla)	20-21

L	
learning (mësimi)	121-122
leaving prison (largimi nga burgu)	125
- benefits (ndihmat)	127
- gate arrest (arresti i portës)	130
- grants and loans (grante/dhurata e të hollave dhe kreditë)	128
- Housing (strehimi)	126-127
- money (paratë)	127
- release time (koha e lirimit)	129
local prisons (burgjet lokale)	54
M	
marriage in prison (martesa në burg)	46
medicine (mjekime/ilaçe)	68
money (të holla/para)	59-60
P	
parole (lirim para kohe me kusht)	141 - 144
private prisons (burgje privatë)	55
privileges (privilegje)	64

punishment (ndëshkim)	87 - 89
R	
race equality (barazi racore)	106-108
recall (ri-thirrje)	149-150
- foreign national prisoners (të burgosurit e kombësive të huaja)	151
records (shënimet)	
- prison (burgu)	49-50
- health (shëndeti)	69
rehabilitation (riaftësimi)	130- 131
release on licence (lirimi në licencë/lirim i parakohshëm me kusht)	134
- childcare (kujdesi për fëmijët)	135
- end of custody licence scheme (fundi i skemës së licencës së arrestit)	136-137
- ROTL (ROTL)	134
- resettlement (rivendosja)	135
- special purposes (qëllimet e veçanta)	135
religion (feja)	78- 82
repatriation (riatdhesimi)	152-153
rules (rregullat)	83- 86
S	

searches (kontrollet)	103-104
segregation (izolimi)	99-100
sentences (dënimet)	25
- how long (sa i gjatë)	26-28
- sentence plan (plani i dënimit)	118, 120
adult prisoners (të burgosurit e rritur)	26, 145
- on or after April 2005 (në ose mbas prillit 2005)	27, 148-149
- on or before April 2005 (në ose përpara prillit 2005)	26-27, 146-148
- before October 1992 (përpara tetorit 1992)	28
- up to 12 months (deri më 12 muaj)	26,145
young offenders (shkelësit e rinj)	145
smoking (pirja e duhanit)	60- 61
solicitors (avokatët)	47
- letters (letrat)	47
- visits (vizitat)	48
special accommodation (strehimi i veçantë)	100-101
supervision (mbikëqyrja)	138

T	
training (trajnim)	122
training prisons (burgje të trajnimit)	54
transfers (transferimet)	153-154
U	
unconvicted prisoners (të burgosurit e padënuar)	7
- bail (lirim me kusht)	8
- court (gjyqi)	9-11, 13
- sureties (siguruesit)	11-12
W	
work (puna)	123-124
Y	
young offender (shkelësit e rinj)	155
- arrival (arritja)	156
- education (edukimi)	157
- leaving (lëshimi)	158
- sentences (dënimet)	53, 145, 155
- supervision (mbikëqyrja)	159

Mbi Trustin e reformës së burgut

Trusti i reformës së burgut punon për të krijuar një sistem burgu të drejtë dhe të denjë. Këtë ne e kryejmë duke vëzhguar se si janë duke punuar burgjet, duke i dhënë informata të burgosurve, punonjësve dhe njerëzve jashtë dhe duke kërkuar të bëhen ndryshime nga qeveria dhe zyrtarët.

Falenderojmë

- Shërbimin e Burgut të Madhërise së Saj (HMPS). Dhe Trusti i Reformës së Burgut dëshiron të falënderojë të burgosurit dhe punonjësit e HMP Wandsworth për ndihmesën me këtë libër.
- Trusti i Reformës së Burgut dëshiron të falënderojë Fondin e Lotarisë së Madhe dhe Fondin e Kujtesës të Dianës, Princesha e Uellsit, për përkrahjen e shoqërisë sonë bamirëse në përpjekjen për të përmirësuar të dhënat për të burgosurit.
- Mencap

What is this book about?

- What you need to know about prison life.
- Prison rules and ways of doing things.
- Your rights.

“The handbook is like an A-Z of information for prisoners. We could never do without it.”

Adeleke, prisoner HMP Wandsworth

“When a prisoner first comes into prison he often doesn't know the questions he needs to ask. This guide is an invaluable aid.”

Prison Officer



Ministry of
JUSTICE

Safer Custody and Offender Rights
NOMS
1st Floor, Fry,
2 Marsham Street
London, SW1P 4DF
www.hmprisonservice.gov.uk

**PRISON
REFORM
TRUST**

Prison Reform Trust
15 Northburgh Street,
London, EC1V 0JR
Tel: 020 7251 5070
e-mail: prt@prisonreformtrust.org.uk
www.prisonreformtrust.org.uk